REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 146/24
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 15. 07. 2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28 paragrafi 1 i Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores për Punën e Kuvendit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 korrik 2024 (e enjte), me fillim në ora 10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024, mbajtur më datë 27 qershor 2024.
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për heroin “Adem Voca” në fshatin Pasomë.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për z. Milaim Fejzullahu, ish-komandant i Policisë së Kosovës.
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës, për periudhën janar-qershor 2024.
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr.02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raporti për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore të komunës për periudhën janar-qershor 2024.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit lidhur dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në fshatin Lumadh.
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.
13. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2023.
14. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për Klubin e Hendbollit “Samadrexha” F.
15. Pyetje dhe përgjigje.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 145/24
Nr. i fq. / Br. st -2-
Data: / Datum 15.07.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| **PËR:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA:** | **Melihate Basholli Latifi** ____________ <br> **Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES:** | **Sekretarisë së Kuvendit** |
| **TEMA:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.07.2024** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **15 korrik 2024** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

2. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2024.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. "Përparimi" SH.A për vitin 2023.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtim të lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

7. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

8. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

9. Shqyrtimi i i kërkesës për përkrahje financiare të klubit të hendbollit "Samadrexha (F)".
   ***Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:***
   ***Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa rekomandoi që për KPF dhe kuvend të mos ketë material shtesë, por të përgatiten dhe të dorëzohen me kohë.***

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS – VUSHTRRI**

# PROCESVERBAL
# NGA MBLEDHJA E VI E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 QERSHOR, 2024

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën **10:20.**
Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Alban Bajrami, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Basri Menxhiqi, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Faton Hyseni, Leonora Gërguri, Kushtrim Hyseni, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Jeton Gjaka, Refik Maloku, Melihate Basholli-Latifi, Mek Selaci, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Mentor Ferizi, Nasuf Aliu**,** Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviç, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Munguan:** Gentiana Rama, Gresa Muli, Nurie Halili dhe Shkelzen Xhaferi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetarja e komunës znj. Hava Rruka-Mlinku, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-** në fillim të mbledhjes njoftoi kuvendin për pika shtesë, për bashkëngjitje për shqyrtim në rendin e ditës.
**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-** në adresimin e tij para kuvendit lexoi një kërkesë nga z. Nazif Ferati Rr. “Lidhja e Lezhes" Nr.33, Vushtrri, Drejtuar: Kuvendit Komunal–Vushtrri, Kryetarit të Komunës: z. Ferit Idrizi, ku më herët, para 14 muajve kamë bërë kërkesë me shkrim dhe me gojë me drejtorin e Shërbimeve Publike z. Benjamin Shala, për çështjen e kanalizimit i cili më ka premtuar se do kryhet shumë shpejtë, mirëpo deri më sot nuk është punuar në rrugën "Ibrahim Rrugova", mbi Zjarrëfiksat-Svaraqak dhe po ashtu edhe kërkesa ime me shkrim dhe gojë nuk është realizuar deri më tani. Ju njoftoj se në vendin ku kam kërkuar vendosjen e kanalizimit dhe ndriçimit, janë tri shpija në ndërtim e sipër që do e shfrytëzojnë edhe këtë kanalizim dhe ndriçim, po ashtu në këtë sipërfaqe janë pjesëtarë edhe Nazif Ferati, Ahmet Ferati, Njazi Ferati, Valon Ferati dhe Azize Bytyqi e Sejdi Zhushi, Ali Zhushi të cilët mund të lidhen në këtë rrugë, kanalizim dhe ndriçim. Në afërsi të ndërtesës ka edhe ndërtesa tjera që janë duke banuar me banorë e që mund të përfitojnë nga kjo punë në kanalizimin e kësaj lagjeje dhe ndriçimi i duhur që do shërbente edhe për banorët tjerë në afërsi. Gjithashtu ju njoftoj

se me dt. 10 janar 2024 është bërë kërkesa për ndriçim publik dhe për rrugë sipas Drejtorisë për Shërbime Publike nr.11-104/02-0001588/24 e cila është evidentuar pranë Organeve komunale të Vushtrrisë -Njësia e Drejtorisë Publike, mirëpo gjerë më tani nuk kemi përgjigje pozitive dhe po ashtu nuk kemi informim për fillimin e këtyre punimeve që do na ndihmonte shumë banorët tjerë në afërsi të kësaj ndërtese. Edhe përkundër asaj që i kemi dhuruar nga pronarët e shfrytëzimit të parcelave Komunës si shpronësim falas për nevojat publike sipërfaqja prej 169 m gjatësi me 2 m gjerësi nga pronari Ali Zhushi dhe 124 m gjatësi me 2 m gjerësi nga pronari Sejdi Zhushi. Vushtrri, 27.06.2024. Në fund deklaroi se shpreson që në një afat së më të shpejtë organet komunale të ndërmarrin veprimet e duhura për realizmin e këtyre projekteve.
**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LDK-së deklaroi: të nderuar të pranishëm, të dashur qytetarë të Vushtrrisë, gjatë këtyre tri viteve qeverisje të Kryetarit Idrizi, kemi parë pak punë, e shumë drama. Nuk e dimë se cilat premtime i ka realizuar Kryetari gjatë kësaj periudhe, nuk e dimë ne si anëtarë të kuvendit e lëre më qytetarët e Vushtrrisë. Ka dështuar me ujë, po dështon me sheshin dhe po dështon me çdo projekt, por fatmirësisht ka projekte të mjaftueshme të cilat kanë filluar gjatë qeverisjes së kaluar me të cilat po krenohet Kryetari. Për tri vite janë shkarkuar më shumë se 13 drejtorë komunal. Pyetja është se: gjithë këto ndërrime a i ka bërë vet Kryetari, apo është detyruar t'i bëjë nga dikush tjetër? Nëse i ka bërë vet, po del të jet një menaxher shumë i dobët. Nëse është ndikuar nga dikush tjetër, atëherë se di si mund të jesh Kryetar Komune duke u ndikuar nga të tjerët. Me shumë gjasë Kryetari nuk mund t'i marr vendimet vet, këtë e dëshmon më së miri shkarkimi dhe riemërimi i drejtorit të Drejtorisë së Prokurimit Publik në Komunën tonë. Kryetar, nëse e shkarkuat vet, pse e kthyet sërish, kush ndikoj? Ne e dimë, por a mund t'ju tregoni ju edhe qytetarëve. Keni shumë punë të filluara të cilave nuk ju dihet afati i përfundimit. Rruga për në Begaj është pothuajse e pakalueshme, rruga për Nedakoc ka mbetur në gjysmë për më shumë se tri vite, njëjtë edhe rruga për në Qyqavicë. Keni investuar në rregullimin e varrezave të martirëve në Studime të Epërme dhe keni bërë mirë, por të njëjtën punë nuk e keni bërë në varrezat e qytetarëve, a mund ta dimë pse Kryetar?, - nuk duam të besojmë që këto dallime i bëni për përfitime elektorale. Lista e punëve të papërfunduara është shumë e gjatë Kryetar, gjithashtu edhe lista e dramave dhe skandaleve në Vushtrri është e gjatë. Në çdo punësim shihen lidhjet e të punësuarve me pushtetin aktual. Punësimi i fundit është qershia mbi torte, ku të dashur qytetarë Kryetari i Komunës punëson renë e vëllait. A mund të na shpjegoni këtë punësim Kryetar, apo mjafton shpjegimi që e keni dhënë për media, kinse nuk keni qenë i informuar?
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**përsërit se edhe në mbledhjen e kaluar ka kërkuar nga kryetari i komunës, emrat e drejtorëve të drejtorive komunale, por një informatë të tillë nuk e ka pranuar as me shkrim dhe as me prononcim të kryetarit të komunës para kuvendit. Një gjë e tillë është obligim ligjor për kryetarin e komunës që ta njoftoi kuvendin për emrat e kabinetit të tij qeveritar. Prandaj, ai kërkoi informatë lidhur me numrin e drejtorive dhe emrat e tyre si dhe a ka mbulim financiar për drejtorit që janë themeluar rishtazi.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se, me që gjashtëmujori i parë i viti 2024 po përfundon, duhet t'i bëjmë një analizë për ecurinë qeverisëse për këtë periudhë në veçanti dhe qeverisjes tri vjeçare në përgjithësi të cilën e ka quajtur qeverisja e lodhur e Ferit Idrizit, kjo për faktin se të ndërrosh nënkryetarin dhe 13 drejtorë të drejtorive komunale, për më pak se tri vjet qeverisje, të provosh të njëjtin drejtor në tri drejtori të ndryshme Kadastër, Prokurim dhe Arsim, nuk ka rëndësi kualifikimi profesional i drejtorit se a përshtatet në këto drejtori apo jo, zgjidhja është thjesht universale. Të provosh të njëjtin drejtor në dy drejtori Kadastër dhe Financa, nuk ka kurrfarë rëndësie kualifikimi profesional i drejtorit dhe vizioni i tij. Në qeverisjen e "lodhur" Idrizi, provohen dy drejtorë në shëndetësi, tre drejtorë në arsim, 5 apo 6 drejtorë në prokurim, tre drejtorë në inspektime, dy drejtorë në financa, dy drejtorë në administratë. Të qeverisësh sikur Ferit Idrizi

do të thotë të punësosh asamblistë dhe familjarë të tyre, sa për ti kaluar disa vendime në kuvend. Në raste të caktuara, hapur pastron rrugë, shkurre e male, ndërsa rrugët gjithandej qytetit janë në kaos nga prerja e asfaltit dhe mosrregullimi i tyre nga operatorët që janë kontraktuar nga Komuna e Vushtrrisë. Shkarkon drejtorin e Drejtorisë së Inspektimeve vetëm disa muaj pasi e emëron të njëjtin, merr mundin që të shkarkoi Drejtorin e Prokurimit vetëm një muaj pasi e emëron atë, provon ta shkarkoi por nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, sepse të njëjtin detyrohet ta kthej përsëri aty ku ishte, në një rang pak më të lartë si drejtor i drejtorëve. Për më tepër kryetari nuk mjaftojnë 12 drejtori komunale dhe i shton ato në 14, nuk ka rëndësi stafi se a kanë këto drejtori, nuk është i rëndësishëm planifikimi i buxhetit për këto drejtori me rëndësi është që dikë ta emëroi drejtor. Pas tri viteve shkarkon Drejtoreshën e Urbanizimit sepse sipas kryetarit e njëjta është lodhur nga udhëtimi Prishtinë-Vushtrri, defakto kryetari e pranon se qeverisja e tij është lodhur. Kjo qeverisje kositë bari e ujitë bari në minus temperaturë dhe në të njëjtin i pastron rrugët nga bora, ky paradoks tregon për keqpërdorim të parasë publike. Pas tri viteve shkarkon drejtoreshën e kulturës sepse të njëjtës kishte filluar ti zgjerohet drejtoria e më vonë sipas porosisë i ndërton një drejtori të re për ta rehatuar. Nuk arrin t’i kyçë në rrjetin e ujësjellësit qytetarët, fshatrat dhe lagjet që janë pa ujë të pijes, as pas tri viteve të qeverisjes së tij. I mashtron punëtorët e administratës për pagesën e shujtës dhe në fund nuk ia paguan ato. Refuzon rritjen e subvencioneve për fëmijët e porsalindur nga 120 në 250 €, vetëm e vetëm se propozimi kishte ardhur nga LVV në Vushtrri. Punëtorëve të Ndërmarrjes “Përparimi” iu ndalon pagat dhe çuditërisht të njëjtëve iu premton vaksina kundër tetanosit. Refuzon zbatimin e vendimit të kuvendit për emërimin e teatrit “Adem Mikullofci”, ndërsa emëron sheshe dhe vendkalime pa vendim të kuvendit. Në fund tha se, lista e dështimeve është e gjatë dhe lirisht mund të thuhet se qeverisja e Ferit Idrizit është më e dobëta në historinë 24 vjeçare të Vushtrrisë.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-** duke iu adresuar Kuvendit dhe qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, ngriti dy shqetësime të qytetarëve të Vushtrrisë që kanë të bëjnë me banorët në rr.”Shotë Galica”, ku pas zgjerimit të rrugës maxhistrale ajo pikë është bërë shumë e rrezikshme për banorët lokal, këta banor për me shumë se 200 nënshkrime kanë bërë kërkesë komunës që të zgjerohet ajo pjesë e rrugës. Ai sqaroi se në atë vend ka pronë komunale dhe mundet lehtë me një angazhim të bëhet rregullimi i zgjerimit të asaj rruge dhe kësisoj do të mënjanohet rreziku për jetët e atyre banorëve. Çështjen tjetër që e ngriti është ajo e ndihmës financiare për klubin e futbollit në vlerë prej 100,000.00 € dhe pyeti se a ka mjetet komuna që të mbuloj këto kosto, sepse siç e dimë komuna nuk po gjen mjete për financimin e projekteve për shuma edhe më të vogla, ndërsa në rend dite kemi një propozim-vendim me një shumë të konsiderueshme të mjeteve buxhetore. Për më tepër ai pyeti se DKRS në Vushtrri a ka bërë një skanim të gjendjes së funksionimit të këtij klubi, sepse ka tri vjet që ky klub nuk është duke funksionuar e në ndërkohë që komuna vazhdimisht e ka subvencionuar këtë klub. Ai mendon se duhet të bëhet një analizë e gjithanshme e këtij klubi para se të ndajmë mjete. Pastaj informoj se Klubi i Hendbollit Samadrexha F, do të marr pjesë në garat ndërkombëtare dhe do të ishte mirë që edhe ky klub të subvencionohet.
**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**ngriti shqetësimin e banorëve për rr. Drenica, nga ura e Lumit “Silnica” në drejtim të fshati Bukosh, ku pyeti se kur do të përfundohet kjo rrugë, për faktin se për një periudhë gati tre muaj është mbyllur kjo rrugë. Ky projekt është në bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës, por menaxhimi i kontratës është nga ana e komunës. Më tej pyeti se a është paraparë ndonjë projekt për rregullimin e rrugës në fshatin Dolak e cila është pothuajse krejtësisht e shkatërruar.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**pasi i përshëndeti gjithë të pranishmit në adresimin e tij para kuvendit deklaroi se: çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit dhe shqetësimet e tyre në totaalitet

janë të bazuara, dhe ceku se ato do ti adresoj tek operatoret ekonomikë që janë të kontraktuar, dhe aty ku ka urgjencë do të intervenohet në rregullimin e infrastrukturës. Deputetja Leonora Gërguri, ngriti shumë çështje por mendimi i saj dhe i qytetarëve mund të ndryshojnë, sepse ai ishte në fshatin Studime e Epërme dhe ata banorë janë jashtëzakonisht të kënaqur me punën që është bërë në rregullimin e varrezave sepse gjendja ka qenë jashtëzakonisht e keqe dhe do të bëhet edhe zhvendosja e rrugës dhe do të bëhet aty një kompleks ashtu siç e meritojnë ata martirë. Sa i përket punësimeve vlerësoi se ati i vjen shumë keq por atë letër që deputetes Gërguri ai ka shkruar dikush, është mirë ta lexoj dy apo tri herë, sepse pikërisht motrën e gruas së kryetarit të LDK-së e kemi transferuar në administratën e komunës dhe ai nuk bënë dallime partiake në punësim por punësimet bëhen vetëm në formë ligjore. Lidhur me projektet të natyrës kapitale ekonomike të filluar në qytetin e Vushtrrisë, njoftoj se të gjitha këto projektet me peshë janë edhe sfiduese por të gjitha e kanë dinamikën e tyre të përfundimit dhe mund të thuhet se të gjitha janë në afatin optimal të përfundimit të tyre. Për sa i përket rrugës "Lumni Surdulli" që është një arterie e fuqishme që e zbrazë qytetin, ceku se, është sipas dinamikës dhe standardeve dhe mendon se nga mesi i korrikut do jepet shtresa e parë e asfaltit kësaj rruge. Lidhur me emrat e drejtorëve, njoftoi se brenda afatit 30 ditor raporton dhe njoftoi se Drejtoresha e Urbanizimit ka kërkuar të lirohet nga detyra dhe e ka lejuar sepse e njëjta është transferuar me punë në Komunën e Prishtinës. Sa i përket Kompanisë "Përparimi" ceku se ndoshta ka bazë për kritikë por qytetarët nuk kanë ankesa për këtë kompani dhe menaxhimin e mbeturinave. Lidhur me një drejtor komunal, ceku se i ka skaduar licenca, ndërsa në momentin që e ka përtërirë licencën ai është kthyer në udhëheqjen e drejtorisë së apostrofuar. Lidhur me shqetësimin për rr. Shotë Galica, ceku se është bërë kërkesa për dislokimin e një shtylle elektrike në KEDS dhe mendon se kjo çështje shpejt të rregullohet. Mendon se në rrugën maxhistrale sikur të ishin respektuar rreth-rrotullimet dhe semaforët nuk do kishte aksidente deri në fatalitet apo ato do ishin shumë të rralla. Lidhur me subvencionimin e klubit të futbollit, ceku se është në gjendje shumë të keqe dhe ndihma prej 50,000.00 € që është e ndarë, është marr nga ATK-ja si pasoj e obligimeve financiare të klubit ndaj kësaj të fundit. Por akoma nuk është zyrtarizuar por këtë klub e ka marr në menaxhim Kompania Interex, ku kjo e fundit ka marr obligim që të fshijë borxhe në vlerë prej 300,000.00 €, ndërsa komuna do ti ndaj 50,000.00 € do ti ekzekutoj këtë vit ndërsa pjesën e mbetur në vitin 2025. Lidhur me ofrimin e ndihmës për klubin e hendbollit, tha se kanë gjetur sponsor përmes formës ligjore dhe kjo është tepër e mirëseardhur, ndërsa është në negociata të gjej edhe ndonjë sponsor edhe për klubin e femrave, kurse njoftoj se ndihma e komunës për këto klube nuk ka munguar asnjëherë. Projekti i rregullimit të rr. Drenica është tepër i rëndësishëm dhe ceku se ajo rrugë ka qenë tepër e rrezikshme për shkak se ka qenë e ngushtë dhe trotuari i ngritur lart ashtu që ka paraqitë rrezik qoftë për këmbësorët ashtu edhe për vozitësit e automjeteve. Kjo rrugë do të bëhet sipas standardeve me projekt detaj ku përfshihet infrastruktura nëntokësore kabllot e rrymës dhe telefonisë, kanalizimi atmosferik dhe do të vendosen pusetat. Nga takimi që ka pasur me operatorin ekonomik ka marr obligim që nga data 5 korrik 2024 do të bëhet shtresa e parë e asfaltit dhe rruga do të lirohet. Në fund paraqiti disa prej emrave të drejtorëve komunal që janë emëruar së fundmi.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**përsëriti pyetjen e tij se, a ki më mjete për ta mbështetur klubin e futbollit, ndërsa shtroj nevojën që të përkrahet edhe klubi i hendbollit i cili do marrë pjesë në garat evropiane.

**Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-**tha se, kryetari i komunës ka bërë një punë të mirë sa i përket varrezave të martirëve, por ka ankesa se varrezat e qytetarëve është mirë që edhe ato të rregullohen. Tutje përsëriti se punësimet janë duke u bërë sipas vijës politike dhe partiake.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se të gjitha punët e mira që bëhen në Komunën e Vushtrrisë do ti përkrahin, ndërsa shtoj se ka më tepër se një vit që në fshatin Akrashticë arteriet kryesore të kanalizimit nuk funksionojnë ku kemi kundërmim të tmerrshëm, kërkoj që me urgjencë të rregullohet kjo çështje. Po ashtu kërkoj nga kryetari i komunës që të ushtroj ndikimin e tij ndaj operatorëve ekonomikë që të kthejnë në gjendjen e mëparshme rrugët në të cilat është prerë asfalti, sidomos në unazën e qytetit.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**lidhur me prerjen e asfalti, sqaroi se, dëmin më të madha është duke e shkaktuar Kompania Regjionale e Ujësjellësit dhe në takimin që ka pasur me zyrtarët e kësaj kompanie iu është bërë me dije se prerja e asfaltit nuk mund të bëhet pa pëlqimin e komunës. Lidhur me ndihmën për klubin Samadrexha, njoftoi se kryetari i klubit duhet ti adresohet komunës me një kërkesë e më tej do të shikohen mundësit që edhe këtij klubi ti dilet në ndihmë. Në takimin me kryetarin e këtij klubi i kishte kërkuar kryetarit të komunës që të iu sigurohet një autobus dhe një gjë të tillë komuna e ka siguruar.
**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-**parashtroj një kërkesë për ofrimin e ndihmës financiare për znj. Hanëmshahe Kajtazi, e cila vuan nga një sëmundje e rëndë kanceroze, ndërsa gjendja e saj sociale është e renduar dhe nuk po ka mundësi të mbuloj shpenzimet e mëdha për trajtimin e kësaj sëmundje. Kërkesa është që të ofrohet ndihmë financiare në shumë prej 8000 €.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**parashtroj një kërkesë për ofrimin e ndihmës financiare për fermerin z. Rasim Vatovci, të cilit nga energjia elektrike i është djegur shtalla dhe dëmet materiale janë të konsiderueshme, andaj propozoi që ti ndahet një shumë prej 8000 €.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se, dy propozimet e bëra e kanë bazën dhe arsyen, janë të logjikshme, por kërkoj që këto kërkesa të kthehen dhe të vijnë përmes komisioneve pasi të bëhet një analizë e mirëfilltë, sepse ka edhe shumë kërkesa tjera. Kërkesa për shërim të vjen përmes komisionit për shëndetësi dhe ata të caktojnë vlerën e ndihmës për shërim. Po ashtu edhe kërkesa për fermerin duhet fillimisht të bëhet vlerësimi i dëmit e më pas nga ana e komisionit të sillen në kuvend për aprovim.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-**tha se, vërtet gjendja e familjes së znj. Hanëmshahe Kajtazi, është e rëndë dhe është mirë që të ndihmohet, ai potencoi se ndoshta do të ishte mirë që nga shuma e mjeteve të dedikuar për klubin të zbritet një pjesë e mjeteve dhe ti ndihmohet parashtrueses së kërkesës e cila gjendjen shëndetësore e ka tepër të rënd edhe është emergjente ti dilet në ndihmë.

Në vazhdim kryesuesja e kuvendit i hedhe në votim në mënyrë individuale pikat e propozuara në të ndryshme dhe atë me sa vijon:

Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 1 votë “abstenim”, e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim-vendimin për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për zgjerimin e rrugës “Tahir Gerbeshi” në fshatin Ropicë –Vushtrri.

Kuvendi pas votimit me 25 vota “për”, 1 votë “abstenim”, e aprovoi për inkorporim në rendin e ditës Propozim-vendimin për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, për zgjerimin e rrugës “Zeqir Gubetini” në Nedakoc –Vushtrri.

Kuvendi pas votimit me 27 vota “për”, e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim-vendimin për ndarje të mjeteve financiare për organizimin e shënimit të 100 vjetorit të rezistencës së Heroit Azem Bejta.

Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës Propozim-vendimin për përkrahje financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”.

Anëtari i kuvendit z. Adnan Lahu, nuk mori pjesë në votim me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, lidhur me mjetet financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**njoftoi se me qëllim të respektimit të procedurave ligjore, tërhiqet nga propozimi i tij, për ofrimin e ndihmës financiare për fermerin Rasim Vatovci, ashtu që procedurat të zhvillohen përmes komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.

Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” e aprovoj për inkorporim në rendin e ditës kërkesën për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për znj. Hanëmshahe Kajtazi.

**Në fund të debatit, jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” aprovoi këtë:**

**R E N D   D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024, mbajtur më datë 03 qershor 2024.
2. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024.
3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë.
4. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje.
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira financiare nga investimet kapitale.
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Tahir Gerbeshi” në fshatin Ropicë –Vushtrri.
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës “Zeqir Gubetini” në Nedakoc –Vushtrri.
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare për organizim e shënimit të 100 vjetorit të rezistencës së Heroit Azem Bejta.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për përkrahje financiare për Klubin e Futbollit “Vushtrria”.
12. Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për znj. Hanëmshahe Kajtazi.
13. Pyetje dhe përgjigje.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024,  mbajtur më datë 03 qershor 2024.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me 22 vota "për", aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e muajit maj 2024, e mbajtur më datë 03 qershor 2024.**

**2.** Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2023/2024.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit-**tha se, është dashur që në politikat e stimulimit të studentëve nga ana komunës, konkretisht nga ana e DKA-së është dashur të merren për bazë studentët e drejtimit Informatikë në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini", të cilët janë të nivelit evropian dhe kanë një bashkëpunim dhe konkurrojnë edhe me studentët e fakulteteve gjermane dhe mos të përfshihet në bursa asnjë student, vërtetë është për keqardhje, por edhe e dëmshme.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**tha se, komisioni për ndarjen e bursave, ka bërë një punë të shkëlqyeshme dhe për këtë e përgëzojmë për punën e kryer me përgjegjësi. Më pas pyeti se a është në kompetencën e kryetarit të komunës që pas propozimit të komisionit të ankesave të miratoj edhe dy bursa shtesë.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**pyeti komisionin për ndarjen e bursave se cili është fati i bursave për të cilat nuk ka pasur konkurrentë, e në veçanti nuk ka pasur aplikantë sidomos në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore drejtimi Fizikë Bachelor, nuk ka fare studentë. Në ndërkohë nga plotë figura në këtë kuvend nga udhëheqësja e komunës, është akuzuar në mënyrë profesioniste, një grua, një profesioniste, një profesoreshë e fizikës, për ngjyrime politike, e në ndërkohë kjo komunë nuk ka as studentë në lëndën e fizikës. Le të mbetet turpi i të turpëruarve, që kanë përdor të gjuajnë çdo gurë, sepse nuk ka pasur as kandidatë nëpër konkurse kandidatë të kualifikuar. Herëve tjera le ta përdorin vetëm argumentin e qartë politik sepse e vërteta gjithherë triumfon dhe e vërteta kur triumfon ndaj shpifjes e poshtëron atë që udhëhiqet nga shpifja. Prandaj le të mbetet poshtërimi mbi ata që tentojnë të përdhosin vlerat e njerëzve kredibil dhe profesionist. Mandej duke falënderuar përfaqësuesin e DKA-së për qasjen korrekte shtoj dhe vlerësoi se është fat që stafi i DKA-së nuk po bie në presionin e politikave ditore. Tutje ceku se duhet të përdoren politika stimulative, si p.sh te drejtimi i Veterinarisë, ku nuk ka pasur kandidat atëherë të stimulohen që të rinjtë të studiojnë në këto drejtime. Ai propozoi që të gjenden modalitetet që të ndahen bursa edhe për studentët e farmacisë për shkak të kohëzgjatjes së studimeve në këtë drejtim. Në fund lidhur me studentë jashtë vendit bursat e mbetura, ku këto bursa barten në fushat tjera bazuar në notën mesatare, lidhur me këtë kërkoj të jepen sqarime.
**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-**e përgëzoi komision për punë e shkëlqyeshëm që ka bërë, ndërsa uroj të gjithë studentë përfitues të bursave.
**Enver Bajrami, përfaqësues i DKA-së-**në cilësinë e kryesuesit të komisionit për ndarjen e bursave, paraqiti sqarime të hollësishme lidhur me procesion dhe procedurat e ndarjes së bursave për student dhe në të njëjtën kohë u përgjigj në çështje dhe temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**3.** Shqyrtimi i Informatës lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë.

**Hyra Uka, drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë-**paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke dhënë informata shtesë për numrin e lindjeve jashtë Komunës së Vushtrrisë, të cilët e kanë adresën e vendbanimit në komunën tonë sipas kërkesave të anëtarëve të Komitetit për Politikë

dhe Financa. Numri total i këtyre lindjeve jashtë Komunës së Vushtrrisë është 335 sipas statistikave të Agjencisë për Regjistrimin Civil.

**4.** Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje.

**5.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**tha se, ka vërejtur një diskrepancë te vlerësimi i dëmeve tek ekonomitë familjare, duke krahasuar se kemi një ngatërrim mes vlerësimit në vlerë financiare të një sere dhe të një pullazi të një shtëpie me vlera diametralisht të mëdha në vlerë dhe vlerësim të gabuar.
**Agim Miftari, zyrtar i Drejtorisë së Emergjencave-**paraqiti sqarime hyrëse lidhur me raportin për vlerësimin të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera duke iu përgjigjur çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim aprovohet raporti i Komisionit Komunal lidhur me Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, në Komunën e Vushtrrisë, për përiudhën dhjetor 2023, si dhe muajt: janar, shkurt, mars dhe maj 2024.

**2.** Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, ka dalë në terren dhe ka bërë evidentimin e dëmeve të shkuara nga moti i ligë (vërshimet, zjarret, erërat e forta dhe nga qent endacakë), që kanë mbretëruar në periudhën e sipër-cekur, në Komunën e Vushtrrisë.

**3.** Komisioni i cekur më lartë, ka bërë vlerësimin e dëmeve dhe ka shqyrtuar kërkesat e qytetarëve, dhe konform të gjeturave ka evidentuar dhe kalkuluar shumat e mjeteve financiare në vlerë totale prej **41,837.00 €**, si në të mbjellat bujqësore e po ashtu edhe dëmet e shkuara në ekonomitë familjare dhe këto të dhëna për dëmet janë të bashkangjitura në mënyrë tabelare në raportin e komisionit.

**4.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, në Komunën e Vushtrrisë.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Vushtrrisë dhe po ashtu ky vendim i dërgohet edhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

**6.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**6.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, duke shpërfaqur të dhëna në indikatorët e përgjithshme lidhur me tavanet buxhetore në kategoritë e buxhetit për vitin 2025 dhe parashikimet për vitet 2026 dhe 2027.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditë kuvendi pas votimit, me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2025/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2025-2027.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 e Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**7.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira financiare nga investimet kapitale.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**paraqiti sqarime lidhur me propozim-vendimin për ridestinimin e mjeteve të lira financiare nga investimet kapitale, duke sqaruar se është obligim ligjor të aprovohet ky vendim për ridestnimin e mjeteve financiare të komunës nga projektet kapitale në projektet dhe kodet tjera të projekteve kapitale që janë në zhvillim e sipër apo do të zhvillohen dhe me qëllim të mbulimit të detyrimeve kontraktuale.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditë kuvendi pas votimit, me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet ridestinimi i mjeteve financiare të komunës nga kategoria e investimeve kapitale, fondi 22 si në vijim:

**<u>Alokimi dhe Rialokim i mjeteve, nën programi, fondi burimor 22:</u>**

**INFRASTRUKTURA PUBLIKE - VUSHTRRI (18184), nga projektet:**

Rregullimi i shtratit të lumit „Silnica"Kodi 51830, shuma 6,993.81€
NDËRTIMI I RRUGËS ME KUBËZA BETONI, RR. "BEKIM ZENUNI", Kodi ( 53280 ), shuma 80.00€
NDËRTIMI I RRUGËS ME KUBËZA BETONI, RR. "MURSEL HYSENI" Kodi (53285 ), shuma 1,737.41€
NDËRTIMI I RRUGËS ME KUBËZA BETONI, RR. "FEHMI TAHIR ISTREFI",Kodi(53288),shuma 194,97€
NDËRTIMI I RRUGËS ME KUBËZA BETONI RR. HAXHI IBRAHIMI",Kodi(53290).shuma 687.00€
NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA BETONI RR. "BAHRI KUQI" SEGMANT, Kodi (53293), shuma 2,796.00€
NDËRTIMI I RRUGËVE ME KUBËZA BETONI RR. "ADEM ADEMI"Kodi(53295),shuma 92.52€
NDËRTIMI I RRUGËS ME KUBËZA BETONI RR. "HAZIR GJAKA",Kodi(53297 ),shuma4,887.50 €
NDËRTIMI I RRUGËS "FARUK SUNGURI" ME KALLDËRM,Kodi(53307),shuma 2,000.00€
NDËRTIMI I TROTUARIT NË BUKOSH Kodi(53310),shuma 45.05€
NDËRTIMI I TROTUARIT NË FSH .PRELLUZHË Kodi( 53312),shuma 611.00€
ZGJERIMI I RRJETIT TË UJËSJELLËSIT MIHALIQ Kodi (53331 ),shuma 1,204.88€

HAPJA E PUSEVE PËR UJITJE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE NË VUSHTRRI Kodi(53365),shuma 2,230.00€
NDRIÇIMI NË RR. "BASTRI BEQIRI"Kodi(53368),shuma1,052.00€
NDERTIMI I URËS DHE MURIT MBROJTËS NE FSH STUDIME E EPERME Kodi(53373),Shuma 251.00€
NDERTIMI I RRUGES ME KUBEZA BETONI FSH REZNIK Kodi(53988),shuma 102.60€
NDERIMI I RRUGES ME KUBEZA BETONI RR "ALBANIA SFARAQAK" Kodi(53990 ),shuma 531.22€
**Totali i mjeteve të alokuara....................................................................................................... 25,496.96€**

**<u>Të rialokohen në projektet</u>**
SINJALIZIMIT NDRIÇUES ME MONITOR DIGJITAL INFORMUES NE KATËR Kodi (53315), shuma 8,589.04€
NDËRTIMI I RR..DUMNICË (ME ZHAVOR ), Kodi (53342), shuma 14,808.00€
Ndërtimi i trotuareve në Vushtrri, Stanoc, Smrekonicë, Kodi (51821), shuma 2,099.92€
**Totali i mjeteve të rialokuara.................................................................................................. 25,496.96€**

**<u>Alokimi dhe Rialokim i mjeteve, nën programi fondi burimor 22:</u>**

**PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKCIONI - VUSHTRRI (66425), nga projektet:**
MBJELLJA E DRUNJVE DEKORATIV, Kodi (49588 ),shuma 18.03€
ASFALTIMI I RRUGES VESEKOC SLLAKOVC,Kodi(52188),shuma 1,249.00€
ASFALTIMI I RR. PRELLUZHË,kodi(52305),shuma 56.30€
NDËRTIMI I RRUG."2 MAJI" ME INFRASASFALTIMI I RR. CECELI,Kodi(53411),shuma 2,951.58€
NDËRTIMI I RRUG."2 MAJI" ME INFRASTRUKTURË PËRCJELLËSE,Kodi(53283),shuma 946.64€
ASFALTIMI I RRUG. DUMNICE,Kodi(53410),shuma 730.00€
ASFALTIMI I RR. AKRASHTICE,Kodi(53412 ),shuma 6,994.77€
ASFALTIMI I RR. BAJSKE,kodi(53413),shuma 3,870.00€
ASFALTIMI I RR. SMREKONICË,Kodi(53414),shuma 2,050.00€
ASFALTIMI I RR. BALINCË,kodi(53416),shuma 2,150.00€
ASFALTIMI I RR. SHITARICË,Kodi(53499),shuma 2,100.00€
ASFALTIMI I RRUG. NË GOJBULË,Kodi( 53553),shuma 2,820.00€
ASFALTIMI I RRUG. STANOC I EPËRMKodi( 53554 ),shuma 3,000.00€
ASFALTIMI I RR. STANOC I ULËTKodi(53561),shum 1,520.00€
ASFALTIMI I RR. STUDIME E ULËT,Kodi(53565),shum 1,520.00€
ASFALTIMI I RR. PASOMË,Kodi(53586),shuma 1,400.00€
ASFALTIMI I RR. MAXHUNAJ,Kodi(53594),shuma 2,870.00€
NDERTIMI I RRUGEVE LOKALE NE FSHATRA AKRASHTICE, VERNICE,Kodi(53971),shuma 11,454.16€
**Totali i mjeteve të alokuara................................................................................. 46,300.48€**

**<u>Të rialokohen në projektet</u>**
NDËRTIMI I RRUG. "AVNI SARAÇI" VICIANA,Kodi( 53262 ),shuma 37,476.00€
ASFALTIMI I RR. PASOMË, Kodi(53586),shuma 8,824.48€
**Totali i mjeteve të rialokuara................................................................................ 46,300.48€**

**<u>Alokimi dhe Rialokim i mjeteve, nën programi fondi burimor 22:</u>**

**SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI (85024), nga projektet:**

BLERJA E MONITORIT LED ME PËRMASA 3X5 PËR SKENËN E SALLËS ,Kodi (52299),shuma 695.00€
NDËRTIMI I NJË SKULPTURE ME KARAKTER ARTISTIK (PARA QENDRËS,Kodi(52877),shuma 130.00€
RIKONSTRUKTIMI I MUZEUT "MAHMUT AGË GJINOLLI",Kodi(53632),shuma2,000.00€
**Totali i mjeteve të alokuara...................................................................................... 2,825.00€**

**<u>Të rialokohen në projektet</u>**

RENOVIMI I PALESTRËS „JETON TERRSTENA", Kodi(51007),shuma 2,825.00
**Totali i mjeteve të rialokuara................................................................................................. 2,825.00€**

**Alokimi dhe Ri-alokim i mjeteve, nën programi fondi burimor 22:**

**SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR- VUSHTRRI (74450),nga projektet**
RREGULLIMI I OBORRIT TË QKMF-SË VUSHTRRI,Kodi (52749),shuma 10.313.75
**Totali i mjeteve të alokuara...................................................................................... 10,313.75€**

**Të rialokohen në projektet**
IZOLIMI I KULMIT NË QMF-1,RREGULLIMI DHE NGJYROSJA E OBJEKTIT,Kodi(52822),shuma 3,744.10
54710 Rehabilitimi I objekteve shendetsore dhe rrethojave per QKMF,QMF-të dhe AMF Vushtrri,Kodi(54710),shuma 6,569.64
**Totali i mjeteve të rialokuara................................................................................ 10,313.75€**

**Alokimi dhe Ri-alokim i mjeteve, nën programi fondi burimor 22:**

**ARSIMI FILLOR - VUSHTRRI-(93690), nga projektet:**

Ndërtimi i tualeteve ne SHMU ,,Emin Duraku",Kodi(51854),shuma 222.39
Meremetimi i SHMU,,Enver Hadari" - Smrekonicë,Kodi(51866),shuma 350.00
Meremetimi i SHFMU "Mihaliq",Kodi(51869),shuma 550.00Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa",Kodi(51870),shuma 532.00
RENOVIMI I SHFMU "MIGJENI" STANOC LAGJA CAKAJ,Kodi (52463),shuma 4.910.00
RENOVIMI I SHFMU "LUMNI SURDULLI" SAMADREXHË,Kodi(52464),shuma3,910.00

RENOVIMI SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË,Kodi (52465),shuma 3,525.78
NDËRTIMI I PLATOS PËR SHFMU "EMIN DURAKU ",Kodi(52779),shuma 4,101.50
NDËRTIMI I DEPOS NE SHFMU "ADEM VOCA "PASOMË,Kodi(52781),shuma147.70
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU. "MIGJENI " LAGJA CAKAJ,Kodi(52910),shuma 147.70
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MIGJENI" STANOC,Kodi(52913),shuma 363.00
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË,Kodi (52961),shuma 279.00
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHF. "ALI KELMENDI" VUSHTRRI.Kodi (52967),shuma 773.80
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "7 MARSI" BUKOSH,Kodi(52995),shuma 204.70
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "AVDYL FRASHËRI" DRUAR,Kodi(53000),shuma 185.70
RENOVIMI I SHFMU "LATIF BERISHA" DOBERLLUKË,Kodi(53032),shuma 1,856.20
RENOVIMI I SHFMU "LIRIA " STROC GLLAVOTIN,Kodi (53051),shuma 3,099.54
RENOVIMI I SHFMU REZNIK,Kodi(53052),shuma 640.00
RENOVIMI I SHFMU -MIHALIQ,Kodi(53053),shuma 737.50
RENOVIMI I SHFMU "RILINDJA" MAXUNAJ,Kodi(53054),shuma 3,506.72
RENOVIMI I SHF "ALI KËLMENDI",Kodi(53055),shuma 925.55
NDËRTIMI I PLATOS PËR SHFMU "28 NËNTORI" VËRNICË,Kodi (53533),shuma 3,469.00
NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MARTIRËT" REZNIK,Kodi(53713),shuma 234.70
MEREMETIMI I SHMU - 1 VUSHTRRI,Kodi(53968),shuma 3,230.85
**Totali i mjeteve të alokuara...................................................................................... 37,974.28€**

**Të rialokohen në projektet**

NDËRTIMI I SHFMU "MUSTAF VENHARI ".Kodi(53024),shuma 37,974.28
**Totali i mjeteve të rialokuara........................................................................... 37,974.28 €**

**Alokimi dhe Rialokim i mjeteve, nën programi fondi burimor 22:**

**ARSIMI I MESËM - VUSHTRRI (94890), nga projektet:**
Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha",Kodi(51874),shum 3,337.08
MEREMETIMI I GJIMNAZIT "EQREM ÇABEJ ",Kodi(52448),shuma 520.00
TEKNOLOGJI INFORMATIVE SHMT "LUTFI MUSIQI",Kodi (52716),shuma 8,660.00
TEKNOLOGJI INFORMATIVE GJIMNAZI "EQREM ÇABEJ" VUSHTRRI,Kodi(52758).shuma 5,021.00

TEKNOLOGJI INFORMATIVE  SHMP :BAHRI HAXHA",Kodi(52768),shuma 1,567.00
BLERJA E PAJISJEVE TË TI (TELEVIZOR ) " BAHRI HAXHA",Kodi(52775),shuma 3,000.00
NDE.PUNETORISE DHE KABINETEVE NE SHMT LUTFI MUSIQI VUSHTRRI,Kodi(53970),shuma 16,992.00
**Totali i mjeteve të alokuara.................................................................................................. 39,097.08€**

**<u>Të rialokohen në projektet</u>**

Rehabilitimi i fushës sportive në SHMP Bahri Haxha,Kodi(54990),shuma 18,949.24
BLERJA E PAIJISJEVE PËR PRAKTIKË SHMT "LUTFI MUSIQI",Kodi(53688),shuma 9,000.00
MEREMETIMII I SHMT "LUTFI MUSIQI " VUSHTRRI,Kodi(52462),shuma 7,000.00
Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi"SHMU II,Kodi(51875),shuma 4,147.84

**Totali i mjeteve të rialokuara............................................................................................. 39,097.08€**

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabela për ridestnimin e mjeteve të lira buxhetore, të shpenzimeve kapitale.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**8.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për  zgjerimin e rrugës  “Tahir Gerbeshi” në fshatin Ropicë –Vushtrri.

**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-**paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se është nevojë e komunës që bëhet këmbimi i kësaj prone me qëllim të zgjerimit të Rr.”Tahir Gerbeshi”.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditë kuvendi pas votimit, me 26 vota “për” vendosi me sa vijon:**

**1.** Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Zaide Gërbeshi.

**2.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika; Pjesë nga parcelat kadastrale P-70202055-0133K-0, në sipërfaqe prej 462.80m$^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6225m$^2$, pronë e Zaide Shaban Gërbeshi, me pjesë ideale 1/1 dhe pjesë nga parcela kadastrale P-70202055-07014K-0 në sipërfaqe prej 419.69m$^2$, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2757m$^2$ , pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**3.** Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë, bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

**4.** Këto prona u janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronave të paluajtshme pranë Departamentit të tatimit në pronë, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe transfereve.

**5.** Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

**6.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**7.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**9.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e rrugës "Zeqir Gubetini" në Nedakoc –Vushtrri.

**Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-**paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se bëhet fjalë për këmbim të pronës mes pronës së komunës dhe pronës private, prona ndodhen në të njëjtin lokalitet me një distancë prej 30 metra largësi prej njëra tjetrës dhe bëhet për interes të përgjithshëm për zgjerimin e rr. "Zeqir Gubetini" në Nedakoc –Vushtrri.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 26 vota "për", vendosi me sa vijon:**

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nuredin (Zeqir) Gubetini

2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: Pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-06458-6, në sipërfaqe prej 24.58m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 855m2 ZK Vushtrri, pronë e Nuredin (Zeqir) Gubetini, dhe pjesë nga parcela P-70202016-03556-0, në sipërfaqe prej 24.58m2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 17447m2 ZK Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

3. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë, bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona u janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

7. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**10.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare për organizim e shënimit të 100 vjetorit të rezistencës së Heroit Azem Bejta.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-**kërkoi sqarime lidhur me këtë propozim-vendim, se kujt po i ndahen këto mjetet sepse kjo po i bie që Drejtoria e Kulturës po i ndan mjete financiare vetë vetës së saj.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se, nuk e vë në dilemë se është e rëndësishme që të financohet organizmi i këtij manifestimi dhe shtoj se në këtë rast po del në pah se DKRS-ja nuk ka qenë në nivel të detyrës, sepse kjo e fundit e ka një plan të punës dhe një kalendar të aktiviteteve në të cilin i parasheh në fillim të vitit të gjitha aktivitete që do të mbahen gjatë një viti kalendarik e të cilat i buxhetonë drejtoria për dedikimin e caktuar. Ajo çka është e dhimbshme është fakti se këto mjete po merren nga kategoria e subvencioneve, në të cilën po kemi më së shumti kërkesa për financim dhe më së paku po kemi buxhet. Nëse planifikimi do të bëhej me kohë atëherë këto aktivitete do të mund të mbuloheshin edhe nga kategoria mallra dhe shërbime, ata do ta përkrahin këtë vendim por mundon se kjo nuk është një praktikë e mirë dhe apelon mos të ndiqet në ta ardhmen.

**Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 26 vota "për" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim ndahen mjetet financiare në shumë prej 3,700.00 euro (tremijë e shtatëqind euro), për organizim e shënimit të 100 vjetorit të rezistencës së Heroit Azem Bejta.

**2.** Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**11.** Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për përkrahje financiare për Klubin e Futbollit "Vushtrria".

Para votimit të kësaj pike të rendit të ditës, anëtari i kuvendit z. Adnan Lahu, deklaroi se nuk merr pjesë në votim me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 25 vota "për", vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim ofrohet përkrahje financiare në shumë prej njëqind mijë euro (100,000.00 €), për Klubin e Futbollit “Vushtrria”, në Vushtrri.

**2.** Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Në mungesë të mjeteve në këtë drejtori, do të sigurohen nga njësitë e tjera buxhetore, ku ka mjete të lira.

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa si dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**12.** Shqyrtimi i kërkesës për ofrimin e mbështetjes financiare për shërim për znj. Hanëmshahe Kajtazi.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-**sqaroi se për çdo vendim që merr kuvendi i komunës duhet të figuroj një pasues që të revidohet planin e Drejtorisë së Financave, me qëllim të mbulimit të kostos së atij vendimi dhe realizimin e mjeteve financiare. Ai ceku se në kuadër të kategorisë së subvencioneve në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të merren mjete për mbulimin e kostos së këtij vendimi.
**Jeton Gjaka, anëtar i kuvendit-**arsyetoi se, kërkesa për ndihmë financiare për shërim është e natyrës urgjente dhe imediate, andaj kërkoi që të gjendet ndonjë kod tjetër buxhetor, ku do të mbulohet kostoja e vendimit në vlerë prej 8000 €, kjo për faktin se gjendja e pacientes është tepër e rënd dhe po ashtu sëmundja e saj është tepër e kushtueshme, dhe kjo ka bërë që gjendja socio-ekonomike e kësaj familje të rrënohet.
**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se, kur bëhet fjalë për ofrimin e ndihmës për shërim, ky kuvend është mirë ti heqë disa praktika jo humane dhe të ndërtoi një standard të barabarsisë së ndarjes se këtyre ndihmave kur është në pyetje shëndeti i qytetarëve. Apeloi që të ndahen këto mjete për parashtruesin sipas kërkesës së saj.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**vlerësoi se, këto kërkesa që lidhen me shërim, janë të natyrës më të ndjeshme dhe shtoj se cilido që të jetë propozimi dhe vlera e mjeteve ata do ta votojnë. Tutje ceku se duhet bërë e ditur se forma se si po ndahen këto mjete është e kundërligjshme sepse këto mjete nuk duhet të ndahen përmes kuvendit. Në këtë kontekst ai vlerësoi se kjo praktikë e ndarjes së këtyre mjeteve është tepër jo e rregullt dhe jo humane sepse është duke krijuar pabarazi në shpërndarjen e këtyre mjeteve, sepse ai cili po ka një mbështetje në kuvend, por përfiton mirë, ndërsa ata që nuk kanë mbështetej dhe janë me diagnoza me sëmundje të rënda po mbesin pa kurrfarë përkrahje financiare.
**Hava Rruka-Mlinku, nënkryetare e komunës-**sqaroi se, kjo kërkesë është adresuar te kryetari i komunës dhe është mbështetur nga anëtarët e kuvendit z. Gjaka dhe znj. Shala, vullneti i qeverisë komunale është që të mbështetë këtë rast me shumën e cekur si në kërkesë. Ajo vlerësoi se hezitimi ishte se kjo kërkesë është dashur të kaloj nëpër komisionin profesional mjekësor e më pas të sillet për aprovim në kuvend.

**Në fund të debatit, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1.** Me këtë vendim znj. Hanëmshahe Kajtazi, i ofrohet mbështetje financiare në shumë prej tetëmijë euro (8000.00 €), për financimin e nevojave dhe shpenzimeve për shërim, e cila vuan nga një sëmundje e rënd kronike.

**2.** Mjetet financiare të cekura në pikën paraprake të këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria: subvencione dhe transfere, **Programi Buxhetor (74450), në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.**

**3.** Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit të Komunës si dhe Drejtoria Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

**4.** Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Mbledhja përfundoi në ora 13:55**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ________________ | ___________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR:**<br>**ZA:**<br>**TO:** | z.nj Melihate Basholli/Latifi<br>Kryesuese e kuvendit komunal Vushtrri | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 02.07.2024 |
| **PËRMES:**<br>**PREKO:**<br>**THROUGH** | Direkt | **Nr. i Referencës:**<br>**Br. Referencije:**<br>**Reference No:** | 05/1-03 VSH-O / 073/ 24 |
| **PREJ:**<br>**OD:**<br>**FROM:** | Toger Shaban Salihi<br>Shef i Sektorit të Operativës<br>Stacioni policor Vushtrri | | |
| **LËNDA:**<br>**PREDMET:**<br>**SUBJECT:** | Raporti i sigurisë Janar-Qershor 2024 | | |

E nderuara Kryesuese z.nj Basholli/Latifi.

- Gjendja e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2024 vlerësohet e qetë dhe stabile. Gjatë periudhës raportuese, Stacioni Policor Vushtrri ka evidentuar gjithsej 590 raste, prej të cilave 430 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 160 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, numri i rasteve ka shënuar ngritje për 11.%.

- Me qëllim të ngritjes së sigurisë në bashkësi, SP-Vushtrri ka vazhduar përkushtimin e vet në promovimin dhe ndërtimin e partneritetit me komunitetin nëpërmes një numri të madh projektesh dhe një sërë aktivitetesh. Këto nisma kanë synuar parandalimin e krimit dhe realizimin e projekteve në vetëdijesimin dhe këshillimin e nxënësve në fusha të ndryshme të dukurive negative në shoqëri.

- Siguria në Trafikun rrugor:
  Siguria në trafikun rrugor vazhdon të mbetet sfidë. Për të adresuar këtë sfidë, SP-Vushtrri në vazhdimësi ka bërë përpjekje të mëdha që të përmirësohet edhe më tej siguria në trafikun rrugor. Kemi vazhduar me aktivitete të shumta policore, gjobat administrative i kemi shtuar për 39 %, numri i aksidenteve të trafikut rrugor ka rënë për rreth 2%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mbetet të punohet edhe më shumë në përmirësimin e gjendjes në trafikun rrugor.

- Veprat penale të armëve:
  Në operacione të ndryshme të ndërmarra, Policia ka konfiskuar 28 armë zjarri të llojeve të ndryshme, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 është shënuar një ngritje për 133%, si dhe janë konfiskuar 221 sasi të municionit të kalibrave të ndryshëm, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 është shënuar një ngritje për 904%.

- Veprat penale kundër narkotikëve:
  Bazuar në trendin e rritjes së kësaj dukurie negative dhe informacioneve të pranuara, kemi marr aktivitete shtesë në parandalimin e përdorimit dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, sidomos jemi fokusuar në afërsi të shkollave të mesme, në rrugët "Pandeli Sotiri" dhe "Marin Barleti" tek kafiteritë, si dhe në lokacione të ndryshme, sidomos nëpër qytet. Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi hasur në 30 raste me substanca narkotike dhe në pajisje për përdorimin e tyre, substancat narkotike dhe pajisjet janë konfiskuar dhe ndaj të dyshuarve janë iniciuar dhe proceduar rastet në bashkëpunim dhe koordinim me prokurorin kompetent të shtetit. Numri i rasteve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është shtuar për 30%.

- Rastet e dhunës në Familje:
  Rastet e dhunës në familje kanë shënuar ngritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak për 30%.

- Siguria në Shkolla:
  Në përgjithësi është stabile me trend të përmirësimit, gjithsej janë raportuar 4 raste në raport me 11 raste që kanë qenë në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përveç aktiviteteve operative nga Policia e Kosovës përkatësisht zyrtarët policor të stacionit policor Vushtrri kane vazhduar me mbajtjen e ligjëratave për nxënësit e shkollave të komunës së Vushtrrisë.

- Rastet me motive ndëretnike
  Në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë nuk ka pasur të raportuar asnjë rast me motive ndëretnike.

- Gjatë kësaj periudhe, Policia ka regjistruar gjithsej 2 protesta, në të cilat Policia e Kosovës ka kryer një varg të detyrave policore lidhur me këto protesta. Në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023 vërehet një ngritje e protestave.

- Përveç angazhimit policor në përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë të parapara për vitin 2024, gjatë kësaj periudhe, SP-Vushtrri ka ofruar mbështetje të vazhdueshme edhe autoriteteve të tjera relevante në përmbushjen e detyrave të tyre të përcaktuara me ligj, me ç 'rast janë ofruar 271 asistime. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, vërehet një ngritje e ofrimit të asistencës për 11%.

Me respekt!



Adresa: Rr. „Bedri Pejani" pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNAVUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **Për,** | Kuvendin e Komunës |
| **Propozues,** | Kryetari i Komunës ____________ |
| **Hartues,** | Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport ____________ |
| **Çështja për shqyrtim,** | Propozim-vendim |

---

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" dhe 14 paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 13 paragrafi 1 pika 1.4, 18 paragrafi 1 pika 1.13 dhe 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës 01nr.126/17 për Aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _________2024, merr këtë:

# V E N D I M
# PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIM TË LAPIDARIT NË FSHATIN DUMNICË E POSHTME

## Neni 1.

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtim të lapidarit për të rënët për Liri nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë, kundër pushtuesit serb, para, gjatë dhe pas luftës së dytë botërore.

## Neni 2.

Ndërtimi i lapidarit të bëhet në parcelën kadastrale P-70202026-00704-0, në sipërfaqe prej 450 $m^2$, vendi i quajtur "Shpoti", dhe në pjesë të parcelës kadastrale P-70202026-00703-0 në sipërfaqe prej 1500 $m^2$ nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3283 $m^2$, vendi i quajtur "Shpati Gazhjan", Zona Kadastrale Dumnicë e Poshtme, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

## Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë që do të bëjnë shenjëzimin e sipërfaqes në parcelën nga pika 1 e këtij vendimi si dhe regjistrimin në RDPP dhe dokumentat tjera te parapara me legjislacionin në fuqi.

## Neni 4.

Financimi i realizimit të këtij projekti do të bëhet nga komuniteti i fsh. Dumnicë e Poshtme. Këshilli i këtij fshati do të siguroj listën e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar.

**Neni 5.**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Kërkesa e përfaqësueseve të fsh. Dumnicë e Poshtme, Lista me nënshkrime, Lista e emrave të cilët do të shkruhen në lapidar dhe certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

**Neni 6.**

Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**
**Kryesuese e Kuvendit**

---

A r sy e t i m

Përfaqësues të fshatit Dumnicë e Poshtme me datën 07.06.2024 kanë bërë kërkesë për nderti, të lapidarit për të rënët për Lirin nga fshati Dumnicë e Poshtme, Komuna e Vushtrrisë, kundër pushtuesit serb, para gjatë dhe pas luftës së dytë botërore. Në kërkesë është theksuar se projektin për ndërtim si dhe financimin do ta bëjnë komuniteti i këtij fshati. Në këtë lapidarë do të shënohen emrat be të gjithë atyre të cilët janë vrarë, zhdukur dhe masakruar nga regjimi serb i asaj kohe.

Andaj, i propozohet kuvendit të komunës që të aprovoj këtë propozim vendim si në diapozitiv.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

18/1543

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : Komuna e Vushtrrisë

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | **18-1543/24** |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 12.06.2024 - 11:38 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen t | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Komuna e Vushtrrisë | | | / / | **600535001** | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | | | 28.12.2020 |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI | | AHMET KRASNIQI | VUSHTRRI | 28.12.2020 |

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprata/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202026-00703-0 | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI | Dumnicë E Poshtme / Dumnicë E Poshtme / Dumnicë E Poshtme | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | SHPATI/GAZHJAN / SHPATI/GAZHJAN / SHPATI/GAZHJAN | 3283 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 2 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 2 Klase / / Agriculture - pasture - 2nd Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |
| P-70202026-00704-0 | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI | Dumnicë E Poshtme / Dumnicë E Poshtme / Dumnicë E Poshtme | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë shoqërore Drushtvena Imovina Socially owned Land / | | SHPOTI / SHPOTI / SHPOTI | 450 | Shërbimet Publike - Varrezë - / / Javne Usluge - Groblje - / / PublicServices - cemetery - / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Dumnicë E Poshtme

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202026-00704-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 450 |
| P-70202026-00703-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3283 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1212

Punoi/Obradio/Created: Fadil Selimi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 12.06.2024

Koha/ Vreme/ Time: 11:43:29

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Fadil.Selimi


Auto
00703-0
00700-0
00701-0
02000-1
02000-2

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

# Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Kryetari i Komunës

**Data** 07/06/2024

**Mos shkruani në këtë pjesë**

**Numri i protokolit**
**02-104/02-0027203/24**

**Afati i zgjedhjes**
07/07/2024

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Qazim Azemi

**Numri personal**
1006536286

**Adresa e vendbanimit**
Vushtrri

**E-mail Adresa**
-

**Numri i tel. fiks**
-

**Numri i tel. mobil**
44414818

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit**
Kërkesa

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kerkese.

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Qazim Azemi vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** liridon.krasniqi

Për : Kryetarin e komunës së Vushtrrisë,
Z. Ferit Idrizi

Për : Drejtorinë e kadastrit dhe të gjeodezisë

Lenda : KËRKESË

Kërkojmë nga organet e sipërpermendura të na e dhenë lejën për ndërtimin e një monumenti për martiret e renë para, gjatë, dhe pas luftës së Dytë Botërore në Dumnicën e Poshtme - Vushtrri.

Mjetet për ndertimin e monumentit i heqin qytetarët e Dumnicës së Poshtme, respektivisht nga një donator - biznismen i tyre.

Nga komuna kërkojmë dhe presim ndihma teknike, konsulta dhe lejendertimin

Respekt nga këshilli organizativ:

1. Bilall Osmoni ________
2. Qazim Azemi ________
3. Nexhat Ibrahimi ________
4. Isa Abiti ________
5 Mentor Azemi ________

Më poshtë po i japim edhe disa nënshkrime të disa qytetarëve të Dumnicës së Poshtme :

Deshmorë e martirë të vrarë e të zhdukur, para, gjatë dhe pas LDB, periudha 1938 – 1946 nga Dumnica e Poshtme:

1. Asllan Salih Bullaku ........ 1938 ...... në Vushtrri,
2. Halit Azem Çuka ........ 1945 ........ zhdukur,
3. Ramë Halit Çuka ........ 1945 ........ në Kçiç të Madh
4. Mustafë Halit Çuka ........ 1945 ........ Zhdukur
5. Zenel Arif Latifi ........ 1945 ........ në Kçiç të Madh
6. Beqir Osman Osmani ........ 1945 ........ Karaqë
7. Ajet Hasan Hasani ........ 1945 ........ Karaçë
8. Tahir Hysen Bajrami ........ 1945 ........ Banat
9. Avdullah Emin Abazi ........ 1945 ........ Tivar
10. Jahir Selim Abazi ........ 1945 ........ Qyqavicë
11. Adem Zeqir Bekteshi ........ 1945 ........ zhdukur
12. Sefë Zeqir Bekteshi ........ 1945 ........ Pestovë
13. Nafë Zeqir Bekteshi ........ 1945 ........ zhdukur
14. Rushit Qazim Qerimi ........ 1945 ........ Kalldarnicë
15. Sejdi Kadri Kadriu ........ 1945 ........ Pasomë
16. Latif Kadri Kadriu ........ 1945 ........ Pasomë
17. Lan Beka ........ 1945 ........ Zhdukur
18. Liman Bekteshi ........ 1945 ........ në Banate,
19. Nebih Mehë Shabani ........ 1945 ........ në Banat
20. Felah Qerim Aliu ........ 1945 ........ mbi Pasomë
21. Dibran Beqiri ........ 1945 ........ zhdukur
22. Zenel Muharrem Beqiri ........ 1945 ........ Banat,
23. Emin Ramë Bekteshi ........ 1945 ........ Banat,
24. Azem Bit Abiti ........ 1945 ........ Zhdukur
25. Rushit Rexhë Rexha ........ 1945 ........ Tivar
26. Murat Rexhë Rexha ........ 1945 ........ Maxhunaj
27. Dibran Bekteshi ........ 1945 ........ në Banat

.................................................................................................

28. Ferat Jashar Zekolli ........ 1941 ........ Maxhunaj
29. Ismajl Halim Zekolli ........ 1941 ........ Maxhunaj
30. Riza Feriz Zekolli ........ 1941 ........ Maxhunaj
31. Xhemail Halim Zekolli ........ 1945 ........ Maxhunaj
32. Ragip Azem Zekolli ........ 1941 ........ Maxhunaj

– Të dhenat për këta martirë dumnicas kryesisht i kemi marrë nga veterani i arsimit Ahmet Selimi, 86 vjeçar i gjallë, nga urtaku e haxhiu Rizah Zekolli, i ndjerë dhe plaku i urtë Isa Azemi, i gjallë dhe kryefamiljarë të tyre, të martirëve.

Të dhenat i sistemuan:

1. Qazim Azemi dhe [signature]
2. Bilall Osmani

| Nr | Emri e mbiemri | Nënshk | Nr. letërnjoft. |
|---|---|---|---|
| 1 | Beqir Kadriu | Kadriu | 1004625141 |
| 2 | Lutfi Kadriu | [illegible] | 1004625052 |
| 3 | Xhemi Bekteshi | [illegible] | ~~1004624790~~ ~~044 2937~~ |
| 4 | AVNI BEKTESHI | [illegible] | 1004624664 |
| 5 | Bayram Syla | B S | 1013248032 |
| 6 | FATON SYLA | F S | 1176338845 |
| 7 | Sefet Beka | [illegible] | 1030429784 |
| 8 | Isa Abiti | ISA Abiti | 1004766306 |
| 9 | AZEM ABITI | AZEM Abiti | [illegible] ? |
| 10 | LIAZMEND | [illegible] SALIHI | 1004765601 1015241801 |
| 11 | Ramadan Salihu | R Salihu | 1021040629 |
| 12 | Halit Rexha | Rexha | 1013243642 |
| 13 | BESMIR REXHA | [illegible] | 1243005372 |
| 14 | FERIT REXHA | F Re | 1013245823 |
| 15 | Nexhat Ibrahimu | | ~~[illegible]~~ |
| 16 | Mentor Avdiu | Avdiu | 1004938590 |
| 17 | | | |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |

SKENDA BAJRAMI
049-197172

Republika e Kosovës                                                    Kuvendi i Komunës- Vushtrri

**Për: Kuvendin e Komunës**

**Propozues: Ferit Idrizi, Kryetari i Komunës**

**Hartues: Izet Miftari, Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Lënda: Propozim-vendim**

Bazuar në nenin 13.1. pika "a" të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr.02/L-26, nenit 12.2 "d", 14 .1 dhe 17 "c" lidhur me pikën "s" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 19, paragrafi 1, pika 4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më ________ **2024** mori këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fshatin Pasomë**

**Neni 1**

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e lapidarit në fshatit Pasomë pjesë nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe prej 613 m2, nga sipërfaqja të përgjithshme prej 89886 m2, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**

Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të patundshmërisë të cekur në neni 1 të këtij vendimi, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë që të bëjë ndërrimin e destiminit (kulturës) së kësaj parcele në elaboratin kadastral.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendim obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

________________________

**Melihate Basholli**

## Arsyetim

Banorët e fshatit Pasomë, përmes përfaqësuesit të tyre në Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë, z. Ali Januzi, i kanë paraqitur kërkesë kryetarit të komunës për mundësinë e ndërtimit të një lapidari në fshatin Pasomë, por edhe sigurimin një parcele kadastrale, në të cilën do të ndërtohej lapidari në nderim të patriotit shqiptar Adem Voca, në fshatin Pasomë.
Pas shqyrtimit të kërkesave, në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë është planifikuar ndërtimi i lapidarit dhe është identifikuar vendi ku do të mund të ndërtohej ai lapidar, pasi që prona në të cilën është propozuar nga banorët por edhe nga ekipi i zyrtarëve komunalë që kanë dalë në terren për të parë vendin e propozuar është pronë e Komunës së Vushtrrisë, në zonën kadastrale në Pasomë.
Duke vlerësuar se në atë vend kishte qenë më herët edhe kulla e patriotit shqiptar Adem Voca, edhe komisioni i caktuar nga komuna e Vushtrrisë për vlerësimin e atij vendi ka mbështetur propozimin dhe ka bashkëngjitur edhe dokumentet e nevojshme që anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të kenë mundësinë t'i shohin.

Prandaj Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport kërkon nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që ta mbështesë këtë propozim-vendim, me të cilin nga parcela kadastrale P-70202050-01296-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 89886 m2, me kulturë kullosë e kl.4 ZK P e cila evidentohet si pronë e Komunës së Vushtrrisë, sipërfaqja prej 613 m2 caktohet për ndërtimin e lapidarit për Adem Vocën.

*Bashkangjitur me këtë propozim-vendim, keni dokumentet dhe shkresat e nevojshme për çështje në fjalë:*
*- certifikatën e pronës*
*- kopjen e planit*
*- dy fotografi të pjesës së parcelës që planifikohet për ndërtim të lapidarit*

**Drejtor i DKRS-së**

**Izet Miftari**

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

18/3780

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202050-01296-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 18-3780/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 30.09.2022 - 10:48 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Pasomë / Pasomë / Pasomë |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type | Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type | Zona U/R G/S U/R | Sipërfaqja Površina Area (m²) | Përshkrim Opis Description | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202050-01296-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 89886 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur Mesto zvano Called place | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Emri i rrugës Naziv ulice Street name | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar, Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| SUVI BREG | | | | |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Valon.Maxhuni | P-70202050-01296-0 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klase/4th Class Pasture | 89886 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Vushtrrisë** | 600535001 | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | AHMET KRASNIQI | 1/1 | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Pasomë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202050-01296-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 89886 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:6016

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 30.09.2022

Koha/ Vreme/ Time: 10:51:55

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


347-0
314-0
20.5m
30.00m
S-613m2
20.5m


955-0
1296-0

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 498/24
Data / Datum 07. 05. 2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**

| | |
|---|---|
| PËR: | **Sekretarisë së Kuvendit**<br>**z.Benjamin Shala,**<br>**Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike** |
| PËR NJOFTIM: | z.Sabri Fejzullahu, Vushtrri |
| PËRMES: | |
| NGA: | Hadika Abdurrahmani, Bashkëpunëtore Profesionale në Zyrën e Kryetarit |
| TEMA: | Kërkesa, ju dërgohet për shqyrtim |

Të bashkangjitur keni kërkesën - Peticionin Nr.02-104/02-17682/24 të dt.22.04.2024, të z.Sabri Fejzullahu nga Vushtrria, në emër të banorëve, për rregullimin e një parku në fshatin Shallc dhe vënien e pllakës përkujtimore për ish komandantin e UÇK-së dhe Komandantin e Policisë së Kosovës z.Milaim Fejzullah.

Kërkesa në fjalë është vendosur që t'i dërgohet Sekretarisë së Kuvendit dhe Drejtorisë për Shërbime Publike për shqyrtim të mëtejmë.

Për çfarëdo vendimi që të merrni lidhur me këtë kërkesë duhet ta informoni kryetarin më së largu deri në mbledhjen e radhës me drejtor të drejtorive.

Njoftimi me shkrim lidhur me vendimin mbi kërkesën duhet të i dërgohet gjithashtu palës brenda afatit ligjor.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia**
Kryetari i Komunës

**Data** 22/04/2024

Mos shkruani në këtë pjesë

**Numri i protokolit**
**02-104/02-0017682/24**

**Afati i zgjedhjes**
22/05/2024

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri**
Sabri Fejzullahu

**Numri personal**
1005299582

**Adresa e vendbanimit**
Vushtrri

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil**
49164389

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit**
Peticion

**Statusi i lëndës**
Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kërkesë - Peticion

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Sabri Fejzullahu vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** florjana.krasniqi

PETICIJON ME DAT. 19.04.2024

KËRKOJM NGA KOM. E VUSHTRRIS QË TË NA JEP PELQIMIN PËR RREGULLIMIN E NI PARKU N FSHATIN SHALLC DHE NI PLLAK TË ISH KOMONDAN E UÇK SI DHE KOMONDANT E POLICIS SË KOSOVË ZI MILAIM FEJZULLAH

| EMRI | NR PER | | |
|---|---|---|---|
| SABRI FEJZULLAHU | 1005299582 | | VUSHTRI/SHALL |
| BASTRI FEJZULLAHU | 1021280867 | | VUSH/SHALL |
| BASHKIM FEJZULLAHU | 1232390812 | | VUSHTRRI SHALLC |
| DRIATIK SHALLCI | 1173869106 | | Shalc |
| INI FEJZULLAHU | 1001070655 | | Shallc |
| IAK Fejzullah | 1005109627 | | Shallc |
| AKIF FEJZULLAHU | 1003930340 | | Shalle |
| IZE KADRIU | 1004745171 | | Shalle |
| SAR FEJZULLAHU | 1244089034 | | SHALLC |
| TRIT FEJZULLAHU | 124088607 | | SHALLC |

KRYTAR MEHDI FEJZULL / NËN KRYTAR SABRI FEJZULLAHU

ADRESA RR. FARUK BEQIRI NR. 97


REPUBLIKA E KOSOVËS
LETERNJOFTIM
РЕПУБЛИКА КОСОВО
ЛИЧНА КАРТА
REPUBLIC OF KOSOVO
IDENTITY CARD
FEJZULLAHU
SABRI
30.08.1970
M
KOSOVAR
20.12.2026
SHALE
187761


21.12.201
MPB / MU / MIA
100529952
ID066527
VUSHTRR
IDRKSID06652761<<<<<<<<<<<<<<<
7008304M2612203RKS1005299582<1
FEJZULLAHU<<SABRI<<<<<<<<<<<<<

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202069-00341-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | Certificate draft |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 19.03.2024 - 10:20 |
| Komuna / Opština / Municipality: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Shalc / Shalc / Shalc |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | VUSHTRRI / VUĆITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-70202069-00341-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 959 | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendi i quajtur<br>Mesto zvano<br>Called place | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Emri i rrugës<br>Naziv ulice<br>Street name | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| ZHARI/FEJZULI BRDO | | | | |



DRAFT

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br 374/24
Nr. i Sq. / Br. st
Data: / Datum 18.04.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi" nr. 10, Tel.+383/38 20042402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | z.Sabri Fejzullahu, Vushtrri |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | |
| NGA/OD/FROM: | **Ferit Idrizi**<br>Kryetar i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje në kërkesë |

I referohemi kërkesës – Peticionit të juaj 02-104/01-15824/24 të dt.15.04.2024, në emër të banorëve të fshatit Shallc, për rregullimin e një parku në këtë fshat dhe vënien e një pllake për ish komandantitn Milaim Fejzullahu.

Kërkesa e juaj është shqyrtuar, me ç'rast ju njoftojmë se Peticioni nuk i plotëson kriteret sipas nenit 68, pika 6 te Statutit të Komunës së Vushtrrisë 209/22 të dt.06.09.2022, ku secili peticion duhet të përmbajë emrin dhe adresën e organizatorit, emrat, numrin e letërnjoftimit dhe adresat e personave të nënshkruar. Lënda e peticionit duhet të shënohet qartë, në çdo faqe të peticionit/ankesës.

Ju faleminderit për mirëkuptim;

**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**
**Kryetari i Komunës**

# INFORMATË
# LIDHUR ME ZBATIMIN E VENDIMEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
# JANAR – QERSHOR 2024

**Korrik 2024**

Bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, paraqitet kjo Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2024, si në vijim:

| **25 Janar dhe 01 shkurt 2024** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Vendimet e miratuara | Vendimet e zbatuara | Vendimet në procedurë të zbatimt | Vendimet e pa zbatuara | Arsyeja e mos zbatimit | Vërejtje |
| 1 | Vendim për ndarje të mjeteve financiare NPL "Përparimi" në Vushtrri | √ | | | | |
| 2 | Vendim për ofrim të mbështetjes financiare për shërim | √ | | | | |
| 3 | Vendim për ndryshim plotësim të vendimit për themelim të këshillit komunal për siguri | √ | | | | |
| 4 | Vendim për shfuqizim të vendimit të KK-së për miratimin e Planit për Integritet | √ | | | | |
| 5 | Vendim për ndarje të dy dekoratave "Nderi i Qytetit" | √ | | | | |
| 6 | Vendim për financim të shkollimit të fëmijëve të heronjve Enver Zymberi dhe Afrim Bunjaku | | √ | | | |
| 7 | Vendim për miratim të nismës për bashkëpunim ndërkomunal me komunat: | √ | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Podujevë dhe Obiliq për ndërtim të rrugës Barilevë-Bajgorë.<br>Sqarim: Vendimi është konfirmua nga MAPL por nuk kemi njoftime për nisma të bashkëpunimit nga komunat tjera. | | | | | |

| **Mars 2024** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Vendimet e miratuara | Vendimet e zbatuara | Vendimet në procedurë të zbatimit | Vendimet e pa zbatuara | Arsyeja e mos zbatimit | Vërejtje |
| 1 | Vendim për përkrahje financiare drilon. haradinaj | √ | | | | |
| 2 | Vendim për përkrahje financiare remzi rashica | √ | | | | |
| 3 | Vendim për ndryshim plotësim të vendimit për Këshillin komunal në bashkësi | √ | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Vendim për formim të komisioni vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës | √ | | | | |
| 5 | Vendim për formim të komisioni vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës | √ | | | | |
| 6 | Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë ( 99 vite ) të pronës së paluajtshme të komunës per veprimtari afariste (5 parcela: 3 në Stanoc të Poshtëm, dhe 2 në Vushtrri, | | √ Në seancën e radhës do të dorëzohet propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim | | | |
| 7 | Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtë ( 15 vite ) të pronës së paluajtshme të komunës për veprimtari bujqësore (5 parcela: 1 në Navalan, 1 në Prelluzhë, 1 në Kollë, 1 në Dumnicë të Llugës, 1 në Gjelbishtë. | | √ Në seancën e radhës do të dorëzohet propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim | | | |
| 8 | Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm “Shtëpi Muze” të shtëpisë së Selatin Gërgjaliut | √ | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm "Shtëpi Muze" të shtëpisë së Kahriman Pasomes | √ | | | | |
| 10 | Vendim për caktimin e Lokacionit për varreza të kafshëve | √ | | | | |
| 11 | Vendim për aprovimin e Planit Lokal për veprim për avancim të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali për periudhën 2024-2026 | √ | | | | |

| Prill 2024 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Vendimet e miratuara | Vendimet e zbatuara | Vendimet në procedurë të zbatimit | Vendimet e pa zbatuara | Arsyeja e mos zbatimit | Vërejtje |
| 1 | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për themelimin e komitetit për Politikë dhe Financa | √ | | | | |
| 2 | Vendim për aprovimin e Planit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës | √ | | | | |

| Në muajin maj ı **Nuk ka pas seancë të KK** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Vendimet e miratuara | Vendimet e zbatuara | Vendimet në procedurë të zbatimit | Vendimet e pa zbatuara | Arsyeja e mos zbatimit | Vërejtje |

| **Qershor 2024** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Vendimet e miratuara | Vendimet e zbatuara | Vendimet në procedurë të zbatimit | Vendimet e pa zbatuara | Arsyeja e mos zbatimit | Vërejtje |
| 1 | Vendim për formim të komisionit për shqyrtim të ankesave për rastet e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës | √ | | | | |

Sqarim: Për Vendimet tjera të muajit qershor 2024 ende nuk është kthyer nga MAPL përgjigje lidhur me ligjshmërinë.

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, janë miratuar gjithsejtë 21 vendime, nga të cilat, janë zbatuar 18, në procedurë janë 3 vendime.

Me Respekt!

**Ferit Idrizi**

Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosova ▪ Republic of Kosova

Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn ▪ Municipality of Vushtrri

| | |
|---|---|
| DATË/A | 04.07.2024 |
| REFERENC-Ë | 08Nr. 262/2024 |
| PËR/ZA/TO: | KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë |
| PËRMES: | Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DUMM)<br>U.D. Drejtor i drejtorisë Nexhat Merovci |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit |

Të nderuar,

Bazuar në Planin e punës së Kuvendit e cila ka të bëjë me informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ju njoftojmë se bazuar në investimet kapitale për këtë vit komuna ka realizuar projektet që ndikojnë në mbrojtjen e mjedisit siç janë projektet për gjelbërim, pastrimin e rrugëve, mbikëqyrja dhe përkujdesja e parqeve në pjesë të ndryshme të qytetit ku janë të përfshira edhe sektorët nga Drejtoritë përkatëse siç është Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.
Hap i rëndësishëm për ruajtjen e ambientit, mjedisit, infrastrukturës, krijimit të hapësirave të reja publike e të gjelbra është përgatitja për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal të ri për vitin 2024, pasi që plani aktual është i paraparë prej vitit 2016-2024, pas miratimit të PZHK-së të fillohet me Hartën Zonale Komunale si dhe në zonat ku është e nevojshme edhe Planet Rregulluese të Hollësishme. Planifikimi urban është çelësi për të ruajtur, kujdesur dhe zhvilluar tutje mjedisin urban dhe rural sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.
Komuna e Vushtrrisë është e vendosur që të planifikojë dhe definoj zhvillimin duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës. Komuna jonë karakterizohet nga veçoritë e saj të vlefshme natyrore si burimet ujore, kullotat, pyjet dhe trashëgimia unike historike dhe kulturore.
Reforma për menaxhim të mbeturinave është duke vazhduar grumbullimi i mbeturinave dhe transporti i tyre në deponi bëhet në vazhdimësi. Në bazë të Raportit për Vlerësimin e deponive ilegale (GIZ, ANMK dhe Komuna e Vushtrrisë). Gjendja e mjedisit është përmirësuar dukshëm, Po ashtu edhe ne si drejtori e cila bën rregullimin dhe shtruarjen e rrugëve duke përfshi qytetin dhe fshatrat ku edhe hasim në deponi të ndryshme të mbeturinave ilegale të cilat menjëherë i largojmë dhe ndikimet e tilla kanë rezultate pozitive për qytetarët si dhe bëhet përmirësimi në mbrojtjen e mjedisit.

Gjendja e Mjedisit është përmirësuar dukshëm, duke filluar nga menagjimi i mbeturinave ku kompania për menagjimin e mbeturinave Uniteti-Njësia Vushtrri ka bërë shtrirje të menagjimit në pothuajse në shumicën e territorit të komunës.

Gjithashtu jemi në implementim e sipër të sipërfaqeve të gjelbëruara si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Po ashtu në respektim të Udhëzimit Administrativ për gjobat mandatore Drejtoria e Ispekcionit me shkeljen e këtyre dispozitave ligjore kjo drejtori bën shqiptimin e gjobave për ndëshkimin e qytetarëve jo të ndërgjegjshëm të cilet po hudhin mbeturina vend e pa vend dhe ky ndëshkim nga Inspektoret po sjell ndikime pozitive në ambient.

Vlenë të theksohet se edhe vendosja e kanalizimit për Ujëra të zeza ka një ndikim pozitiv ku një gjë të tillë e kemi parandaluar pothuajse gati në të gjitha fshatrat sepse me vendosjen e kanalizimit ndalohet hedhja e ujërave të zeza në ambient të hapur –lumenj ku projektet e tilla në disa fshatra janë realizuar pothuajse në tersi dhe kanë një gjatësi me kilometra.

Bazuar në: Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit,
Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor,
Udhëzimi Administrativ Nr.01/2017 për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale i aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, obligohemi që gjatë procedurës së dhënës së Lejes Ndërtimore për objekte të cilat janë në listën për marrjen e Lejes Mjedisore Komunale gjatë këtij procesi ta njoftojmë palën dhe të kërkojmë nga pala pajisjen edhe me Leje Mjedisore Komunale.
Leja Mjedisore Komunale epet po nga ky organ pas aplikimit të palës i cili i plotëson kriteret sipas Raportit të prezantuar për ndikim të Lejes Mjedisore Komunale.
Po ashtu Komuna e Vushtrrisë ka hartuar edhe Planin e Veprimit Lokal në Mjedsit 2023-2026.

Bazuar në të cekurat më lartë Komuna e Vushtrrisë ka kontribuar vazhdimisht në përmirësimin dhe ruajtjen e Mbrojtjes së Ambientit në tërë territorin e Komunës si dhe veprime të tillë do të ndërmerren edhe në Vazhdimësi.

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës- Vushtrri**

---

**Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë**

**Propozues: kryetari i komunës z.Ferit Idrizi,** ____________

**Tema: Propozim-vendim**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, pika "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092, si dhe nenin 41 paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën **______2024** merr këtë:

## V E N D I M
## PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT LIDHUR ME FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIM TË PROCEDURAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi i kuvendit të komunës me nr. protokolli 63/24 i datës 28.03.2024 lidhur me formimin e Komisioni Vlerësues për zbatim të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ashtu që z. Kushtrim Hyseni, duhet të zëvendësohet me një tjetër anëtar të kuvendit pasi që i njëjti ka dhënë dorëheqje nga ky komision.

2. Pjesët tjera të vendimet me numër të protokollit Nr.01-63/24 i datës 28.03.2024 mbeten të pa ndryshuara.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: anëtari i Komisionit Vlerësues.

4. Ky vendim hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

______________________

**Kryesuese e Kuvendit**

## Arsyetim

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij vendimi, bëhet si rezultat sepse z.Kushtrim Hyseni anëtarë i kuvendit nga radhët e PDK-së, ka dhënë dorëheqje nga Komisioni për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme, sepse i njëjti është edhe anëtar i Komisionit për shqyrtim të ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, dhe kjo gjë bie në konflikt interesi. Me qellim të respektimit të kuadrit ligjor, dhe shmangien e konfliktit të interesit, i propozojmë kuvendit që aprovoj këtë propozim-vendim duke e zëvendësuar këtë anëtar të këtij komisioni.

HOME MAIL NEWS FINANCE SPORTS ENTERTAINMENT LIFE SEARCH SHOPPING YAHOO PLUS MORE...

Find messages, documents, photos or people Advanced

Compose

Back Archive Move Delete Spam

Inbox 1
Unread
Starred
Drafts
Sent
Archive
Spam
Trash
Less

Views Hide
Photos
Documents
Emails to myself
Subscriptions
Receipts
Credits
Travel

Folders Hide
+ New Folder
untitled

## Dorëheqje nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronave në shfrytëzim afatshkurtër

Yahoo/Inbox

**kushtrim hyseni**
**From:** kushtrimhyseni@yahoo.com
**To:** Melihate Basholli Latifi
**Cc:** Kuvendi Komunal

Wed, Jun 19 at 2:34 PM

Përshëndetje,

| 54007 TEKNOLOGJI INFORMATIVE PËR QKMF- VUSHTRRI | 20,000.00 | 0.00 | 20,000.00 | 0.00 |
| 54013 AUTOMJET TERENI PËR SHKPSH-VUSHTRRI | 30,000.00 | 0.00 | 30,000.00 | 0.00 |
| 54706 RREGULLIMI I SPORTELIT NË QMF- PANTINË DHE QKMF NË OBJEKTIN | 7,000.00 | 0.00 | 7,000.00 | 0.00 |
| 54707 APARAT PËR HEKUROSJE ROLE, DHE PAJISJE TJERA | 16,000.00 | 0.00 | 16,000.00 | 0.00 |
| 54708 KALLDA QILER NË OBJEKTIN E QMF-1 VUSHTRRI | 77,000.00 | 0.00 | 77,000.00 | 0.00 |
| 54709 KOMBI PËR HEMODIALIZË SKPSH-VUSHTRRI | 39,000.00 | 0.00 | 39,000.00 | 0.00 |
| 54710 REHABILITIMI I OBJEKTEVE SHËNDETËSORE DHE RRETHOJAVE PËR QKM | 70,000.00 | 20,000.00 | 50,000.00 | 28.57 |
| 54711 INVENTOR PËR LABORATOR PËR QKMF- VUSHTRRI | 10,000.00 | 0.00 | 10,000.00 | 0.00 |
| 75616 SHËRBIMET SOCIALE - VUSHTRRI | 11,069.03 | 8,000.00 | 3,069.03 | 72.27 |
| 53626 RREGULLIMI I NYJEVE SANITARE PËR QPS - VUSHTRRI | 69.03 | 0.00 | 69.03 | 0.00 |
| 53629 BLERJA E GJENERATORIT PËR QPS VUSHTRRI | 1,000.00 | 0.00 | 1,000.00 | 0.00 |
| 54950 REHABILITIMI I OBJEKTIT TË QPS- VUSHTRRI | 10,000.00 | 8,000.00 | 2,000.00 | 80.00 |
| 75617 SHËRBIMET REZIDENCIALE - VUSHTRRI | 16,136.26 | 0.00 | 16,136.26 | 0.00 |
| 53625 BLERJA E VETURËS PËR SHËRBIMET REZIDENCIALE | 1,136.26 | 0.00 | 1,136.26 | 0.00 |
| 54954 REHABILITIMI I OBJEKTIT TË QR - VUSHTRRI | 15,000.00 | 0.00 | 15,000.00 | 0.00 |
| 85024 SHËRBIMET KULTURORE - VUSHTRRI | 257,830.77 | 20,000.00 | 237,830.77 | 7.76 |
| 51007 RENOVIMI I PALESTRËS ,,JETON TERRSTENA" | 0.75 | 0.00 | 0.75 | 0.00 |
| 52299 BLERJA E MONITORIT LED ME PËRMASA 3X5 PËR SKENËN E SALLËS NË | 695.00 | 0.00 | 695.00 | 0.00 |
| 52825 RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I OBJEKTIT "ARKIVI I VJETËR" ISH F | 30,000.00 | 0.00 | 30,000.00 | 0.00 |
| 52877 NDËRTIMI I NJË SKULPTURE ME KARAKTER ARTISTIK (PARA QENDRËS | 130.00 | 0.00 | 130.00 | 0.00 |
| 53632 RIKONSTRUKTIMI I MUZEUT "MAHMUT AGË GJINOLLI" | 2,000.00 | 0.00 | 2,000.00 | 0.00 |
| 53991 RENOVIMI I PALESTRES "JETON TERSTENA" | 5.00 | 0.00 | 5.00 | 0.00 |
| 54727 RREGULLIMI I MEMORIALEVE NË GLLAVOTIN, REZNIK, BEÇIQ, DUBOC, | 35,000.00 | 0.00 | 35,000.00 | 0.00 |
| 54731 REHABILITIMI I PLATOSË NË KALANË E QYTETIT | 30,000.00 | 20,000.00 | 10,000.00 | 66.67 |
| 54735 NDËRTIMI/RIKONSTRUIMI I FUSHAVE SPORTIVE MAXHUNAJ, LUMMADH, | 100,000.00 | 0.00 | 100,000.00 | 0.00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 54743 NDËRTIMI I TRIBUNAVE, DHE OBJEKTEVE PËRCJELLËSE NË SADIUMIN | 60,000.00 | 0.00 | **60,000.00** | **0.00** |
| 92060 NGRITJA E PERFORMANCES 2019 | 0.02 | 0.00 | **0.02** | **0.00** |
| **92670 ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET - VUSHTRRI** | **60,345.55** | **30,000.00** | **30,345.55** | **49.71** |
| 53069 NDËRTIMI I DEPOSË PËR FOLEJA III VUSHTRRI | 152.34 | 0.00 | **152.34** | **0.00** |
| 53072 NDËRTIMI I DEPOSË PËR FOLEJA II | 193.21 | 0.00 | **193.21** | **0.00** |
| 54865 REHABILITIMI I ÇERDHES ,,FOLEJA- VUSHTRRI | 60,000.00 | 30,000.00 | **30,000.00** | **50.00** |
| **93690 ARSIMI FILLOR - VUSHTRRI** | **710,380.58** | **284,406.10** | **425,974.48** | **40.04** |
| 51854 Ndërtimi i tualeteve ne SHMU ,,Emin Duraku" | 222.39 | 0.00 | **222.39** | **0.00** |
| 51866 Meremetimi i SHMU,,Enver Hadari" - Smrekonicë | 350.00 | 0.00 | **350.00** | **0.00** |
| 51869 Meremetimi i SHFMU "Mihaliq" | 550.00 | 0.00 | **550.00** | **0.00** |
| 51870 Meremetimi i SHFMU "Rexhep Musa" | 532.00 | 0.00 | **532.00** | **0.00** |
| 52463 RENOVIMI I SHFMU "MIGJENI" STANOC LAGJA CAKAJ | 17,910.00 | 0.00 | **17,910.00** | **0.00** |
| 52464 RENOVIMI I SHFMU "LUMNI SURDULLI" SAMADREXHË | 3,980.95 | 0.00 | **3,980.95** | **0.00** |
| 52465 RENOVIMI SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË | 3,525.78 | 0.00 | **3,525.78** | **0.00** |
| 52779 NDËRTIMI I PLATOS PËR SHFMU "EMIN DURAKU " | 4,101.50 | 0.00 | **4,101.50** | **0.00** |
| 52781 NDËRTIMI I DEPOS NE SHFMU "ADEM VOCA "PASOMË | 147.70 | 0.00 | **147.70** | **0.00** |
| 52910 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MIGJENI " LAGJA CAKAJ | 147.70 | 0.00 | **147.70** | **0.00** |
| 52913 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MIGJENI" STANOC | 363.00 | 0.00 | **363.00** | **0.00** |
| 52961 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "ENVER HADRI" SMREKONICË | 279.00 | 0.00 | **279.00** | **0.00** |
| 52967 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHF. "ALI KELMENDI" VUSHTRRI | 773.80 | 0.00 | **773.80** | **0.00** |
| 52995 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "7 MARSI" BUKOSH | 204.70 | 0.00 | **204.70** | **0.00** |
| 53000 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "AVDYL FRASHËRI" DRUAR | 185.70 | 0.00 | **185.70** | **0.00** |
| 53024 NDËRTIMI I SHFMU "MUSTAF VENHARI " | 150,000.00 | 150,000.00 | **0.00** | **100.00** |
| 53032 RENOVIMI I SHFMU "LATIF BERISHA" DOBERLLUKË | 5,000.00 | 3,143.60 | **1,856.40** | **62.87** |
| 53051 RENOVIMI I SHFMU "LIRIA " STROC GLLAVOTIN | 3,099.54 | 0.00 | **3,099.54** | **0.00** |
| 53052 RENOVIMI I SHFMU REZNIK | 640.00 | 0.00 | **640.00** | **0.00** |
| 53053 RENOVIMI I SHFMU -MIHALIQ | 2,000.00 | 1,262.50 | **737.50** | **63.13** |
| 53054 RENOVIMI I SHFMU "RILINDJA" MAXUNAJ | 3,506.72 | 0.00 | **3,506.72** | **0.00** |
| 53055 RENOVIMI I SHF "ALI KËLMENDI" | 925.55 | 0.00 | **925.55** | **0.00** |
| 53533 NDËRTIMI I PLATOS PËR SHFMU "28 NËNTORI" VËRNICË | 3,469.00 | 0.00 | **3,469.00** | **0.00** |
| 53713 NDËRTIMI I DEPOSË PËR SHFMU "MARTIRËT" REZNIK | 234.70 | 0.00 | **234.70** | **0.00** |
| 53968 MEREMETIMI I SHMU - 1 VUSHTRRI | 3,230.85 | 0.00 | **3,230.85** | **0.00** |
| 54749 REHABILITIMI I OBORRIT NË SHKOLLËN SHMU II | 30,000.00 | 0.00 | **30,000.00** | **0.00** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 54755 REHABILITIMI I DHOMAVE TË PARAFILLORËVE VUSHTRRI | 60,000.00 | 10,000.00 | 50,000.00 | 16.67 |
| 54805 NDËRTIMI I DEPOVE PËR SHKOLLA NË PESTOVE,"RILINDJA", "BAHRI | 70,000.00 | 0.00 | 70,000.00 | 0.00 |
| 54811 REHABILITIMI I ARKIVËS NË SHF ALI KELMENDI VUSHTRRI | 15,000.00 | 0.00 | 15,000.00 | 0.00 |
| 54821 REHABILITIMI I SHFMU MUSTAFË SHYTI OSHLAN | 50,000.00 | 0.00 | 50,000.00 | 0.00 |
| 54890 REHABILITIMI I SHFMU,,ENVER HADRI" SMREKONICË | 80,000.00 | 0.00 | 80,000.00 | 0.00 |
| 55026 NDËRTIMI I SHKOLLËS FILLORE "MUSTAFË VENHARI"- VUSHTRRI | 200,000.00 | 120,000.00 | 80,000.00 | 60.00 |
| **94890 ARSIMI I MESËM - VUSHTRRI** | **205,683.29** | **8,175.39** | **197,507.90** | **3.97** |
| 51874 Paisje për praktike profesionale SHMP "Bahri Haxha" | 3,337.08 | 0.00 | 3,337.08 | 0.00 |
| 51875 Kaldaja për ngrohje qendrore "Lutfi Musiqi"SHMU II | 10,852.16 | 0.00 | 10,852.16 | 0.00 |
| 52446 MEREMETIMI I GJIMNAZIT "EQREM ÇABEJ " | 520.00 | 0.00 | 520.00 | 0.00 |
| 52462 MEREMETIMII I SHMT "LUTFI MUSIQI " VUSHTRRI | 5,000.00 | 0.00 | 5,000.00 | 0.00 |
| 52716 TEKNOLOGJI INFORMATIVE SHMT "LUTFI MUSIQI" | 8,660.00 | 0.00 | 8,660.00 | 0.00 |
| 52758 TEKNOLOGJI INFORMATIVE GJIMNAZI "EQREM ÇABEJ" VUSHTRRI | 5,021.00 | 0.00 | 5,021.00 | 0.00 |
| 52768 TEKNOLOGJI INFORMATIVE SHMP :BAHRI HAXHA" | 1,567.00 | 0.00 | 1,567.00 | 0.00 |
| 52775 BLERJA E PAJISJEVE TË TI (TELEVIZOR ) " BAHRI HAXHA" | 3,000.00 | 0.00 | 3,000.00 | 0.00 |
| 53688 BLERJA E PAIJISJEVE PËR PRAKTIKË SHMT "LUTFI MUSIQI" | 5,000.00 | 0.00 | 5,000.00 | 0.00 |
| 53970 NDE PUNETORISE DHE KABINETEVE NE SHMT LUTFI MUSIQI VUSHTRRI | 16,992.00 | 0.00 | 16,992.00 | 0.00 |
| 54912 NDËRTIMI I PUNËTORISË PËR AUTOMEKANIK DHE METALPUNUES NË SHM | 45,000.00 | 5,000.00 | 40,000.00 | 11.11 |
| 54967 RREGULLIMI I PLATOS SE LAPIDARIT ,,LUTFI MUSIQI" | 5,000.00 | 0.00 | 5,000.00 | 0.00 |
| 54972 NDËRTIMI I POLIGONIT NË SHMT LUTFI MUSIQI | 30,000.00 | 0.00 | 30,000.00 | 0.00 |
| 54976 REHABILITIMI I TUALETEVE NË SHMP BAHRI HAXHA VUSHTRRI | 35,000.00 | 0.00 | 35,000.00 | 0.00 |
| 54990 REHABILITIMI I FUSHËS SPORTIVE NË SHMP BAHRI HAXHA | 20,000.00 | 0.00 | 20,000.00 | 0.00 |
| 54992 NDËRTIMI I KLASËVE VERORE NË GJIMNAZIN EQREM ÇABEJ VUSHTRRI | 10,000.00 | 0.00 | 10,000.00 | 0.00 |
| 93222 RREGULLIMI I SHKOLLES BAHRI HAXHA | 577.05 | 0.00 | 577.05 | 0.00 |
| 95104 FURNIZ.MJETE PER PUNTOR SALDATOR-AXHUSTATOREVE | 157.00 | 0.00 | 157.00 | 0.00 |
| **Totali I Përgjithshëm** | **8,176,845.45** | **2,523,714.10** | **5,653,131.35** | **30.86** |

**Republika e Kosovës** **Komuna e Vushtrrisë**

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës
Hartues: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë
Tema: Propozim – vendim

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike, nenit 19 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit të datës 24.03.2022 me numër reference AKK-DPKI-06-1655/21 si dhe bazuar në Rekomandimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të datës 31 mars 2021, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më .....................2024 merr këtë::

# VENDIM
## PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës se paluajtshme te komunës në Parkun Industrial në Lumadh, bizneseve private, nga parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive biznesore si vijon:

2.1.Solid Group SHPK;

2.2.Druri SHPK;

2.3.BTP Holding SHPK;

2.4.Timber Home SHPK.;

2.5.Time N.T.P;

2.6.Unikonzum;

2.7.Mateo Company SH.P.K;

2.8.Homestar N.T.P;

2.9.Vazo SH.P.K;

2.10.Bunsam Metal SH.P.K;

2.11.Euro Driloni;

2.12.Bina SH.P.K;

2.13.RaEximp SH.P.K;

2.14.Emona Center SH.P.K;

2.15.Berto SH.P.K;

2.16.Te Duli D.P.Z;

2.17.Trios Grup SH.P.K;

2.18.Bvd Ing.SH.P.K;

2.19.AH Invest SH.P.K;

2.20.Ajna Cake SH.P.K;

2.21.Union SH.P.K;

2.22.7 Vëllezërit SH.P.K.

3. Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë aneks kontratë me secilin përfaqësues të biznesit të cekur në pikën 2 (dy) të këtij vendimi, brenda afatit prej 10 ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit.

4. Prona e paluajtshme e komunës iu jepet në shfrytëzim bizneseve/subjekteve ekonomike në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.

5. Bizneset e cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi, në tri vitet e para nga data e nënshkrimit të aneks kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në çdo vit.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: rekomandimi i komisionit vlerësues dhe konfirmimi i ligjshmërisë së Ministrisë së Pushtetit Lokal i konstatuar në procedurë të konsultimit paraprak konform nenit 83 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe opinioni i Agjencisë |kundër korrupsionit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

8.Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal , se dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

MelihateBasholli-Latifi
Kryesuese e Kuvendit

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me datën 16.04.2021 ka aprovuar vendimin 01.Nr.81/21 për dhënien ne shfrytëzim afatgjate te pronës se paluajtshme te komunës në fshatin Lumadh, vendim ky i cili pas dërgimit për vlerësim të ligjshmërisë ne MAPL- sipas dispozitave ligjore në fuqi, është vlerësuar se është në përputhje me legjislacionin ne fuqi, ku vlerësimin e vet e kanë dhënë, Ministria e Industrisë Ndërmarsisë dhe Tregtisë, me shkresën nga MAPL-ja të datës 30.04.2021 me Nr.020-363/3.
Mirëpo pas ngritjes se çështjes pran Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për shkak dyshimeve për konflikt të interesit me rastin e votimit në mbledhjen e Kuvendit të komunës datë 16.04.2021, Agjensia përmes parashtresës-opinionit të datës 24.03.2022 me numër reference AKK-DPKI-06-1655/21 ka konstatuar se dy këshilltar të Kuvendit që kanë marr pjesë në votim kanë pasur konflikt interesi dhe Agjencia ka kërkuar që propozim vendimi te kthehet në riprocedurë/rivotim.
Pas marrjes së këtij opinioni, Kuvendi i Komunës, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë në opinionin në fjalë me datën 31.01.2023 e ka shfuqizuar vendimin 01.Nr.81/21 të datës 16.04.2021 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, me vendimin Nr.27/23.
Me qenë se komuna e Vushtrrisë ka hyrë në obligime kontraktuale me operator ekonomik sipas vendimit të më parmë dhe se kontratat e nënshkruara me operatoret ekonomik përfitues ende janë ne fuqi, kurse referuar nenit 3, 7, 8 dhe 10 të kontratave, komuna si autoritet kontraktues- dhënës në shfrytëzim i pronës komunale ka marr obligime dhe ka ofruar garanci për zbatimin e atyre kontratave. Ndërsa mos zbatimi i këtyre kontratave nga ana e komunës bazuar në nenet e sipërcituara do të prodhonte pasoja juridike – financiare të pa përballueshme dhe të pa imagjinueshme për komunën po qe se, kjo përfundon në gjykatë, pasi që për moszbatimin e kontratave në fjalë nuk janë fajtor operatoret ekonomik përkatësisht marrësit në shfrytëzim të pronës komunale por përgjegjësia bie ekskluzivisht mbi Komunën e Vushtrrisë.
Ju njoftojmë poashtu se disa operatorë ekonomik i janë drejtuar me parashtresa Kryetarit të Komunës, ku përmes këtyre parashtresave të njejtit kanë kërkuar implementimin e kontratave në fjalë respektivisht krijimin e mundësive për fillimin e ndërtimit të objekteve konform projekteve të dorëzuara.
Kanë kërkuar gjithashtu që brenda afatit 15 ditor të informohen nga ana e komunës lidhur me kërkesën e tyre, në të kundërtën të njetit kanë tërhequr vërejtjen se do të i drejtohen gjykatës kompetente përmes padisë.

Andaj, nga të cekurat më lartë i propozoj kuvendit të komunës që t'a aprovojnë këtë propozim vendim si në dispozitiv.

DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-363/14
Data: 24.06.2024

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

Datë: 28.05.2024
Nr.020-363/13

**Për:** Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

**Lënda:** Kërkesë për konsultim paraprak

I nderuar, z. Idrizi

Ministria e Pushtetit Lokal (MAPL), ka pranuar kërkesën për konsultim paraprak Nr.020-363/13 nga ju, lidhur me Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në fshatin Lumadh në komunën e Vushtrrisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën I, pika 9 të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të kërkesës sqaron se:

- Procedurat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale brenda Parkut Industrial rregullohen me Ligjin Nr. 08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2014 (MTI) për Procedurën, Formën dhe Përmbajtjen e Konkursit, Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike;

- Propozim vendimi është në rregull, përveç bazës ligjore ku është vendosur Rregullorja (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës se paluajtshme të Komunës. Pra, nga baza ligjore duhet të largohet rregullorja në fjalë pasi që është fjala për dhënien në shfrytëzim të pronës në Parqet industriale, e cila rregullohet me më nenin 12, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 08/L-208 për Parqet Industriale dhe Teknologjike.

MAPL, është e gatshme të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt

Elbert Krasniqi,
Ministër i MAPL-së

**Kopje:** *Jeton Qela, U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL-së*

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-363/14
Data 14.06.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government*

Dana, 28.05.2024.
br.020-363/13

**Za:** Ferit Idrizi, gradonačelnik opštine Vučitrn

**Predmet:** Zahtev za preliminarnu konsultaciju

Poštovani g. Idrizi

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), primilo je Vaš zahtev za preliminarnu konsultaciju sa br.020-363/13 u vezi sa predlogom odluke o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine u Industrijskom parku u selu Lumadh (Velika Reka) u opštini Vučitrn.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave (MALS), u skladu sa svojim mandatom utvrđenim Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi prilogom 1 tačka (9) Uredbe VRK-a br. 14/2023 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava, nakon razmatranja zahteva pojašnjava da:

- Postupci za davanje na dugoročno korišćenje nepokretne imovine opštine unutar Industrijskog parka, regulišu se Zakonom br. 08/L-208 o industrijskim i tehnološkim parkovima i Administrativnim uputstvom MTI-a br. 03/2014 za postupak, oblik i sadržaj konkursa, uslovi i kriterijumi za plasman privrdnih subjekata u prostorijama industrijskih (privrednih) zona .

- Predlog odluka je u redu, osim pravne osnove gde je uspostavljena Uredba VRK br. 09/2020 o utvrđivanju postupaka za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine. Dakle, iz pravne osnove treba da se izbaci nevedena uredba, pošto je reč o davanju na korišćenje imovine i industrijskim zonama (parkovima), koja se reguliše članom 12, stav 2, Zakona br. 08/L-208 o industrijskim i tehnološkim parkovima.

MALS, je spreman da pruža neophodnu pomoć i podršku za sprovođenje obaveza koje proizilaze iz primenljivog zakonodavstva na snazi o lokalnoj samoupravi u Republici Kosovo.

S poštovanjem,

Elbert Krasniqi, ministar MALS-a

**Kopija:** *Jeton Qela*, v.d. generalnog sekretara MALS-a
*Arhiva MALS-a.*

REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVO, R
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr./Br./Nr: 570/24
Nr.Lig./Ult.at
Data / Datum: 14.05.2024
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | **z. Jeton Qela,** UD. i Sekretarit të përgjithshëm i MAPL-së, **z. Erblin Hetemi,** UD. i Departamenti Ligjor dhe Monitorimit të Komunave |
| **NGA/OD/FROM:** | **Ferit Idrizi,** Kryetar i Komunës së Vushtrrisë |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Kërkesë për konsultim paraprak** |

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 17.05.2024
-VI- 020-363/13

I nderuar z. Qela,

I nderuar z. Hetemi,

Bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale kërkojmë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si autoritet mbikëqyrës i komunave të Republikës së Kosovës që të jap një opinion ligjor lidhur me ligjshmërinë e propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh, bizneseve private.

Me qëllim të zbatimit të drejt të dispozitave të legjislacionit që rregullojnë këtë fushë si dhe marrjes së një vendim të ligjshëm, kërkojmë dhe presim një përgjigje me shkrim brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë ju dërgojmë propozim-vendimin si dhe opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit me të cilin është kërkuar rishqyrtimi i vendimit të KK-së nr. 81/21 datë 16.04.2021.

Paraprakisht ju falënderojmë për bashkëpunim!

Me respekt!

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Komuna Vushtrri**
Opstina Vucitrn - Municipality of Vushtrri

## KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

Me datë: 31.03.2021

Në bazë të Nenit 19, paragrafi 3, të Ligjit për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Nenit 21 të Projekt Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Statutit të Komunës, Komisioni vlerësues propozon këtë:

## REKOMANDIM

Në bazë të këtij Rekomandimi Komisioni për Vlerësim të Ofertave për Park të Biznesit në Fshatin Lumadh-Vushtrri për Parcelat P-702020011-00435-1 dhe P-702020011-00435-3 me sipërfaqe totale prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, njofton anëtarët e Kuvedit Komunal të Vushtrrisë se kanë aplikur gjithësejt 43 biznese për vendosje në Parkun e Biznesit, nga të cilët 22 prej tyrë kanë plotësuar dokumentacionin në tërësi në bazë të Kushteve dhe Kritereve të përcaktuara me Vendim të Kuvendit nr. 269/20 të dt. 30.12.2020, të listuar më poshtë:

Solid Group Sh.p.k.; Druri Sh.p.k.; B.t.p. Holding Sh.p.k.; Timber Home Sh.p.k.; Time N.t.p.; Unikonzum; Mateo Company Sh.p.k.; Homestar N.t.p.; Vazo Sh.p.k.; Bunsam Metal Sh.p.k.; Euro Driloni; Bina Sh.p.k.; Ra Eximp Sh.p.k.; Emona Center Sh.p.k.; Berto Sh.p.k.; Te Duli D.p.z.; Trios Group Sh.p.k.; Bvd Ing. Sh.p.k.; AH Invest Sh.p.k.; Ajna Cake Sh.p.k.; Union Sh.p.k.; 7 Vëllëzërit Sh.p.k.

Komisoni vlerësues njofton Kuvendin Komunal të Vushtrrisë se nga aplikuesit e mësipërm në zonën e parë (I) deri në 50 ari janë rekomanduar 13 biznese, në zonën e dytë (II) 50 ari deri 1 ha janë rekomanduar 6 biznese ndërsa në zonën e tretë (III) mbi 1 ha janë rekomanduar 3 biznese.

Vlera Investive e Bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh do të jetë 22 milion € dhe me punësim të ri të planifikuar mbi 800 persona.

Veprimtaritë që do të zhvillohen në Parkun Industrial do të jenë veprimtari afariste të cilat nuk cenojnë rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
Bizneset të cilat janë rekomanduar nga komisioni janë biznese me veprimtari prodhuese, përpunuese, shërbyese si dhe ato të cilat kanë numër më të madh të punëtorëve.

Krijimi i zonës ekonomike në Lumadh-Vushtrri ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Vushtrri duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim të veprimtarive; të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Komunën e Vushtrrisë, veçanërisht në sektorin privat; hapjen e vendeve te reja te punës dhe krijimin e të ardhurave; tërheqjen e teknologjive të përparuara; përqendrimin e bizneseve në Vushtrri; zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve; krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në lidhje, transport dhe shërbime në mbështetje të biznesit; rritjen e konkurrencës në biznesin vendor etj.

Përparësitë që ofrohen nga Parku i Biznesit në Lumadh fillojnë nga hapësirat e gatshme dhe komode për akomodim të Bizneseve, lokacion i përshtatëshëm për transportin e mallrave dhe shërbimeve në tërë territorin e Kosovës si dhe qasja e lehtë nga Magjistralja M2 deri në lokacion, hapësirë për parkim, siguri të plotë, qasje në rrymë, ujë, telefoni dhe internet.

Pjesë përbërëse e rekomandimit është edhe skica e vendosjes sipas veprimtarive dhe hapësirës adekuate për secilin biznes.

Komisioni në mënyrë unanime ka përkrahur dhe votuar vendosjen e këtyre bizneseve gjithësejt 22 biznese në zonën ekonomike në Lumadh dhe i propozon asamblesë Komunalë në Vushtrri që ashtu sic është vendosur nga komisioni i përzier nga Kuvendi dhe Qeveria Komunale ta përkhrahin dhe ti japim shtytje zhvillimit, punësimit dhe progresit të Komunës sonë.

Bizneset e aprovuara nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin e kërkuar sipas Vendimit me nr. 269/20 të dt. 30.12.2020.

Kryesuesi i Komisionit

Adnan LAHU

DPK KI 13

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 24.03.2022 |
| REFERENC-E: | AKK-DPKI-06-1655/21 |
| PËR/ZA/TO: | znj. Melihate Basholli - Latifi,<br>Kryesuese e Kuvendit Komunal në Vushtrri<br>z. Ferit Idrizi,<br>Kryetar i Komunës së Vushtrrisë |
| CC: | z. Ilmi Azemi,<br>Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri<br>z. Fitim Halili,<br>Ish.Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri<br>znj.Venera Çerkini<br>Zëvendës Sekretare e përgjithshme në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Yll Buleshkaj,<br>Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit |
| NGA/OD/FROM: | Esad Ejupi,<br>Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | **OPINION** lidhur me trajtimin e rastit të konfliktit të interesit |

E nderuara znj. Basholli - Latifi,

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar dy kërkesa të ndara (raportues të rastit) për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit, lidhur me pretendimet si në vijim;

Pretendimi i parë, lidhet me atë se; z. Ilmi Azemi, duke qenë Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal së Vushtrrisë të datës 16.04.2021 ka deklaruar konflikt interesi në raport me biznesin Sh.P.K "Mateo Company", por ka abstenuar në votim, e që duke abstenuar në votim, i ka mundësuar Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të bëjë



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

kuorumin lidhur me vendimmarrjen nr.81/21, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh".

Pretendimi i dytë, lidhet me atë se; z. Fitim Halili, duke qenë Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë lidhur me vendimmarrjen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", të datës 16.04.2021, ka deklaruar konflikt interesi, por ka abstenuar në votim, e që duke abstenuar në votim, i ka mundësuar që Kuvendi Komunal të bëjë kuorumin për vendimmarrje. Kjo për shkak se bashkëshortja e tij znj. Nurije Halili, me biznesin SH.P.K "Bina", ka qenë e rekomanduar për dhënien e paluajtshmërisë në shfrytëzim afatgjatë në parkun industrial në "Lumadh".

Agjencia kundër Korrupsionit konform kompetencave të saj të përcaktuara me Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit në fjalë, në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr.03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 21 (paragrafi 1, nën paragrafët 1.4, 1.5 dhe 1.7) të LPKI-së, pas vlerësimit të rrethanave lidhur me rastin konkret, Agjencia ofron këtë:

## OPINION

- Ekziston konflikt i interesit për zyrtarin e lartë z. Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, lidhur me pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të datës 16.04.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim bizneseve private, pronën e paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", ku në mesin e të përzgjedhurve ishte znj. Fllanza Sadiku - Azemi, me të cilën ka lidhje familjare (bashkëshortja e djalit të vëllait).
- Ekziston konflikt i interesit për zyrtarin e lartë z. Fitim Halili, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri lidhur me pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë të datës 16.04.2021, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të bizneseve private, pronën e paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", ku në mesin e përfituesve ishte edhe znj Nurije Halili, me të cilën ka lidhje familjare (bashkëshortja).



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

## ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit duke u bazuar në Ligjin nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, ka njoftuar zyrtarët e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin të gjendjes së konfliktit të interesit. z. Ilmi Azemi dhe z. Fitim Halili, nuk janë përgjigjur shkresës së Agjencisë lidhur me sqarimin e situatës së pretenduar për konflikt interesi.

Me qëllim të sqarimit të këtij rasti Agjencia ka kërkuar dokumentacionin dhe informatat shtesë nga Komuna e Vushtrrisë lidhur me procesin vendimmarrës për dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh", (shkresa me nr protokolli 06-02-1727/21). Duke vepruar sipas kërkesës në fjalë Komuna e Vushtrrisë ka dërguar në Agjenci dokumentacionin e kërkuar (shkresa me nr. protokolli 35183/21).

Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar dhe pranuar dosjen për vendosjen e ligjshmërisë së vendimit nr.81/21 nga Ministria e Pushtetit Lokal. Shkresat me nr.(06-02/2019/21 - 020-363/5).

Agjencia kundër Korrupsionit ka analizuat kërkesat e raportuesve të rastit, dokumentacionin e pranuar nga Komuna e Vushtrrisë dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal, provat e siguruara sipas detyrës zyrtare dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim;

- Me datë 26.11.2020, Komuna e Vushtrrisë ka nxjerr vendim paraprak me nr.239/20 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.

- Kuvendi Komunal në Vushtrri me datë 26.11.2020 ka nxjerrë vendim me nr. 269/20 për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në parkun industrial në Lumadh.

- Kuvendi Komunal në Vushtrri me vendimin nr.240/2020 të datës 26.11.2020 ka formuar komisionin për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh". Pjesë përbërëse e këtij komisioni ishte edhe Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri.

- Komisioni për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh", me datë 16.04.2021, ka shpallë njoftimin për përzgjedhjen e aplikuesve për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin "Lumadh". Aplikantët që nuk janë përzgjedhur, u është dhënë e drejta të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej 7 ditësh në komisionin e ankesave të Komunës së Vushtrrisë.

- Komisioni vlerësues me datë 31.03.2021 i ka rekomanduar Kuvendit Komunal në Vushtrri bizneset përfituese për shfrytëzimin e paluajtshmërive në parkun e biznesit



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

"Lumadh", duke u bazuar në kriteret e vlerësimit të përcaktuara me vendimin nr.269/20 të datës 30.12.2020 të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

- Me datë 16.04.2021, është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, bazuar në procesverbalin e mbajtjes së seancës z. Ilmi Azemi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, gjatë seancës ka deklaruar si në vijim: *"njoftoi Kuvendin se ai do të qëndroi në sallën e kuvendit, por vota e tij do të jetë abstenim me qëllim të shmangies së konfliktit eventual të interesit. Sepse kjo parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, por ai do të marrë pjesë, por që vota e tij nuk dëshiron të jetë përcaktuese në kahjen e këtij vendimi që do të merret"*.

- Ndërsa z. Fitim Haliti, ish Anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, në seancën e Kuvendit Komunal ka deklaruar se " *deklaroj se për shkak të konfliktit të interesit eventual lidhur me vendimmarrjen njoftoi se vota e tij do të jetë abstenim*".

- Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë ka nxjerr vendim me nr. 81/21 të datës 16.04.2021 për dhënien afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

- Për këtë vendimmarrje kanë votuar 13 vota për, dy vota kundër dhe tre vota abstenim, ndërsa ish Kryesuesi i Kuvendit Komunal nuk kishte marrë pjesë në votim.

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me datë 26.04.2021 e ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit nr.81/21 të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Zyrtari i lartë z. Azemi, ka qenë anëtar i komisioni për vlerësimin e ofertave dhe për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në fshatin "Lumadh" dhe në takimin e mbajtur të komisionit të datës 12.03.2021, në procesverbal shprehimisht është shkruar *"është votuar lista e aplikuesve që kanë plotësuar kriteret, përveç aplikuesit "Mateo Group", ku anëtari i komisionit z. Ilmi Azemi, nuk ka marrë pjesë në votim e kësaj kompanie, pasi që ka konflikt interesi"*.

Por i njëjti në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërive në fshatin Lumadh, ka marrë pjesë në votim dhe ka votuar abstenim, e që vota e tij ka ndikuar që seanca e Kuvendit lidhur me vendimmarrjen të bëjë kuorumin.

Edhe ish zyrtar i lartë z. Haliti, në seancë të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë ka deklaruar konflikt interesit dhe ka votuar abstenim lidhur me vendimmarrjen për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin "Lumadh".

Person i afërt me zyrtarin dhe Interesi privat i zyrtari është i përcaktuar në nenin 3 (pika 3, 6) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit;



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org | E-mail: info@akk-ks.org

*1.6 Person i afërm me zyrtarin – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*

*1.2 Interes privat i personit zyrtar – nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste*

Në nenin 17 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit është përcaktuar deklarimi "rast për rast" i interesave private të zyrtarit në të cilin thuhet;

Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit

*1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.*

*2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.*

*3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.*

*4. Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, institucioni punëdhënës regjistron identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkak për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.*

*5. Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.*

Në rastin konkret, zyrtarët z. Azemi dhe Halili, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal në Vushtrri, kanë deklaruar konflikt interesi, por nuk janë tërhequr nga vendimmarrja duke votuar abstenim.

Në nenin 48.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale shprehimisht thuhet;



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org E-mail: info@akk-ks.org

*Në të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij, çdo person, përfshirë edhe kryesuesin, ka nga një votë, por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi. 48.2 Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e kuvendit të komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë. 48.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.*

Fakti që z. Ilmi Azemi dhe z. Fitim Halili kanë pasur interesa private dhe këtë e kanë deklaruar në seancën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë nënkupton atë se zyrtarët do të duhej të mos merrnin pjesë në vendimmarrje për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit, por kjo nuk ka ndodhë dhe këta zyrtar kanë votuar abstenim. Ndërsa votat e tyre abstenim kanë qenë thelbësore dhe përcaktuese në formimin e kuorumit. Në këtë rast zyrtarët kanë vepruar në kundërshtim me nenin 17 pika 1 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit.

Nga 35 anëtar sa ka kuvendi Komunal në Vushtri për vendimmarrje me nr.81/21 kanë votuar 13 vota për, dy vota kundër dhe tre vota abstenim, ndërsa ish Kryesuesi i Kuvendit Komunal nuk kishte marrë pjesë në votim.

Zyrtarët z. Azemi dhe z. Halili me veprimet e tyre në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal në Vushtrrisë kanë vepruar në kundërshtim edhe me nenin 5 pika 1.9 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në të cilën thuhet;

*9. "Zyrtari nuk mund të përdorë pozitën apo funksionin e vet për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërm".*

Konflikt i interesit për anëtarët e Kuvendit Komunal është i përcaktuar edhe me Ligjin 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, konkretisht në nenin 38 shprehimisht thuhet;

*37.1. Anëtari i Kuvendit të Komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrje të vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me çështje në të cilën ai/ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij/saj ka interes personal apo material.*
*37.2. Çdo anëtar duhet të shfaq të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërën prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo anëtar mund të ofrojë informacionet për interesat e anëtarit tjetër të kuvendit.*
*37.3 para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet të regjistrojnë deklarata e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilën e mbanë udhëheqësi i personelit. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.*

Në mbështetje të nenit 23 pika 1.13 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit si dhe nenit 37 pika 37.4 të Statutit nr.58/11 të Komunës së Vushtrrisë, Agjencia kërkon nga ju si Kryesuese e Kuvendit Komunal në Vushtri inicimin e procedurës për rishqyrtimin e vendimit nr.81/21 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë me kompensim të pronës së paluajtshme të Komunës në parkun industrial në "Lumadh".



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefon: +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org E-mail: info@akk-ks.org

Në nenin 23 pika 1.13 të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit shprehimisht thuhet se;

*13. Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, afati i caktuar për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për rishqyrtimin e vendimit*

Agjencia kundër Korrupsionit duhet të njoftohet për vendimin e ndërmarrë për zbatimin e këtij Opinionit.

Agjencia kundër korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!



Adresa: Rruga „Shkodra" Nr. 6, 10.000 Prishtinë, Kosovë
Telefoni +383 38 516 - 145 | web: http://www.akk-ks.org E-mail: info@akk-ks.net

REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 04.07.2024 |
| **PËR/ZA/TO:** | KPF dhe Kuvendin Komunal |
| **PËRMES;** | Kryetari i Komunës Ferit Idrizi________ |
| **NGA/OD/FROM;** | Abit Abiti, ZKF________________ |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Pasqyrat Vjetore financiare dhe Raportin e Auditimit për PVF për vitin 2023 |

Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit, trajtimi i të gjeturave dhe zbatimi i rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm dhe Brendshëm nga SSP të audituara i prezentojmë në Kuvend Pasqyrat Vjetore financiare dhe Raportin e Auditimit për PVF për vitin 2023

Të bashkangjitura
Raportin vjetor Financiar
Raportin e Auditimit për Pasqyrat Financiare Vetore

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMUNA VUSHTRRI
*OPSTINA VUCITRN*

# Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

Protokolli dalës i Organizatës Buxhetore
8267/24
-52-
23.02.2024

Protokolli hyrës i Thesarit të Kosovës

## Neni 12
## DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **NYSRET KOCA, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit**

Nga: **Ferit Idrizi, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

**Abit Abiti, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)**

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.
Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuara janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 të institucionit KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| **Data: 23 / 02 / 2024** | **Datë: 23 / 02 / 2024** |
| *(Nënshkrimi i ZKA)* | *(Nënshkrimi i ZKF)* |

## Neni 13
## Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **BURIMET E FONDEVE -PRANIMET** | | | | |
| Granti qeveritar | | 21,238.62 | 15,281.82 | 15,664.56 |
| Të hyrat vetanake | | 4,972.65 | 2,818.60 | 2,260.43 |
| Të hyrat e dedikuara | | | | |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | | 1.85 | 68.94 | 319.24 |
| Financimet nga huamarrja | | | 158.06 | 52.94 |
| Klauzola e investimeve | | | | |
| Fondi zhvillimor në mirëbesim | | | | |
| Pranimet tjera | | | | |
| Gjithsej | | **26,213.12** | **18,327.42** | **18,297.17** |
| **SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT** | | | | |
| Operacionet | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 12,140.87 | 10,100.51 | 10,603.10 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 4,416.99 | 3,306.29 | 3,109.69 |
| Shpenzime komunale | 4 | 447.46 | 381.07 | 309.36 |
| | | 17,005.32 | 13,787.88 | 14,022.15 |
| Transferet | | | | |
| Transfere dhe subvencione | 5 | 1,129.21 | 1,183.53 | 836.87 |
| Shpenzime kapitale | | | | |
| Prona, ndërtesa dhe pajisje | 6 | 8,078.59 | 3,356.01 | 3,438.15 |
| Pagesa tjera | 7 | | | |
| Gjithsej | | **26,213.12** | **18,327.41** | **18,297.17** |

Totali i pranimeve është i barabartë me totalin e pagesave për arsye se Qeveria e Republikës së Kosovës udhëheq dhe menaxhon shpenzimet dhe të hyrat e të gjitha organizatave buxhetore përmes LLVTH-së, pra entiteti buxhetor nuk ka kontroll mbi mjetet.

Burimet e financimit janë nga:

- Granti qeveritar........................................... 21,238,617.41 €
- Të hyrat vetanake.......................................... 4,972,652.29 €
- Donacionet.................................................... 1,848.00 €

Totali i pranimeve nga Ll.V.Th ............................ 26,213,117.70 €.

Shfrytëzimi i fondeve:

- Paga dhe shtesa ............................................ 12,140,867.58 €
- Mallra dhe shërbime ....................................... 4,416,993.12 €
- Shpenzimet komunale ....................................... 447,458,24 €
- Subvencionet dhe transferet............................ 1,129,213.10 €
- Shpenzimet kapitale ....................................... 8,078,585.66 €

Totali i shpenzimeve nga Ll.V.Th............................ 26,213,117.70€

Totali i burimit të fondeve- pranimet, është i barabartë me pjesën e shfrytëzimi i fondeve- pagesat, pra shuma e pranimeve dhe pagesave është 26,213,117.70€

Vërejtje: Gjatë vitit 2023 nga Thesari janë ekzekutuar Vendime gjyqësore për pagesën e obligimeve të cilat burojnë nga Kontrata Kolektive për punëtorët e arsimit nga këto kategori:
Paga.- Për këtë kategori nga kategoritë tjera janë paguar 2,419,414.85€, pra shuma e prezantuar në tabelë është e nënvlerësuar për të njëjtën shumë.
Komunali. Nga kjo kategori janë ekzekutuar Vendime gjyqësore në vlerë prej 26,700.00€ dhe ate për paga 9,000.00€ dhe për vendime gjyqësore për Investime kapitale në vlerë prej 17,700.00€.
Shuma e prezentuar në tabelën më lart është e mbivlerësuar për 26,700.00€

Mallra dhe shërbime.- Nga kjo kategori janë ekzekutuar Vendime gjyqësore në vlerë prej 245,611.81€. Pagat e realizuara nga kjo kategori janë në vlerë prej 230,892.09€, pra edhe në këtë kategori kemi mbivlerësim.
Shpenzime kapitale.- Pjesa dërmuese e vendimeve gjyqësor për paga janë realizuar nga kjo kategori. Nga shuma e vendimeve gjyqësore 2,251,241.18€ vetëm 72,718.42€ i takojnë kësaj kategorije, kurse 2,178,522.76€ janë paguar për kategorinë e pagave.

***Shënim:*** *Pagesat nga palët e treta prezantohen në shënimin 13 në përputhje me SNKPS 2017, efektive nga 1 janari 2019.*

## Shpenzimet e krijuara nga pandemia COVID-19

| | |
|---|---|
| 00098 - MJETET NGA PROGRAMI I RIMËKËMBJES EKONOMIKE | 13,231.64 |
| 11 - PAGA DHE SHTESA | 13,231.64 |

Gjatë vitit 2023, Komuna e Vushtrrisë në projektin me kod 00098-MJETET NGA PROGRAMI I RIMËKËBJES EKONOMIKE ka shpenzuar për Paga dhe shtesa 13,231.64€
Nga mjetet për programin e rimëkëmbjes ekonomike kanë përfituar punëtorët shëndetësor dhe ata të shërbimeve rezidenciale.

## Neni 14
## Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Komunën e Vushtrrisë
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

| | | 2023 | | | | 2022 | 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Realizimi | Buxheti final | Buxheti fillestar | Varianca | Realizimi | Realizimi |
| | | A | B | C | D=B-A | E | F |
| | Shënime | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 | € '000 |
| HYRJA E PARASË SË GATSHME | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | 8 | 1,268.60 | 1,152.14 | 1,152.14 | (116.46) | 969.62 | 895.45 |
| Të hyrat jo tatimore | 9 | 2,138.72 | 1,748.42 | 1,748.42 | (390.30) | 1,599.78 | 1,772.62 |
| Të hyrat e dedikuara | 10 | | | | - | | |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 11 | | | | - | 30.91 | 356.79 |
| Tjera | 12 | | | | - | | 1.98 |
| Gjithsej Pranimet | | 3,407.32 | 2,900.56 | 2,900.56 | (506.76) | 2,600.31 | 3,026.84 |
| DALJA E PARASË SË GATSHME | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 12,140.87 | 12,166.73 | 10,796.37 | 25.86 | 10,100.51 | 10,603.10 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 4,416.99 | 4,687.02 | 3,904.19 | 270.03 | 3,306.29 | 3,109.69 |
| Shpenzime komunale | 4 | 447.46 | 483.59 | 472.50 | 36.13 | 381.07 | 309.36 |
| Transfere dhe subvencione | 5 | 1,129.21 | 1,153.16 | 942.00 | 23.94 | 1,183.53 | 836.87 |
| Shpenzime kapitale | 6 | 8,078.59 | 9,012.56 | 7,258.85 | 933.97 | 3,356.01 | 3,438.15 |
| Rezerva | | | | | - | | |
| Tjerat | 7 | | | | - | | |
| Gjithsej pagesat | | 26,213.12 | 27,503.05 | 23,373.91 | 1,289.94 | 18,327.42 | 18,297.17 |

|---|---|---|---|---|---|
| | shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | realizimi i tyre do të ekzekutohen nga kategorit adekuate. | shtesë në mënyrë që keqklasifikimet të mosndodhin. | | **mbivlerësuar/nënvlerësuar kategorinë ekonomike të shpenzimit, dhe nuk pasqyrojnë drejtë informacionet për kategoritë përkatëse të shpenzimeve.** |
| 15 | Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar çështjet pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve përmes projekteve ekzekutive dhe se menaxherët e kontratave për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë. | Vonesat janë si shkak i kushteve atmosferike, problemeve te ndryshme ne terren si dhe ne raste te caktuara probleme pronësore, ose edhe si pasoje e mungesës se projektit kryesor dhe mangësive ne paramasa, andaj me hartimin e projekteve do te mundohemi qe projekti te jete sa me i sakt dhe si zbatueshëm me qellim qe te mos shkaktohen vonesa. | Nëntor 2023 | E pazbatuar | Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të projektit dhe të vet Komunës |
| 16 | Kryetari duhet te sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të | Komuna e Vushtrrisë gatë vitit 2023 do t'i përkushtohet këtij procesi dhe do t'i | Dhjetor 2023 | E zbatuar | Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mosvlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me gjendjen e pasurive komunale. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. | azhurnoj regjistrat e pasurisë. Komisionet për procesin e inventarizimit dhe vleresimit të pasurive d'i zbatojnë kërkesat e Rregullorja 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare dhe do të punojnë që t'a kemi një regjistër të pasurisë sa më të sakt. | | | |
| 17 | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë. | Me ratin e hartimit të pasqyrave Financiare Vjetore do të kujdesemi që saldo e llogarive vjetore të jet e sakt. Në drejtorinë e Kadastrit do të plotësohet sektori për menaxhimin e pronave me staf të mjaftueshëm i cili do të menaxhoj me pronat publike. | | E zbatuar pjesërisht. | Dobësitë e identifikuara në shpalosjet e llogarive të arkëtueshme, ndikojnë në prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV, të cilat mund të kenë ndikim negativ në vendimmarrjen e menaxhmentit dhe tregon jo transparencë ndaj palëve të interesit. |
| 18 | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, | Drejtorija për Sherbime Publike është duke punuar rreth marrjes së një vendimi për dërgimin e borgjlinjëve nga inkasimin e mbeturinave te përmbaruesi, | E pazbatuar | Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal me ndikim negativ në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime. | regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime. | kurse nga sektori i Tatimit ne Prone janë dërguar 18 raste ne përmbarues privat, me rekomandim te DTP kemi ndaluar me këto procedura. | | |
| 19 | Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës ruajnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritë e arkëtueshme të taksës në biznes dhe të siguroj funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të taksës në biznes. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve në taksat në biznes. | Komuna e Vushtrrisë do t'i analizoje regjistrat e taksës në biznes, do t'i shqyrtojmë mundësit për inkasimin e borgjeve. Nëse nuk ekzistojnë mundësit për inkasim atëherë do t'a shqyrtojmë edhe mundësin për falje, nëse nuk kemi pengesa ligjore. | | E pazbatuar. | **Mungesa e dokumentacionit për llogaritë e arkëtueshme për kategorinë e taksës në biznes, pamundëson ofrimin e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme dhe marrjen e masave për arkëtimin e tyre.** |
| 20 | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për obligimet e pa paguara në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore | Me rastin e hartimit të PVF për vitin vijues do të kujdesemi që raste të tilla mos të persëriten. | | | **Dobësitë e identifikuara në shpalosjet e obligimeve të pa paguara ndikojnë në prezantimin e informatave jo të sakta për vlerën e tyre në PFV.** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | të jetë i saktë dhe i drejtë. | | | | |
| 21 | Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të zhvilloj procedurat për auditor, për plotësimin me staf të mjaftueshëm, bazuar në rregulloren për themelimin e Njësisë për Auditmin e Brendshëm. | Pozita e tretë për auditor të brendshëm është buxhetuar dhe planifikuar me planin e personelit, pengesat për rekrutim janë eliminuar dhe rekrutimi për pozitën në fjalë do të shpallet këtë vit. | | E pazbatuar | **Mos kompletimi i NjAB-së me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.** |

<u>**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**</u>

- shpalos rekomandimet e bartura nga viti paraprak dhe te pazbatuara, përpjekjet e bëra dhe rezultatet
- shpalos nivelin e zbatimit te rekomandimeve te auditimit te brendshëm te OB

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT


1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

### Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vushtrrisë (VU), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vushtrrisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

### Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Nga kategoritë ekonomike investime kapitale, mallra dhe shërbime, komunali dhe subvencione janë realizuar pagesa në vlerë 2,427,389€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu, nga kategoria e shërbimeve komunale janë bërë pagesa për investime kapitale në vlerë 17,700€, dhe nga investimet kapitale për mallra e shërbime janë paguar 11,260€.

B2 Prezantim jo i saktë e pasurisë kapitale dhe jokapitale në PVF. Pasuritë kapitale në shpalosje janë nënvlerësuar për 1,493,654€, derisa pasuritë jokapitale janë nënvlerësuar për 512,507€.

A1 Detyrimet kontigjente të shpalosura në PVF janë nënvlerësuar për 546,851€.

B3 Obligimet e papaguara të shpalosura në PVF ishin mbivlerësuar për 89,958€.

B4 Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme për taksën në biznes në vlerë 471,824€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë nuk kanë qenë në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

B5 Pagesa të parregullta për furnizime dhe punë në projekte kapitale.

B6 Mungesa e projekteve detale ekzekutive për kontratat e punëve.

B7 Parregullsi në procedurat e prokurimit publik.

B8 Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve.

A2 Mos pagesa e qirave mujore nga shfrytëzuesit e pronave pubike.

A3 Tejkalim i vlerës së kontratave publike për punë dhe furnizime nga vlerat e buxhetuara.

A4 Parregullsi gjatë aplikimit të zbritjeve nga baza tatimore për pronat me banim parësor, dhe nivel i ulët i inspektimit të pronave të paluajtshme.

A5 Tejkalim i vlerës së planifikuar të shpenzimeve te kontrata me çmime të peshuara.

B9 Parregullsi në procesin e pranimit dhe vlerësimit të aplikacioneve për subvencionim dhe mospërmbushje e kritereve nga fermerët.

B10 Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare për kontraktuesit.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vushtrrisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vushtrrisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vushtrrisë me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vushtrrisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Përmirësimet duhet të zbatohen te: menaxhimi dhe implementimi i projekteve kapitale, pranimi i punëve dhe çertifikimi i pagesave, klasifikimi e shpenzimeve në kategoritë përkatëse, prokurimi, menaxhimi i kontratave të qirasë për pronat publike, regjistrimi i pasurisë jofinanciare, menaxhimi i tatimit në pronë, llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme, proceset e subvencionimit dhe monitorimit të projekteve, personeli, etj. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Si rezultat i procedurave përmbarimore dhe vendimeve gjyqësore për mos pagesë me kohë të obligimeve ndaj kontraktuesve për realizim të punimeve dhe furnizimeve, si dhe personelit arsimor, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë totale 2,610,378€. Prej tyre borxhi kryesor ishte 2,013,139€, derisa 597,239€ ishin pagesa shtesë në emër të kamatave, tarifave të përmbarimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.

Ky raport ka rezultuar me 27 rekomandime, prej tyre 9 janë rekomandime të reja dhe 18 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja B1 - Shpenzime nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate**

**Gjetja**

Me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Nga auditimi i pagesave si dhe shpalosjet në PVF, kemi konstatuar se si rezultat i vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 2,445,089€ nga kategoritë joadekuate buxhetore:

- Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 2,178,523€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve,
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve janë paguar 230,892€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve,
- Nga kategoria e shpenzimeve komunale janë paguar 9,000€ për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, dhe 17,700€ për shpenzime të kategorisë së investimeve kapitale, dhe
- Nga buxheti i subvencioneve janë paguar 8,974€ për shpenzime që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve.

Gjithashtu, nga kategoria e investimeve kapitale, komuna ka paguar furnizime në vlerë 11,260€, që për nga natyra i takojnë mallrave dhe shërbimeve. Regjistrime të gabuara të shpenzimeve janë hasur edhe te

kategoria e subvencioneve, pasi subvencionet për përfitues individual dhe fermer në vlerë 589,775€ nuk janë regjistruar në kodet ekonomike përkatëse, po janë regjistruar gabimisht në kodet subvencione për entitete publike dhe entitete jo-publike.

Kjo ka ndodhur si rezultat i vendimeve gjyqësore për paditë e personelit arsimor dhe planifikimeve joadekuate nga komuna. Pagesat në emër të shujtave kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet nga komuna.

**Ndikimi** Regjistrimi dhe pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve për komunën, qytetarët dhe palët tjera të interesit.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet e tilla përfshihen në planifikimet buxhetore, duke mundësuar regjistrimin dhe pagesën nga buxheti i kategorive dhe kodeve ekonomike përkatëse në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Mos regjistrimi i pasurisë kapitale dhe jokapitale në regjistrin kontabël dhe sistemin e-pasuria.**

**Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11.3 përcakton se pas përfundimit të procesit të investimit, pasuria kapitale do të klasifikohet si pasuri në përdorim dhe të zbatohet zhvlerësimi. Po ashtu, neni 6.3 përcakton se pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria.

Pasuritë kapitale të shpalosura në PVF janë nënvlerësuar për 1,493,654€, pasi në regjistrin kontabël të pasurisë nuk ishin regjistruar 21 pasuri kapitale të blera gjatë vitit 2023. Komuna nuk kishte regjistruar as objektin e komunës në regjistër të pasurisë. Në regjistrin kontabël të pasurisë, ende ka pasuri në vlerë 8,770,472€ që janë të klasifikuara si investime në vijim, të regjistruara përgjatë viteve deri në vitin 2021, e të cilat pas përfundimit nuk janë destinuar në kategoritë përkatëse. Kjo ka pamundësuar kalkulimin e zhvlerësimit vjetor për këto pasuri.

Gjithashtu, komuna ka nënvlerësuar pasuritë jokapitale, pasi në PVF e vitit 2023 ka shpalosur pasuri në vlerë 129,498€, derisa në PVF e vitit 2022 kishte shpalosur pasuri jokapitale në vlerë 642,005€. Komuna nuk i ka regjistruar në programin e-Pasuria pasuritë jokapitale në përdorim nga institucionet komunale arsimore dhe shëndetësore.

Kjo ndodhur për shkak të kontrolleve dhe monitorimit të dobët në regjistrimin e pasurisë nga drejtoria e financave dhe e administratës për detyrat e përcaktuara të zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Mangësitë e identifikuara përveç që pamundësojnë menaxhimin e duhur të pasurisë, ato shkaktojnë mungesë të informatave për pasurinë që ka në dispozicion komuna, mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe me ndikim në prezantimin jo të drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare.

| | |
|---|---|
| **Rekomandimi B2** | Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari i pasurisë të regjistrojë të gjitha pasuritë kapitale në SIMFK, dhe pasuritë jokapitale në e-pasuri. Pasuritë e regjistruara si investime në vijim, e të cilat kanë përfunduar si projekte, të ri-alokohen në kodet përkatëse të pasurisë që i takojnë. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Shpalosje jo e saktë dhe e plotë e detyrimeve kontigjente në PVF**

**Gjetja**

Rregullorja nr. 01/2017 për pasqyrat financiare vjetore, neni 18 përcakton se OB në harmoni LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin vjetor financiar janë nënvlerësuar për 546,851€, kjo pasi:

- Detyrimi kontigjent për kontest pronësor në vlerë 519,215€ nuk ishte prezantuar fare, ndonëse ende ishte në procedurë gjyqësore,
- Detyrimi kontigjent për kompensim prone në vlerë 42,650€ ishte prezantuar në vlerë 5,000€, dhe
- Një lëndë për kompensim page në vlerë 10,014€ e përfunduar si procedurë gjyqësore, dhe tani është një obligim real financiar, ishte shpalosur si detyrim kontigjent.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së komunikimit mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës.

**Ndikimi**

Mos shpalosja e saktë dhe e plotë e detyrimeve kontigjente ka ndikuar në nënvlerësimin e tyre dhe prezantim jo të drejtë financiar për kontigjencat.

**Rekomandimi A1**

Kryetari duhet të sigurojë përforcimin e komunikimit në mes sektorit të financave dhe përfaqësuesit ligjor të komunës, me qëllim që informacioni financiar në regjistrin e detyrimeve kontigjente dhe raportimi i tyre të jetë i saktë dhe i plotë në PVF.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B3 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara në raportin vjetor financiar**

**Gjetja**

Rregullorja MF 01/2017, neni 17 përcakton që OB-të të raportojnë të gjitha detyrimet e papaguara.

Obligimet e papaguara nuk janë prezantuar saktë në raportin vjetor financiar, pasi dy fatura për punët e zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në vlerë 89,958€ të cilat ishin paguar përmes procedurave të përmbarimit, ishin shpalosur si obligime të papaguara.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në menaxhimin dhe përditësimin e regjistrit të obligimeve të papaguara nga zyrtarët financiar.

**Ndikimi**

Mangësitë e identifikuara kanë rezultuar me mbivlerësim të obligimeve dhe shpalosje të pasakta të informacionit për detyrimet që komuna ka ndaj kontraktuesve.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë se obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe

saktë në PVF.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme për taksat në biznes**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Neni 16, i Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, përcakton që OB që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumat e faturuara e të pa arkëtuara.<br><br>Për llogaritë e arkëtueshme të taksave në biznes në vlerë totale 471,824€, komuna nuk disponon dokumentet burimore, dhe si pasojë e kësaj kjo vlerë nuk mund të dëshmohet/provohet për saktësi.<br><br>Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme për ruajtjen e dokumentacionit për borxhet në taksat në biznes. |
| **Ndikimi** | Mungesa e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme, përveç që ndikon në aspektin e raportimit financiar, pamundëson edhe marrjen e veprimeve ligjore për inkasimin e tyre. |
| **Rekomandimi B4** | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës ruajnë dhe sigurojnë dhe mirëmbajnë dokumentacionin burimor për të hyrat nga taksa në biznes. Ndaj borxhlinjve të ndërmerren veprime ligjore për mbledhjen e të hyrave të pa inkasuara. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

**Çështja B5 - Pagesa të parregullta për projekte kapitale**

**Gjetja**

Me specifikacionin teknik të kontratave publike është përcaktuar sasia e punëve dhe kushtet tjera që kontraktuesi duhet ti realizoj, para se të ekzekutohet pagesa.

Nga inspektimet fizike të punimeve për projektet kapitale, kemi vërejtur se për pagesat e ekzekutuara, punimet dhe furnizimet nuk ishin realizuar siç kërkohej me paramasë, në këto raste:

- Kontrata e punëve për "Rregullimin e shtratit të lumit Silnica" në vlerë 1,049,680€ dhe aneks kontrata në vlerë 103,006€, kemi identifikuar se disa punime të parapara me paramasë dhe parallogari për pjesën III Punët e shëtitores dhe shtegut të biçikletave, nuk janë realizuar siç janë përcaktuar me paramasë. Në pozicionin 9 - Furnizimi, transporti dhe vendosja e pllakave njështresore nga graniti dhe mermeri me granil natyral (granit, diabaz, bazalt) etj, me ngjyrë të zezë me granulat granit nero 2-4 mm sipas detalit në projekt, në sasi 2,2420m2+235m2 (aneks kontrata) =2,655m2 me çmim 40€/m2 me total pagesa 106,200€, nuk janë vendosur pllaka siç është përcaktuar me paramasë dhe parallogari as nga përmbajtja/materiali as nga ngjyra. Atestet e bëra për këto pllaka përcaktojnë se janë pllaka betoni. Në aneks kontratën për këtë projekt, sipas paramasës dhe parallogarisë, pjesa 3, Punët e shëtitores dhe shtegut të biçikletave, pozicionin 3.8, nuk ishte bërë ngjyrosja/lyerja me material epoksit e shtegut të biçikletave në sasi 156m2 në vlerë 4,680€.
- Kontrata për "Rregullimin dhe pastrimin e lumit Llap-Silnica", te pjesa I, pozicioni 1 - mobilizimi i ndërmarrjes për të gjitha aktivitet përfshirë edhe ndërtimin e kantierit, në këtë pozicion përfshihet edhe furnizimi me ujë, lidhja me rrjetin e kanalizimit, rrethojat dhe të gjitha masat tjera për organizimin e brendshëm të kantierit në vlerë 50,000€, OE përveç vendosjes së një kantonjeri i cili nuk ishte funksional, nuk kishte infrastrukturë përcjellëse të ujit dhe kanalizimit, si dhe nuk ishin vendosur rrethojat.
- Kontrata publike për "Renovimin e palestrës sportive Jeton Tërstena", pozicioni 2 - Transformatori 250kva 10(20)/0,4 duhet te jete i pranuar nga KEDS në vlere 5,500€, është paguar në tërësi, edhe pse nuk ishte lëshuar në punë dhe pranuar nga KEDS. Gjithashtu, pozicioni 32 punët elektro montuese dhe projekti me ateste pranimi nga KEDS, dhënia e pranimit teknik nga KEDS dhe lëshimi në punë në vlere 4,000€ ishin paguar, derisa pranimi teknik, atestet dhe lëshimi në punë ende nuk ishte bërë.
- Kontrata "Sinjalizimi ndriçues me monitor digjital informues në katër hyrje të qytetit të Vushtrrisë", është konstatuar se pozicioni 14 - Furnizimi, instalimi dhe lëshimi në funksion e monitorëve dinamik digjital shumëngjyrësh (3 vende) me dimensione 1.0 m (L) x 1.0 m (H)= 1.0 m² (sipas përshkrimit në specifikacion) me të gjitha elementet përcjellëse deri në funksionalizimin e monitorit (lëshimin në përdorim së bashku me software-in përkatës), në vlerë 5,605€ është paguar, edhe pse ende nuk janë funksionalizuar. Po ashtu, te pozicioni Furnizimi, instalimi dhe lëshimi në funksion e monitorëve

dinamik digjital shumëngjyrësh (3 vende) me dimensione 5.00 m (L) x 1.00 m (H)=5.00 m² (sipas përshkrimit në specifikacion) me të gjitha elementet përcjellëse deri në funksionalizimin e monitorit (lëshimin në përdorim së bashku me software-in përkatës) në vlerë 23,246€, ishin paguar 17,4350€, ndonëse monitorët ende nuk janë funksionalizuar.

- Kontrata për "Renovimin e Palestrës sportive "Jeton Tërstena", kemi vërejtur se në pjesën I - Ngrohja, ftohja me termo pompe, pozicioni 1 Furnizimi dhe instalimi i pajisjes Chiller, 2 cope me çmim 20,250€, është kërkuar fuqia inpute e ftohjes 38.5 kw, ndërsa pajisja e montuar kishte kapacitetin 38.1 kw, si dhe fuqia inpute e ngrohjes është kërkuar 42 kw, ndërsa është ofruar 39.6 kw. Po ashtu, pozicioni 15 - Furnizimi dhe montimi i pompave qarkulluese për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes 4 cope, derisa ishin montuar vetëm 3 copë, çmimi për cope 1,250€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxherët e kontratave gjatë realizimit të projekteve kapitale.

**Ndikimi** Aprovimi për pagesë i punëve të parealizuara ndikon në dëmtimin e buxhetit dhe mos realizimin e kontratave siç është planifikuar.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara,

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B6 - Mungesa e projekteve detale ekzekutive për kontratat e punëve**

**Gjetja** Rregullorja nr. 01/2022 për prokurimin publik, neni 19.4, përcakton se specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues.

Nga mostrat e testuara, gjetëm se projektet detale ekzekutuese nuk ishin përgatitur për këto kontrata të punëve:

- Ndërtimi i kanalizimeve në territorin e Komunës së Vushtrrisë lot 1, në vlerë 506,130€.
- Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Komunën e Vushtrrisë lot 1, me vlerë indikative 420,000€.
- Ndërtimi i segmentit rrugorë Druar-Pestovë në vlerë 344,395€, dhe
- Rregullimi i shtratit të lumit Silnica në vlerë 1,049,680€, si dhe aneks kontratës në vlerë 106,006€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate dhe mos zbatimit të kërkesave ligjore në hartimin e projekteve detale ekzekutuese për projektet kapitale nga njësitë kërkuese.

**Ndikimi** Mungesa e projekteve ekzekutuese rritë rrezikun që gjatë implementimit të kontratës së punëve të paraqiten vështirësi, pengesa dhe paqartësi të ndryshme si në aspektin e realizimit, mbikëqyrjes së punimeve, vonesave, si dhe kostove shtesë.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar hartimi i projekteve ekzekutive.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Dobësi në procedurat e prokurimit publik**

**Gjetja** Rregullorja nr. 001/2022 për prokurim publik, neni 54.15, specifikon se kurdo që Autoriteti kontraktues (AK) nuk kanë të njohura sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje). Në njoftimin për kontratë, përcaktohen kërkesat e përshtatshmërisë, kriteret ekonomike, teknike dhe profesionale të cilat duhet të plotësohen nga OE.
Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, me LPP është si rregull i përgjithshëm i ndaluar.

Nga testimi i procedurave të prokurimit, kemi identifikuar se:

- Kontrata për "Punët e rekonstruimit të rrugëve të asfaltuara në Komunën e Vushtrrisë" në vlerë të parashikuar prej 420,000€, ishte aplikuar procedura e prokurimit me kriter çmimi më i ulët për njësi apo poentim. Në dosjen e tenderit, në Aneksin 1 specifikimet teknike të detyrueshme, disa pozicione të punimeve, nuk kishin të bënin me mirëmbajtje, por punime të reja. KRPP kishte monitoruar dhe shqyrtuar këtë aktivitet të prokurimit dhe kishte konstatuar se në paramasen dhe parallogarinë kishte pozicione të cilat cilësohen punë e re e jo mirëmbajtje dhe riparime. KRPP kishte sqaruar për Komunën se kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për kontratat e punëve vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me riparime dhe mirëmbajtje, dhe kishte rekomanduar Komunën që ta shqyrtoj kriterin e dhënies së kontratës dhe të ndërmerr veprime për evitimin e këtyre gjetjeve. Gjithashtu, një nga kriteret e njoftimit për kontratë ishte caktimi i menaxherit të kontratës si përgjegjës i drejtpërdrejtë për ekzekutimin e projektit, ku ishte kërkuar përvoja e punës, kualifikimi etj, për të cilën ofertuesi kishte caktuar një menaxher të kontratës. Pas përfundimit të procedurës së prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi kishte caktuar një tjetër menaxher të kontratës, i cili kishte nënshkruar Planin për Menaxhimin e Kontratës dhe situacionet e punimeve.
- Kontrata "Renovimi i palestrës sportive Jeton Tërstena" në vlerë 114,900€, në paramasë dhe parallogari, te pjesa VI/pozicioni 1, është përcaktuar marka tregtare e pajisjes UNTESH (AHU1), duke mos lënë opsion "ose të ngjashme’’ siç kërkohet me rregullat e prokurimit publik.

Këto kanë ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme joadekuate dhe mos zbatimit të kërkesave dhe rregullatives përkatëse të përcaktuara me Ligjin dhe Rregullën për prokurimin publik.

**Ndikimi** Mos zbatimi i procedurës adekuate të prokurimit publik mund të ndikojë negativisht në përzgjedhjen e ofertave më të favorshme dhe të reflektojë si në aspektin operativ dhe atë buxhetor. Përcaktimi i markës tregtare apo modelit në specifikimet e dosjes së tenderit ndikon në favorizimin e operatorit/ve të caktuar për llojin e caktuar të produktit duke kufizuar konkurrencën.

**Rekomandimi B7** Kryetari duhet të sigurojë se kontraktimi i punëve për projektet kapitale të bëhet duke zbatuar llojin adekuat të procedurës së prokurimit publik. Rekomandimet e KRPP-së të merren në konsiderohet dhe të zbatohen nga zyra e prokurimit. Të shtohen kontrollet në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### Çështja B8 - Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit për kohëzgjatjen e kontratës dhe mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve

**Gjetja**

Sipas nenit 63 të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik, neni 29, siguria e ekzekutimit (SE) kërkohet si parakusht për nënshkrim të kontratës. Shuma e SE do të jetë e barabartë me të paktën 10% të vlerës së kontratës. SE do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Gjithashtu, me kushtet e veçanta të kontratës (KVK) kërkohet garancioni për kualitetin e punimeve apo furnizimeve për një afat të caktuar dhe në vlerë 10% të vlerës së kontratës.

Nga auditimi i kontratave janë identifikuar mangësi në ofrimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratave dhe garancionit bankar të kualitetit të punimeve dhe furnizimeve, si në rastet në vijim:

- Kontrata publike "Ndërtimin e kanalizimeve" sipas lot 1 deri lot 3, në vlerë 506,130€, sipas dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe nenit 10.1 të KVK është kërkuar që siguria e ekzekutimit të jetë 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës për periudhën 37 muaj. OE kishte sjellë SE në vlerën 50,613€ me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit, e jo për 37 muaj.
- Për kontratën "Ndërtimi i objektit të zyrave të administratës në QKMF" në vlerë 174,933€, vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit nuk është bërë në vlerën 10% te kontratës apo 17,493€, por në vlerën 13,600€.
- Kontrata publike "Ndërtimi i parqeve dhe hapësirave publike në fshatin Stanoc" në vlerë 65,184€, për shkak të vonesave në implementim, ka mbetur e pa mbuluar me sigurim të ekzekutimi për 7 muaj. Gjithashtu, garancioni bankar i kualitetit të punimeve ishte bërë për afatin 13 muaj, e jo për 24 muaj siç ishte kërkuar me kontratë.
- Për kontratën Renovimi i palestrës sportive "Jeton Tërstena", në vlerë 114,900€, nuk ishte sjellë garancioni bankar i kualitetit të punimeve për afatin 25 muaj. Pagesa e fundit ishte bërë pa u pranuar garancioni i punimeve.
- Për kontratën "Furnizimi dhe instalimi i monitorit LED" në vlerë 25,842€, nuk ishte sjellë garancioni bankar për afatin 24 muaj nga

data e pranimit te mallit. Pas furnizimit dhe instalimit monitori kishte pasur disa probleme teknike, dhe i njëjti është marrë prapë nga furnizuesi për servisim. Për shkak defekteve të pa riparueshme OE kishte vlerësuar se duhet të sjellët monitor i ri. Deri në kohën e auditimit, monitori nuk ishte sjellë.

- Për kontratën e punëve "Renovimi i shkollave sipas lot 1 deri lot 4" në vlerë 59,873€, nuk është ofruar garancioni bankar i kualitetit të punimeve në afat 1 vjeçar pas përfundimit të punimeve. Pagesa e fundit është bërë pa u pranuar garancioni i punimeve.
- Në 5 kontrata[5] të punëve publike në vlerë totale 472,848€, ndonëse projektet nuk ishin përfunduar sipas afatit kohor dhe siguritë e ekzekutimit kishin skaduar, të njëjtat nuk janë vazhduar për kohëzgjatjen shtesë të kontratës.

Kjo ka ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së dobët në menaxhimin e projekteve kapitale nga menaxherët e kontratave, dhe mos kërkimit nga kontraktuesit vazhdimin e sigurisë së ekzekutimit të kontratës dhe garancionit të kualitetit të punimeve.

**Ndikimi** Mos vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit të kontratës nuk garanton mbulimin e dëmeve dhe shpenzimeve në rast të mos përmbushjes së kontratës nga ana e kontraktuesit. Gjithashtu, mos ofrimi i garancionit bankar për kualitetin e punimeve pamundëson kompensimin e dëmeve në rastet kur punët dhe furnizimet e kontraktuara nuk janë realizuar në kualitetin e duhur.

**Rekomandimi B8** Kryetari duhet të sigurojë që në rastet kur kontratat publike nuk arrijnë të përfundohen brenda periudhës së kontraktuar, siguria e ekzekutimit të kontratës vazhdohet edhe për një periudhë shtesë në të cilën parashihet finalizimi i kontratës. Pagesat përmbyllëse të kontratave të mos realizohen pa u siguruar paraprakisht garancioni bankar i kualitetit të punimeve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Mos pagesa e rregullt e qirasë nga shfrytëzimi i pronave publike**

**Gjetja** Kontrata e qirasë, pika 7.1 specifikon se, nëse qiramarrësi dështon të paguajë obligimet e papaguara, apo dështon në zbatimin kushteve të kontratës, atëherë qiradhënësi e njofton qiramarrësin për mos përmbushjen, dhe nëse qiramarrësi nuk e përmirëson dështimin brenda 15 ditëve, atëherë kontrata qirasë automatikisht do të konsiderohet se ka përfunduar.

Gjatë testimeve, kemi vërejtur se në tre (3) raste, qiramarrësit e pronave publike nuk kishin përmbushur kushtet e marrëveshjes për pagesën e rregulltë të qirasë mujore, dhe komuna nuk ka ndërmarrë veprime për përmbushjen e kushteve të kontratës, si te:

- Kontrata për shfrytëzimin e parcelës publike kadastrale me numër P-70202016-00001-1, për aktivitete afariste dhe zhvillim të veprimtarisë hoteliere prej 91 ari, e nënshkruar në prill 2020 me afat të shfrytëzimit për 20 vite dhe me qira mujore 650€. Qiramarrësi nuk ka paguar asnjë qira mujore për vitet 2022 dhe 2023, dhe borxhi total ishte 15,600€. Në janar të vitit 2024 kishte paguar vetëm 5,000€.
- Kontrata për shfrytëzimin e lokalit afarist 90 m2 në parcelën kadastrale numër P-70202016-0000127-0, e nënshkruar në shkurt

2017, me afat të qirasë 7 vite dhe me qira mujore 1,000€. Borxhi total i papaguar për këtë kontratë është 29,000€.

- Tre (3) kontrata për shfrytëzimin e pronave bujqësore me sipërfaqe mbi 25.45ha, (pronat në zonën kadastrale në Gracë) qiramarrësi kishte obligime të papaguara në vlerë totale 21,970€. Edhe pse kontratat ishin ndërprerë, borxhi ka mbetur i papaguar. Gjatë vitit 2023 nuk janë ndërmarrë veprime ligjore për mbledhjen e borxhit.

Kjo ka ndodhur për shkak të dështimit të kontrolleve të brendshme dhe mos marrjen e masave ndaj kontraktuesve konform dispozitave të kontratave.

**Ndikimi** Mos pagesa e qirasë ka ndikuar në dëmtim të buxhetit komunal. Mos marrja e veprimeve ligjore ndaj qiramarrësve të pa përgjegjshëm mund të inkurajojë të njëjtit dhe qiramarrësit tjerë të mos përmbushin obligimet kontraktuale.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e qirasë për shfrytëzimin e pronave publike përmbushen nga qiramarrësit sipas kushteve kontraktuale, dhe në rast dështimi, kontratat e qirasë të ndërpriten. Për borxhet e papaguara të ndërmerren veprime ligjore për inkasimin e tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Tejkalim i vlerës së kontratave nga vlerat e buxhetuara**

**Gjetja** Ligjin mbi ndarjet buxhetore, tabela 4.2 financimi i investimeve kapitale, ka përcaktuar shumat buxhetore për periudhën tre vjeçare për realizimin e secilit projekt të aprovuar.

Për dy (2) projekte kapitale, të planifikuara me planin e prokurimit dhe ligjin e buxhetit për tu realizuar në vitet 2023-2024-2025, janë nënshkruar kontrata të punëve në vlerë 1,463,511€, duke tejkaluar vlerën e buxhetuar për 365,502€. Rastet janë:

- Për ndërtimin e rrugëve "Bekim Berisha - Abeja dhe Vëllezërit Feka" lot 1, është nënshkruar kontrata në vlerë 788,251€, derisa pagesat gjatë vitit 2023 dhe projeksionet buxhetore me ligjin e buxhetit të vitit 2024 në total janë 558,252€, duke tejkaluar buxhetin e dedikuar për këtë projekt për 219,999€.
- Për ndërtimin e rrugës "Lumni Surdulli" lot 2, është nënshkruar kontratë në vlerë 685,260€, derisa pagesat gjatë vitit 2023 dhe projeksionet buxhetore me ligjin e buxhetit të vitit 2024 në total janë 539,757€, duke tejkaluar buxhetin e dedikuar për këtë projekt për 145,503€.

Gjithashtu, në tri (3) raste vlera e kontratave të nënshkruara për mallra dhe shërbime kishin tejkaluar vlerën e planifikuar me planin vjetor të prokurimit, si në rastet:

- Furnizimi me lëndë djegëse - dru lot1, vlera e planifikuar 141,581€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 283,420€.
- Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, vlera e planifikuar 30,500€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë indikative 60,000€.
- Furnizim me material pedagogjik, vlera e planifikuar 16,000€, derisa kontrata ishte nënshkruar në vlerë 21,388€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të brendshme të dobëta në planifikim dhe aprovim të deklaratave të disponueshmërisë së mjeteve nga zyra e financave.

**Ndikimi** Hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, përveç që pamundëson realizimin e projekteve sipas planit, rritë edhe rrezikun e kostove shtesë për shkak të padive që mund të bëjnë kontraktorët në rast të mos pagesës së obligimeve për punët dhe furnizimet e realizuara.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike për projektet kapitale nuk tejkalojnë shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore, dhe shumat e planifikuara në planin vjetor të prokurimit

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A4 - Mangësi në llogaritjen e bazës tatimore për tatimin në pronë dhe nivel i ulët i inspektimit të pronave të paluajtshme**

**Gjetja**

Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronat e paluajtshme, neni 11 përcakton që personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Gjithashtu, neni 15.2 përcakton që veprimtaritë inspektuese të kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Nga analiza e bazës së të dhënave të tatimit në pronë, kemi identifikuar 851 raste për të cilët nuk është llogaritur zbritja e bazës tatimore prej 15,000€, ndërsa në 42 raste kjo zbritje është bërë 2 herë, dhe në një rast tjetër zbritja është aplikuar 3 herë. Gjithashtu, komuna nuk ka arritë që të bëjë verifikimin e së paku 20% të pronave/objekteve të përgjithshme. Nga 25,098 prona të përgjithshme, gjatë vitit 2023 ishin verifikuar vetëm 15.8% apo 3,966 prona.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të kontrolleve në fazën e inspektimit si dhe mos përditësimit të bazës së të dhënave për tatimin në pronë. Niveli i ulët i verifikimit ka ndodhur për shkak të mungesës të anketuesve në terren për verifikim të pronave të paluajtshme.

**Ndikimi** Mangësitë në llogaritjen e bazës tatimore ndikojnë në kalkulim të pasaktë të tatimit në pronë, duke mbingarkuar me tatim disa tatimpagues, dhe liruar pa të drejtë disa të tjerë. Moskryerja e inspektimit të pronave të paluajtshme mund të rezultojë në informacion jo të plotë për gjendjen aktuale të pronave, si dhe të ardhura potencialisht më të ulëta në dobi të komunës.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën 20% të të gjitha pronave/objekteve brenda territorit të Komunës.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### Çështja A5 - Tejkalimi i vlerës së planifikuar te kontrata me çmime të peshuara

**Gjetja**

Rregullorja për prokurimin publik, neni 54.15, sqaron se kurdo që AK nuk dinë sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në bazë të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani +/-30%. Duke pasur parasysh faktin së peshimi i kategorive duhet bërë duke u bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, kjo nënkupton që vlera e realizuar (shpenzuar) nuk mund të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë fillimisht në dosjen e tenderit.

Për kontratën publike me çmim të poentuar për "Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik" në vlerë të parashikuar prej 120,000€, realizimi i pagesave kishte tejkaluar vlerën totale të parashikuar, duke arritur në 156,000€. Për më tepër, nuk është ruajtur raporti ndërmjet sasisë apo përqindjes së realizuar të kategorisë dhe peshës apo përqindjes së dhënë gjatë kontraktimit asaj kategorie. Kategoria A e peshuar me 70% apo në total në vlerë 84,000 ishte realizuar 164% apo 137,410€. Kategoria A kishte çmime më të larta për njësi.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme nga menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejt në monitorimin e projekteve.

**Ndikimi**

Mos ruajtja e përqindjes apo peshimit të kategorive të kontraktuara shkakton kosto shtesë buxhetore për shkak se raporti i peshimit ishte faktori kryesor në përzgjedhjen e tenderit apo ofertës më të lirë gjatë procedurës së prokurimit.

**Rekomandimi A5**

Kryetari duhet të sigurojë që te kontrata me peshim të mos aplikohet rritja prej 30% te vlerës së kontratës bazë. Gjatë realizimit të kontratës, të ruhet e njëjta përqindje apo raport i peshimit të kategorive/pozicioneve siç janë kontraktuar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### Çështja B9 - Dobësi në procesin e subvencionimit të fermerëve dhe OJQ-ve

**Gjetja**

Sipas thirrjes publike 09 nr.83.23 për aplikim nga fermerët për pagesa direkte (bletë, dele, etj), dhe thirrjes publike nr. 04922/23 për subvencionim të prodhimtarisë së qumështit, aplikuesit duhet të dorëzojnë vërtetimet për kryerjen e obligimeve komunale për tatimin në pronë dhe mbeturinat. Gjithashtu, me thirrjen publike caktohet periudha kohore e aplikimit prej 15 ditëve.

Gjatë testimit të procedurave të subvencionimit janë identifikuar këto mangësi:

- Në dy (2) raste të subvencionimit të fermerëve në vlerë 4,751€, përfituesit nuk i kishin plotësuar kriteret e kërkuar me thirrjen publike, pasi nuk kishin ofruar dëshmi se kanë paguar obligimet ndaj komunës për taksën në mbeturina dhe tatimin në pronë.

- Në katër (4) raste të subvencionimit të projekteve në fushën e DKRS-së në vlerë 18,000€, komisioni i vlerësimit të kërkesave nuk ka përdorur formularët standard të vlerësimit siç kërkohet me rregulloren bazë, dhe
- Te projekti "Ndërtojmë vetëdijen zgjohemi kundër drogave" në vlerë 2,500€, përveç mungesës së formularëve të vlerësimit dhe deklaratës për financimin e dyfishtë, përfituesi i subvencionit kishte aplikuar dy ditë pas mbylljes së afatit për aplikim dhe komisioni kishte pranuar aplikacionin për subvencionim.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos zbatimit të procedurave dhe akteve rregullative përkatëse nga zyrtarët përgjegjës gjatë vlerësimit të kërkesave për subvencionim.

**Ndikimi** Mungesa e kontrolleve adekuate lidhur me procesin e vlerësimit të aplikantëve mund të ndikojë në trajtim jo të barabartë të përfituesve të mundshëm.

**Rekomandimi B9** Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B10 - Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve**

**Gjetja** LMFPP, neni 39, përcakton që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për punët, mallra dhe shërbimet e realizuara të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se pesë (5) lëndë për investime kapitale në vlerë totale 230,689€, dhe gjashtë (6) lëndë për mallra dhe shërbime në vlerë totale 30,988€, nuk ishin paguar brenda afatit kohor ligjor prej 30 ditëve nga data e pranimit të faturave. Vonesat ishin nga 10 deri 120 ditë.

Kjo ndodhur për shkak të hyrjes në obligime pa u siguruar mjetet buxhetore, si dhe kontrolleve jo adekuate në menaxhimin e obligimeve.

**Ndikimi** Mos pagesa me kohë e obligimeve financiare rritë rrezikun e padive të mundshme nga kontraktuesit, dhe kjo mund të shkaktojë kosto shtesë financiare për komunën.

**Rekomandimi B10** Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, dhe se obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara për vitin 2023 ishin 2,900,559€, ndërsa janë realizuar 3,407,323€, duke tejkaluar planin për rreth 17%. Struktura e të hyrave përbëhet nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat në mbeturina, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja, participimet, dhe taksat tjera komunale.

**Çështja B11 - Mangësi në menaxhimin e të dhënave për tatimpaguesit në ProTax**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | UA nr. 03/2021 për mbledhjen dhe regjistrimin e informative mbi pronën dhe tatimpaguesin, neni 7, paragrafi 1.1, kërkon numrin personal identifikues të tatimpaguesit fizik. Ndërlidhur me këtë edhe MFPT, përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme me qëllim të shmangies së dyfishimeve apo parregullsive eventuale.<br><br>Nga analizimi i bazës së tatimit në pronë kemi identifikuar se janë 1,997 tatimpagues të cilët në shënimet e bazës ProTax janë pa numër personal ose me numër personal gabim.<br><br>Mos përditësimi i informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë ka ndodhur për shkak të funksionimit të dobët të kontrolleve të brendshme. |
| **Ndikimi** | Mos përditësimi i informatave të tatimpaguesve, ndikon në nënvlerësimin apo mbivlerësimin e bazës tatimore. Rrjedhimisht, kjo mund të ndikoj edhe në informata jo të plota lidhur me zbritjet e mundshme për vendbanim parësorë të lejuar. |
| **Rekomandimi B11** | Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për të siguruar plotësimin dhe përditësimin e të dhënave për tatimpaguesit në sistemin ProTax. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga e mëditje ishte 12,166,732€, derisa gjatë vitit është shpenzuar pothuajse i tërë buxheti apo 12,140,866€, Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,617 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,559.

**Çështja A6 - Dobësi në procedurat e rekrutimit për nëpunësit publik**

**Gjetja**

Ligji për zyrtarët publik, neni 7, përcakton që pranimi në detyrë i zyrtarëve publik bazohet në parimin e meritës, mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese. Me konkursin publik përcaktohen kushtet dhe kriteret e kualifikimit që duhet të plotësojë kandidati/ja.

Nga auditimi i procedurave të rekrutimit të nëpunësve publik / mësimdhënësve, kemi identifikuar se:

- Për pozitën e punës "Edukatore për parashkollor" testi me shkrim nuk ishte nënshkruar nga kandidatja fituese. Gjithashtu, përgjigjet e pyetjeve teorike në testin me shkrim të kandidates, ishin të identike me përgjigjet në shabllonin e testit me shkrim që kishte përgatitur komisioni për pranim, dhe kjo le të kuptojë që përgjigjet e testit me shkrim të jenë kopjuar.
- Për pozitën e punës "Mësimdhënëse për lëndën e tekstilit" me konkurs ishte kërkuar që kandidati/ja të ketë kualifikimin Master i tekstilit, Inxhinier i diplomuar i tekstilit - drejtimi i konfeksionit, përderisa kandidatja e punësuar kishte kualifikimin bachelor i arteve në dizajn të modës; dhe
- Për pozitën e punës "Mësuese klase", me konkurs ishte përcaktuar që kohëzgjatja e kontratës të jetë me kohë të caktuar, derisa në kontratën e punës nuk është përcaktuar kohëzgjatja apo data se kur do të përfundojë afati i kontratës.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta dhe mos respektimit të procedurave dhe kritereve të konkursit nga anëtarët e komisionit dhe zyrtarët përgjegjës gjatë zhvillimit të procedurave të rekrutimit dhe nënshkrimit të kontratës së punës.

**Ndikimi**

Përzgjedhja e kandidatëve jo meritor mund të ketë ndikim negativ në arritjen e objektivave dhe detyrave të punës. Mos përcaktimi i saktë i kohëzgjatjes së kontratës së punës përveç që është në kundërshtim me kërkesat ligjore, gjithashtu shkakton paqartësi si te e punësuara, e po ashtu edhe në aspektin e planifikimit organizativ dhe buxhetor.

**Rekomandimi A6**

Kryetari duhet të sigurojë se procedurat e rekrutimit të punonjësve zhvillohen sipas kërkesave ligjore dhe kritereve të përcaktuara me konkursin publik. Të përmirësohen kontrollet e brendshme në organizimin e testit me shkrim, dhe se në kontratat me afat të caktuar të përcaktohet saktë afati kohor i angazhimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime duke përfshire edhe shpenzimet komunale në vitin 2023 ishte 5,170,610€, prej tyre ishin shpenzuar 4,865,351€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, furnizime të ndryshme për institucionet arsimore dhe shëndetësore, furnizim me pajisje të ndryshme, mirëmbajtje të ndërtesave, derivate, shërbime komunale, etj.

**Çështja A7 - Faturimi i shpenzimeve të derivateve me çmim jo të saktë**

**Gjetja**

Në bazë të nenit 4.3 të kontratës me numër të prokurimit AQP-19-006-111, për furnizim me karburante, lot 6 - niveli lokal, kalkulimi i çmimit bëhet duke u bazuar në çmimin mesatar mujor të berzës, kursit valutor mesatar mujor të bankës qendrore evropiane, dhe elementeve tjera fikse dhe variabile. AQP ka qasje në berzë dhe bënë kalkulimin e çmimit në baza mujore, ky çmim i dërgohet kontraktuesit dhe të njëjtin çmim e publikon në web faqen e AQP-së.

Në faturën për furnizim me derivate për ngrohje qëndrore nuk është aplikuar çmimi i duhur. Për furnizimin e muajit dhjetor, është përdorur çmimi i berzhës së muajit nëntor, çmim ky më lartë se çmimi i muajit dhjetor, duke rezultuar me mbi-pagesë për 998€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta si në menaxhimin e kontratës ashtu edhe procesimin e pagesës nga zyra e financave.

**Ndikimi**

Mos aplikimi i saktë i çmimit ka shkaktuar kosto shtesë financiare për komunën.

**Rekomandimi A7**

Kryetari duhet të sigurojë se procesimi i pagesave bëhet vetëm pasi të jetë konstatuar se faturat përmbajnë çmimet e sakta ashtu siç janë kontraktuar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B12 - Mos përcaktimi i qartë i specifikimeve teknike në marrëveshjen për shërbimet e pastrimit dhe sigurimit të objekteve komunale**

**Gjetja**

Me marrëveshjen kontraktuale duhet të përcaktohen qartë lokacionet dhe numri i punëtorëve që do të angazhohen, orarin dhe hapësirat ku do të ofrohen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit fizik.

Në marrëveshjen mes komunës dhe kompanisë publike lokale për kryerjen e shërbimeve komunale të mirëmbajtjes dhe pastrimit, si dhe sigurimin fizik të objekteve publike të komunës (objektet arsimore dhe shëndetësore, si dhe objektet e administratës), nuk janë përcaktuar specifikat konkrete, përkatësisht objektet dhe lokacionet ku do të realizohen shërbimet, orari apo koha e shërbimeve, numri i punëtorëve që do të angazhohen, etj. Ne kemi vërejtur se faturimet bëhen në bazë të numrit të punonjësve, përderisa me marrëveshje nuk është përcaktuar numri i punonjësve.

Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve joadekuate nga njësitë kërkuese dhe dobësive nga zyra ligjore në hartimin dhe përcaktimin e qartë të kushteve specifike të marrëveshjes.

| | |
|---|---|
| **Ndikimi** | Mos përcaktimi i qartë i specifikimeve teknike në marrëveshje krijon paqartësi si në aspektin operativ të realizimit të shërbimeve, mbikëqyrjes, dhe në aspektin financiar, për shkak se me marrëveshje nuk është përcaktuar njësia matëse (numri i punëtoreve, etj). |
| **Rekomandimi B12** | Kryetari duhet të sigurojë që në Marrëveshje të përcaktohen saktë specifikimet teknike që kanë të bëjnë me lokacionet, hapësirat punuese, orarin ku do të kryhen shërbimet e pastrimit dhe sigurimit, si dhe numrin e punonjësve që do të angazhohen në ofrimin e atyre shërbimeve. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,153,155€, prej tyre në vitin 2023 ishin shpenzuar 1,129,213€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me financimin e OJQ-ve për projekte në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, individë, si dhe financimin e fermerëve në fushën e bujqësisë.

**Çështja B13 - Parregullsi në monitorim dhe raportim nga OJQ-të përfituese të subvencioneve**

**Gjetja**

Neni 23 i Rregullores nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, përcakton që për secilën kontratë të lidhur, ofruesi i mbështetjes financiare cakton një zyrtar përgjegjës i cili duhet kujdeset për monitorimin e implementimit të projektit. Përfituesi raporton te zyrtari monitorues, përkatësisht ekipi monitorues, në baza të rregullta, lidhur me zbatimin e projektit/programit, sipas kërkesave të kontratës. Raportimi përfshin raporte narrative dhe financiare.

Për tre (3) projekte të subvencionuara në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit në vlerë totale 10,500€, përfituesit kishin sjelle raporte financiare, por që raportet nuk ishin mbështetur me dëshmi (fatura, pagesa, kontrata etj), derisa për projektin në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në vlerë 13,500€, përfituesi nuk kishte dorëzuar fare raport financiar dhe narrativ.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së monitorimit dhe neglizhencës nga zyrtarët përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga OJQ-të përfituese.

**Ndikimi**

Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit nuk siguron se mjetet financiare janë shpenzuar për qëllimin e dedikuar.

**Rekomandimi B13**

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullores përkatëse.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B14 - Thirrjet publike për subvencionim të fermerëve jo në pajtim me kërkesat e Rregullores komunale për subvencionim**

**Gjetja**

Sipas nenit 25 të Rregullores se brendshme të komunës nr. 03/2020 për përkrahjen e fermerëve në bujqësi dhe bizneseve në sektorin privat, dokumentet e nevojshme për të aplikuar për subvencione dhe grante për fermerë të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen të subvencioneve dhe granteve në lëmin e bujqësisë, për personat fizikë përfshijnë, duke mos u kufizuar janë: projektin ideor, dëshmi për pagesën e taksave komunale, dëshmi mbi pagesën e tatimit ne pronë, deklaratë se nuk është përfitues i një granti të ndarë nga pushteti qendror apo lokal në këtë fushë brenda vitit fiskal.

Në thirrjen publike nr. 83.23 për subvencionimin e fermerëve në bujqësi (pagesa direkte për bletë, deleve, etj.) me vlerë të përkrahjes 55,944€, dhe në thirrjen publike nr. 04922/23 për subvencionimin e prodhimtarisë së

qumështit në vlera e përkrahjes 73,534€, mungonin kërkesat e përcaktuara me rregulloren komunale si: projekti ideor, dëshmia për pagesën e tatimit në pronë dhe deklarata se nuk është përfitues i një ndonjë granti nga ndonjë tjetër institucion publik.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të mirëfilltë të kontrolleve të brendshëm gjatë përgatitjeve të thirrjeve publike, gjë që ka ndikuar që dëshmitë e kërkuara të mos jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme të komunës.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i kërkesave të thirrjeve publike për subvencionimin e fermerëve në bujqësi me rregulloren e brendshme ndikon në menaxhimin jo të drejt dhe efikas të mjeteve të ndara për subvencione në lëmin e bujqësisë, apo në diskriminimin e aplikuesve të tjerë.

**Rekomandimi B14** Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të duhura për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë që kërkesat për dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me rregulloren e brendshme për subvencione.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B15 - Mos përgatitja e Planit vjetor për subvencionimin e OJQ-ve dhe Raportit vjetor për subvencionet e dhëna.**

**Gjetja**

Rregullorja 04/2017-mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 6, ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës.

Komuna nuk e ka hartuar planin vjetor për mbështetje financiare publike për OJQ-të, dhe as Raportin vjetor për subvencionet e dhëna.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos koordinimit në mes zyrës së financave dhe drejtorive komunale, për të përgatitur një plan vjetor të konsoliduar për subvencionim.

**Ndikimi** Mungesa e planit vjetor për subvencionim krijon paqartësi dhe mungesë informacioni për palët e interesit dhe institucionet shtetërore se në cilat fusha do të dedikohet buxheti i subvencioneve,

**Rekomandimi B15** Kryetari duhet të sigurojë përgatitjen e planit vjetor për subvencionim dhe i njëjti të dërgohet te zyra e qeverisjes së mirë në ZKM, si dhe përgatitjen dhe publikimin e raportit vjetor për përfituesit e subvencioneve sipas kërkesës rregullative.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,012,557€, prej tyre në vitin 2023 ishin shpenzuar 8,078,586€. Struktura e investimeve kapitale përbëhet nga investimet në infrastrukturën rrugore, rregullimin e lumenjve, mirëmbajtjen investive, ujësjellës, ndërtimin dhe renovimin e objekteve shëndetësore, arsimore dhe kulturore, makineri, furnizime me pajisje mjekësore, pajisje tjera, etj.

**Çështja B16 - Vonesa në realizim të projekteve kapitale dhe mos raportim tremujor i progresit fizik dhe financiar i projekteve në departamentin e buxhetit**

**Gjetja**

Ligji nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore, neni 4, përcakton se OB-të përmes sistemit PIP duhet të raportojnë në MF / departamentin e buxhetit, nga mbyllja e secilit tremujor, për progresin fizik dhe financiar për projektet kapitale mbi 1,000,000€.
Në secilën kontratë publike përcaktohet afati kohor i fillimit dhe përfundimit të punimeve, furnizimeve dhe shërbimeve. Ndërlidhur me këtë, neni 70.5, i Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, specifikon se pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari Kryesor Administrativ do ta emërojë MK përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike dhe një mbikëqyrës të drejtpërdrejte të MK. Për më tepër, neni 70.10, përcakton që pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës (MK), i njëjti duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës.

Nga testimet kemi identifikuar se nëntë (9) kontrata publike për punë nuk ishin realizuar sipas afatit kohor të përcaktuar me kontratë dhe as nuk ishin aplikuar penalet për vonesat, në këto raste:

- Kontrata për Ndërtimin e objektit të zyrave të administratës në QKMF në vlerë 174,933, duhej të përfundonin jo më vonë se 30.09.2023, deri në kohën e auditimit (mars 2024), punimet nuk kishin përfunduar.
- Kontrata për Ndërtimin e rrugëve lokale në 7 fshatra Lot 2 në vlerë 108,157€, e nënshkruar më datë 24.10.2022, duhej të realizohej brenda 50 ditëve. Kontrata nuk ishte realizuar deri në fund të vitit 2023.
- Kontrata për Ndërtimin e parqeve dhe hapësirave publike në fshatin Stanoc në vlerë 65,184€, është nënshkruar më datë 26.10.2022, dhe duhej të përfundonte brenda 35 ditëve. Punimet janë kryer me 7 muaj vonesë.
- Kontrata për Sinjalizim ndriçues me monitor digjital informues në katër hyrje të qytetit të Vushtrrisë në vlerë 49,498€, e nënshkruar me datë 06.10.2023, duhej të përfundonte brenda 30 ditëve kalendarike nga data e fillimit të implementimit. Kontrata nuk kishte përfunduar as deri në mars 2024.
- Punimet për kontratën Renovimi i palestrës sportive "Jeton Tërstena" në vlerë 114,900€, ishin përfunduar me 7 muaj vonesë.
- Kontrata për Sinjalizimin horizontal dhe vertikal në vlerë 69,821€, duhej të përfundonte brenda 40 ditëve kalendarike, derisa punimet janë realizuar me vonesë prej 190 ditëve.
- Kontrata për Ndërtimin e rrethojave në SHFMU "Bajram Curri dhe në Qerdhën 2" në vlerë 28,611€, ishte realizuar me 35 ditë vonesë.
- Kontrata për Renovimin e shkollave sipas lot 1 deri lot 4 në vlerë

59,873€, duhej të përfundonte deri në fillim të muajit gusht 2023. Punimet kishin përfunduar nga gjysma e muajit dhjetor, apo gati me 5 muaj vonesë.

- Kontrata për Ndërtimin e rrethojave të fushave sportive dhe oborreve në shkolla në vlerë 31,498€, ishte realizuar me 45 ditë vonesë, derisa pranimi teknik i punimeve nga komisioni ishte bërë me 85 ditë vonesë.
- Kontrata për Asfaltimin e rrugës Vesekovac-Sllakoc në vlerë 110,000€, e nënshkruar më datë 08.11.2022 dhe duhej të përfundonte brenda 60 ditëve, përderisa projekti kishte përfunduar në qershor 2023,
- Kontrata për Ndërtimin e rrugës me kubëza betoni Rr. "Fehmi Tahir Istrefi", lot 1 deri 3 në vlerë 91,387€, e nënshkruar më datë 06.07.2023, duhej të përfundonte brenda 65 ditëve. Punimet nuk janë përfunduar brenda afatit për shkak të planifikimeve joadekuate dhe nevojës për aneks kontratë shtesë,
- Kontrata për Rregullimin e oborrit të QKMF-së në vlerë 30,654€, e nënshkruar më 22.08.2022 duhej të përfundonte brenda 45 ditëve, situacioni i parë ishte përfunduar në prill 2023, derisa pagesa e dytë në fund të vitit 2023.
- Për kontratën Projektimi i projekteve të infrastrukturës Lot 1 në vlerë indikative të kontratës 220,000€, vendimi për caktimin e MK dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit ishte marrë 42 ditë pas nënshkrimit, derisa Plani për Menaxhimin e Kontratës është përgatitur dhe nënshkruar nga MK 2 muaj pas datës së nënshkrimit të kontratës.

Për më tepër, Komuna e Vushtrrisë nuk kishte raportuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve përmes sistemit PIP, nga mbyllja e secilit tremujor, për progresin fizik dhe financiar të projekteve me vlerë mbi 1,000,000€. Po ashtu, MK dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë nuk kanë plotësuar mjaftueshëm të dhënat lidhur me menaxhimin e kontratës dhe vlerësimin e performancës së kontratave në modulin e menaxhimit të kontratave në platformën e-prokurim. Nga regjistri i 262 kontratave publike kemi konstatuar se vetëm për 42 kontrata publike ishin bërë vlerësimet e performancës.

Kjo ka ndodhur për shkak të menaxhimit jo të mirë të kontratave publike, si dhe për shkak të hyrjes në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore. Mos përdorimi i modulit për menaxhim të kontratës në e-prokurim ka ndodhur për mungesës së informatave të duhura nga MK rreth aplikimit të modulit për menaxhimin e kontratës në e-prokurim.

**Ndikimi** Mos implementimi i kontratave publike brenda afateve kohore ka ndikim negativ në aspektin buxhetor dhe operacional, dhe se kjo reflekton drejtpërsëdrejti në mos ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve me kohë për qytetarët. Mos raportimi për progresin e fizik të projekteve kapitale, dhe mos përditësimi i informatave rreth implementimit të kontratave në modulin elektronik pamundëson analizimin, përcjelljen dhe vlerësimin e performances së realizimit të kontratës.

**Rekomandimi B16** Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike të realizohen sipas afateve kohore dhe kushteve tjera kontraktuale. MK për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave, dhe në rastet kur ato janë të paarsyetuara, të aplikohen penalet. Gjithashtu, drejtoria e financave përmes sistemi PIP, në

baza tremujore, të raportoj për progresin fizik dhe financiar në departamentin e buxhetit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A8 - Blerja e makinerisë së përdorur**

**Gjetja**

Opinioni i KRPP-së i datës 22.11.2022, shpjegon që prokurimi i mallrave të përdorura nuk rekomandohet, ngase specifikimet teknike që përcaktohen nga autoriteti kontraktues nuk garantojnë domosdoshmërisht se dy apo më shumë mallra që kanë të njëjtat specifikime teknike kanë edhe kapacitetet e njëjta në kushtet performancës dhe funksionalitetit. Kjo është për shkak të faktit të paparashikueshëm dhe të pa kontrollueshëm sepse një produkt mund të jetë në gjendje më të mirë se tjetri, apo thjesht njëri më pak i prishur se tjetri.

Arsyet e tilla në të vërtetë mund të ndikojnë në cilësinë, performancën dhe funksionalitetin e mallrave dhe mund të bëjnë blerje krejtësisht jo efektive për autoritetin kontraktues. Pamundësia për të krahasuar dy tenderë identik do të përbëjë një shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të konkurrentëve. Sidoqoftë, prokurimi i mallrave të përdorura mbetet në përgjegjësi të autoritetit kontraktues.

UA (MPB) nr. 08/20219 për përcaktimin e pajisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrëfikje dhe shpëtim, me nenin 15, pika 1.2 përcakton që afati i përdorimit të automjeteve zjarrëfikse në gjendje të rregulltë teknike është deri në 15 vite nga viti i prodhimit.

Komuna ka blerë një autocisternë zjarrfikëse të vjetër të vitit 1995 në vlerë 69,468€. Me dosjen e tenderit ishte përcaktuar që viti i prodhimit të mos jetë më i vjetër se 1993. Komuna duke blerë automjet 28 vite të vjetër, nuk ka respektuar UA (MPB) nr. 08/2019, që lejon përdorimin e automjeteve zjarrëfikse të vjetra deri në 15 vite.

Nga zyrtarët përgjegjës blerja e automjetit të përdorur është arsyetuar me mungesën e buxhetit.

**Ndikimi**

Blerja e makinerisë së vjetër ka ndikim në performancën dhe funksionalitetin e automjetit për përdorim në rastet e emergjente. Ky lloj i kontraktimit mund ta bëjë blerjen jo efektive dhe të shkaktojë kosto shtesë financiare për mirëmbajtje dhe servisim për shkak të vjetërsisë së automjetit. Blerja e makinerisë së përdorur, nuk siguron dhe vë në pikëpyetje kapacitetin dhe funksionalitetin e përdorimit të tij në raport me paranë e shpenzuar.

**Rekomandimi A8**

Kryetari duhet të sigurojë që fondet publike për blerje të përdoren në mënyrën më ekonomike duke mundësuar që të merret vlera për para. Automjetet e dedikuara për njësinë e zjarrëfikjes të jenë në përputhje me kërkesat e UA (MPB) nr. 08/0219.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A9 - Pagesa e situacioneve të punimeve jo në pajtim me kushtet e veçanta të kontratës**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK), neni 27.1, përcakton se për çdo pagesë të ndalet 10% e vlerës, dhe kjo shumë e mbajtur e parasë do të paguhet brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në neni 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar.<br><br>Në gjashtë (6) pagesa për projekte kapitale në vlerë 161,359€, menaxherët e kontratave nuk kishin mbajtur 10% të vlerës nga çdo pagesë / situacion të punimeve, dhe as nuk kishin zëvendësuar mbajtjen e parasë me garancion bankar.<br><br>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta në menaxhimin e kontratave dhe pranimit të situacioneve për pagesë. |
| **Ndikimi** | Mos mbajtja e parasë i pamundëson autoritetin kontraktues kompensimin e dëmeve që mund të ndodhin gjatë implementimit të kontratave. |
| **Rekomandimi A9** | Kryetari duhet të sigurojë së menaxherët e kontratave zbatojnë në tërësi kushtet e veçanta të kontratës, dhe nga secila pagesë e situacioneve të aplikojnë mbajtjen e parasë në 10% të vlerës në rastet kur nuk ofrohet garanci bankare nga kontraktuesit. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.6 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2023 në total janë 6,460,793€. Saldo e të arkëtueshmëve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, leje ndërtimore, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale, etj.

**Çështja B17 - Rritje e llogarive të arkëtueshme**

**Gjetja**

Rregulla Financiare 03/2010 për të hyrat, rregullon kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Llogaritë e arkëtueshme kanë tendencë rritje, derisa në fund të vitit 2022 të arkëtueshmet ishin 5,796,928€, në fund të vitit 2023 ato ishin 6,460,793€, përkatësisht janë rritur për 667,166€ apo 11.5% në krahasim me vitin paraprak. Rritja më e theksuar është te taksat për mbeturina dhe taksat për leje ndërtimore.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

**Ndikimi**

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

**Rekomandimi B17**

Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes se veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.7 Funksioni i auditimit të brendshëm

NjAB ka përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor të punës, dhe ka realizuar auditimit e planifikuara. NjAB përbëhet nga vetëm dy auditor të brendshëm. Komiteti i Auditimit ka mbajtur takime pune dhe ka shqyrtuar raportet e auditimit të brendshëm.

**Çështja B18 - Nivel jo i duhur i adresimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm, dhe mos plotësim i NjAB-së me numrin e duhur të auditorëve të brendshëm**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Në planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve jepen afatet dhe veprimet që do të ndërmerren nga menaxhmenti për zbatimin e tyre. Rregullorja 01/2019 për themelimin e NjAB-së, neni 5.1.1, përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi 7mil € duhet të ketë së paku tre auditorë të brendshëm.<br><br>Në raportin vjetor të punës, NjAB ka vlerësuar se nga 21 rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit të brendshëm, vetëm 9 rekomandime janë adresuar plotësisht nga menaxhmenti. Gjithashtu, menaxhmenti nuk ka adresuar rekomandimin e vitit të kaluar që NjAB-në ta plotësojë me së paku tre (3) auditorë të brendshëm.<br><br>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve të dobëta dhe mos ndërmarrjen e veprimeve konkrete në adresimin e rekomandimeve të NjAB-së dhe rekomandimit të ZKA-së. |
| **Ndikimi** | Mos adresimi i rekomandimeve ndikon në mos përmirësimin dhe përsëritjen e mangësive të njëjta. Mungesa e numrit të duhur të auditorëve të brendshëm do të ndikojë në mos përfshirjen e duhur të aktiviteteve operative në planifikimet vjetore të punës së NjAB-së. |
| **Rekomandimi B18** | Kryetari duhet të sigurojë zbatimin në tërësi të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe që NjAB-në ta plotësojë me numrin e mjaftueshëm të auditorëve. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[7] | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **23,373,910** | **27,503,054** | **26,213,118** | **18,327,419** | **18,297,176** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 20,473,351 | 21,843,710 | 21,238,617 | 15,281,820 | 15,664,569 |
| Financimi përmes huamarrjes | 0 | 0 | 0 | 158,056 | 52,937 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 2,733,627 | 2,561,003 | 1,426,001 | 1,174,440 |
| Të hyrat vetanake | 2,900,559 | 2,900,559 | 2,411,650 | 1,392,598 | 1,085,992 |
| Donacionet vendore | 0 | 6,048 | 1,848 | 48,236 | 25,894 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 19,109 | 0 | 20,707 | 293,344 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 4,129,144€. Kjo rritje është rezultat i vendimeve të qeverisë në vlerë 1,503,713€, të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë 2,733,627€, si dhe donacioneve në vlerë 25,156€.

Komuna ka shpenzuar 26,214,018€ ose 95.3% të buxhetit përfundimtar të vitit 2023, me një përmirësim prej 14.3% në krahasim me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Në vitin 2023 Komuna ka përfituar 350,837€ të hyra nga gjobat në trafik dhe 40,970€ nga gjobat e gjykatave. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe i inkasojnë institucionet përkatëse, ndërsa Komunës i alokohen në baza tremujore gjatë vitit për realizim të pagesave.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **23,373,910** | **27,503,054** | **26,213,118** | **18,327,419** | **18,297,176** |
| Pagat dhe mëditjet | 10,796,373 | 12,166,732 | 12,140,868 | 10,100,514 | 10,603,104 |
| Mallrat dhe shërbimet | 3,904,187 | 4,687,020 | 4,416,993 | 3,306,294 | 3,109,691 |
| Komunalitë | 472,500 | 483,590 | 447,458 | 381,075 | 309,362 |
| Subvencionet dhe transferet | 942,000 | 1,153,155 | 1,129,213 | 1,183,529 | 836,871 |
| Investimet Kapitale | 7,258,850 | 9,012,557 | 8,078,586 | 3,356,007 | 3,438,148 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:
• Buxheti për Paga e Mëditje është rritur për 1,370,359€. Rritja është rezultat i vendimeve të qeverisë në shumë 1,357,127€, dhe pranimeve në shumë 13,232€ me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të dedikuara për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
• Buxheti i Mallrave dhe Shërbimeve është rritur për 782,833€. Rritja është ndikuar nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar në vlerë 782,672€, dhe nga donacionet e pashpenzuara nga vitet e kaluara në vlerë 160€.
• Buxheti për Shërbime Komunale është rritur për 11,090€, nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar.
• Buxheti për Subvencione dhe Transfere është rritur për 211,155€, nga bartja e të hyrave të vitit të kaluar.
• Buxheti për Investime kapitale është rritur për 1,753,707€. Rritja është ndikuar nga të hyrat e bartura nga viti i kaluar në shumë 1,728,710€, dhe nga donacionet e pashpenzuara nga vitet e kaluara në vlerë 24,997€. Programi i Investimeve Publike përfshin 196 projekte kapitale të vitit aktual dhe viteve paraprake. Projektet kryesisht janë dedikuar për infrastrukturë rrugore, ujësjellës, fusha sportive, rregullim të lumenjve, kanalizim, ndërtim dhe renovim të objekteve arsimore dhe shëndetësore, makineri, pajisje, etj.

Komuna e Vushtrrisë ka përfituar nga programi i rimëkëmbjes ekonomike mjete në vlerë 13,232€ €, të cilat janë shfrytëzuar nga sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023




Të hyrat e realizuara nga Komuna në vitin 2023 ishin 3,407,323€. Ato kanë të bëjnë kryesisht nga të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga taksat në mbeturina, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë e bizneseve, të hyrat nga qiraja, participimet, dhe taksat tjera komunale.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **2,900,559** | **2,900,559** | **3,408,023** | **2,569,400** | **2,670,051** |
| Të hyrat tatimore | 1,152,144 | 1,152,144 | 1,268,599 | 969,623 | 895,449 |
| Të hyrat jo tatimore | 1,748,415 | 1,748,415 | 2,138,724 | 1,599,777 | 1,772,618 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 700 | | 1,984 |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Komunës së Vushtrrisë ka rezultuar me 21 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna, si dhe ka përgatitur raport periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të vitit 2022. Raporti i auditimit për vitin 2022 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në kuvendin komunal.
Deri në fund të auditimit për vitin 2023, dy (2) rekomandim ishte adresuar, 18 rekomandimet nuk ishin adresuar, dhe një (1) nuk është i aplikueshëm më. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të thelloj bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, për të siguruar që mjetet për kryerjen e obligimeve që kanë mbetur nga marrëveshja kolektive (para aprovimit të Ligjit të pagave) apo obligimeve tjera, të buxhetohen dhe të paguhen me kohë dhe nga kategoritë përkatëse, për të shmangur keqklasifikimin dhe shpenzimet e panevojshme. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk është i aplikueshëm më |
| 2. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë marrjen e masave të nevojshme për forcimin e kontrollit të brendshme në mënyrë qe dokumentet e nevojshme për subvencionimin e fermerëve të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e përcaktuara me rregulloren e brendshme të komunës për subvencione. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara, si dhe këto mjete të paguara të kthehen në buxhetin e komunës. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 4. | Të hyrat | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë në departamentin e tatimit në pronë, në mënyrë që numrat e letërnjoftimit të përmirësohen në sistemin ProTax. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 5. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të sigurojë që komuna të pranoj faturat sipas specifikave të përcaktuara në marrëveshje dhe vlerat e faturës të jenë në pajtim me marrëveshjen për pagesat e caktuara mujore. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 6. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhet të sigurojë se personat përgjegjës përgatitin Planin Vjetor për Mbështetje Financiare për Organizatat Joqeveritare (OJQ) dhe të sigurojë se i njëjti përmban të gjitha kërkesat e përcaktuara me rregullore për Mbështetje Financiare. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 7. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhe të sigurojë marrjen e masave të nevojshme që procesi i vlerësimit për subvencione të jetë në pajtueshmëri të plotë me kriteret e përcaktuara në thirrje publike për subvencione. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 8. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhet të sigurojë që zyrtari përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara, zbaton të gjitha procedurat e kontrollit, për raportimin e tyre që të arrijnë të arsyetojnë shpenzimet sipas memorandumit, dhe monitorimeve apo raportimeve sipas kërkesës së rregullores përkatëse. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 9. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë që në të ardhmen përmes zyrtarëve përgjegjës, sigurimet e ekzekutimit për projektet e përfunduara duhet të kenë vlefshmëri në raport me periudhën e përmbushjes së kontratës ashtu siç parashihet me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 10. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues të cilat do të ndikonin në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë që mos të fillohen projektet pa u siguruar çështjet pronësore, hartimit të specifikave adekuate të projekteve përmes projekteve ekzekutive dhe se menaxherët e kontratave për çdo raport të punëve të sqarojnë arsyet e vonesave. Po ashtu, për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen penalet e parapara me kontratë. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 12. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë kontrolle në procesin e vlerësimit të ofertave, në mënyrë që përzgjedhja e fituesve të bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. | Edhe këtë vit janë identifikuar mangësi. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 13. | Çështjet e përbashkëta | Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet/kategoritë adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe saktë sipas kodeve ekonomike adekuate. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 14. | Pasuritë | Kryetari, duhet të sigurohet që do të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive kapitale konform gjetjeve të auditimit të trajtuara me lartë për të siguruar se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 15. | Pasuritë | Kryetari duhet te sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore. | Janë ndërmarrë disa veprime në inventarizimin e pasurisë. | I zbatuar |
| 16. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për Llogaritë e Arkëtueshme në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 17. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës ruajnë gjithë dokumentacionin e nevojshëm për llogaritë e arkëtueshme të taksës në biznes dhe të siguroj funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të taksës në biznes. Po ashtu duhet të merren të gjitha masat ligjore për trajtimin e borxheve në taksat në biznes. | Situatë e njëjtë është edhe në vitin 2023. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 18. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit, regjistrimit dhe arkëtimit të tyre, do të ishin disa nga masat që mund të sjellin përmirësime. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 19. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për obligimet e pa paguara në mënyrë që prezantimi i tyre në Pasqyra Financiare Vjetore të jetë i saktë dhe i drejtë. | Edhe këtë vit janë hasur gabime në prezantim të obligimeve në PVF. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 20. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të sigurojë planifikim më të mirë të alokimit dhe zotimit të mjeteve si dhe inicimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur mjetet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik. Po ashtu, të forcojë që të gjitha obligimet të paguhen në afatin ligjor prej 30 ditësh. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 21. | Auditimi i Brendshëm | Kryetari duhet të sigurojë që sa më parë të zhvilloj procedurat për auditor, për plotësimin me staf të mjaftueshëm, bazuar në rregulloren për themelimin e Njësisë për Auditmin e Brendshëm. | Nuk janë ndërmarrë veprime. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Ramadan Gashi, Drejtor i Auditimit

Ilir Abazi, Udhëheqës i ekipit

Ardian Bytyqi, Anëtar i ekipit

# Shtojca I: Letër konfirmimi

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

919/24
11.06.2024

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **KK-Vushtrri** për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; DRAFT-RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE
- VJETORE TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR VITIN 2023
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ferid Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

Data: 11.06.2024

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[8] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[9], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
***Forma e opinionit***

### Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

### Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

### Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

### *Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Për Kontratën publike Asfaltimi i rrugës Vesekovac-Sllakoc në vlerë 110,000€, Kontrata publike për Ndërtimin e rrugëve lokale në 7 fshatra Lot 2, në vlerë 108,157€, për Kontratën publike për Ndërtimin e objektit të zyrave të administratës në QKMF, në vlerë 174,933€, Kontrata publike për Renovimin e palestrës sportive Jeton Tërstena, në vlerë 48,260€,Për kontratën e punëve për Ndërtimi i rrethojave të fushave sportive dhe oborreve në shkolla në vlerë 31,498€.

[6] Kontrata për Ndërtimin e trotuareve në fshatrat Prelluzhë, Bukosh dhe Stanoc i Poshtëm në vlerë 83,400€, Kontrata për Ndërtimin e parqeve dhe hapësirave publike në fshatin Stanoc në vlerë 65,184€, Kontrata e punëve Ndërtimi i kanalizimeve Lot 1 në vlerë 506,130€, Kontrata publike për Ndërtimin e kanalizimeve në vlerë 579,486€, dhe Kontrata e punëve për Renovimin e shkollave sipas lot 1 deri lot 4 në vlerë 59,873€.

[7] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[8] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[9] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

| | |
|---|---|
| **DATË:** | **04.07.2024** |
| **PËR:** | **KPF dhe Kuvendin e Komunës** |
| **NGA:** | **Komisioni Komunal i Aksionarëve**<br><br>**Kryesuesi i Komisionit, Qemajl Hasani** |
| **LËNDA:** | **Raport i Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2023** |

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Raportin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për vitin 2023.

Me respekt!

# RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

**Përmbajtja**

HYRJE ..... 3
1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE ..... 4
1.1 EMËRIMI I BORDIT TË DREJTORËVE ..... 5
1.2 CAKTIMI I KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE ..... 7
1.3 CAKTIMI I KOMISIONIT TË AUDITIMIT ..... 7
1.4 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES ..... 8
2. NUMRI I PUNONJËSVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR ..... 9
3. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E VUSHTRRISË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE ..... 10
4. AKTIVITETET E OFRUARA NGA ANA E NDËRMARRJES GJATË VITIT KALENDARIK 2023 ..... 11
4.1 MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË ..... 11
4.2 PASTRIMI I OBJEKTEVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE ..... 12
4.3 SIGURIMI FIZIK ..... 12
4.4 PËRGATITJET PËR MARRJEN E SHËRBIMIT PËR MBLEDHJEN DHE TRANSPORTIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE ..... 13
5. QARKULLIMI I NDËRMARRJES PËR VITIN KALENDARIK 2023 ..... 14
6. LETRA E MENAXHMENTIT DHE OPINIONI I AUDITIMIT TË JASHTËM ..... 15

Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Përparimi” SH.A. i emëruar sipas vendimit të Kuvendit Komunal të Vushrtrrisë, me Nr. të protokollit 27/22 i datës 31.01.2022 në përbrje: 1. Mensur Kosumi dhe 2. Agim Bregaj si dhe anëtari Qemajl Hasani i emëruar në bazë të vendimit të Kryetarit të komunës së Vushtrrisë me Nr. protokollit nr.1736/22 i datës 27.12.2022, si dhe në baze të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarjet Publike, të Nenit 8. Paragrafit 8.2 Kuvendit Komunal të Vushtrrisë i paraqet këtë:

# R A P O R T

(Raportimi para publikut mbi Përformancen e Aksionarëve mbi mënyren e ushtrimin të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me legjislacionin në fuqi)

## Hyrje

Ky raport është hartuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve në përputhshmëri me nenin 8, paragrafi 8.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike në të cilin thuhet si në vijim: *“**8.2 Çdo Komision Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të cilat u janë dhënë me këtë ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t’i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësive, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6, paragrafi 6.2 të këtij ligji.. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t’i sigurojë të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NP-së përkatëse Lokale në interes të Komunës ose Komunave përkatëse**”.*

Në këtë raport janë bërë sqarimet lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Komisioni në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike, dhe në të njëjtën kohë është bërë një sqarim në lidhje me numrin e të punësuarve të ndërmarrjes në fund të vitit kalendarik 2023, po ashtu në kuadër të këtij raporti kemi përfshirë pasqyrat vjetore të ndërmarrjes për vitin

kalendarik 2023[1], ku i kemi bashkëngjitur letrën e menaxhmentit dhe opinionin e auditorit të jashtëm në lidhje me vërtetësinë e Pasqyrave Vjetore Financiare.

**Qëllimi:**

Të paraqes në mënyrë objektive se në çfarë mase janë realizuar objektivat e Komisionit Komunal të Aksionarëve, dhe në të njëjtën kohë të vlerësohet performanca e ndërmarrjes për vitin kalendarik 2023.

**Objektivat:**

- Emërimi i Bordit të Drejtorëve;
- Funksionalizimi i Komisionit të Auditimit;
- Caktimi i kompensimit për Komisionin e Auditimit në pajtueshmëri me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 07/81 të datës 23.03.2016;
- Vlerësimi i punës së ndërmarrjes në përgjithësi;

## 1. EMËRIMI DHE PUNA E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

[1] Sqarim: Të dhënat që gjenden në Kapitujtë 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 janë dërguar nga ana e ndërmarrjes.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me datë 31.01.2022, kishte marr vendimin me të cilin kishte zgjedhur/emëruar dy (2) anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A. Këtë vendim e kishin bazuar në nenin 5, paragrafi 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: ***"5.2 Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal."***.

Me datë 03.02.2022, Kryetari i Komunës duke zbatuar nenin e mësipërm kishte emëruar një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës si Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve, të cilit edhe i besohet nga anëtarët e Komisionit, roli i Kryesuesit të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

Neve gjatë kësaj periudhe kemi zbatuar dhe jemi duke zbatuar Ligjet si në vijim: Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Nga data 27.12.2022, është zëvendësuar Kryesuesi i Komisionit Komunal të Aksionarëve me një anëtar tjetër nga ekzekutivi.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni punën e Komisionit Komunal të Aksionarëve:

**Tabela nr. 1:** Puna e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

| Nr. | Lloji i aktivitetit | Viti 2023 |
|---|---|---|
| **1.** | Mbledhje të rregullta të mbajtura nga Komisioni Komunal i Aksionarëve | 5 |
| **2.** | Procesverbale të miratuara nga Komisioni Komunal i Aksionarëve | 5 |
| | Konkurse publike të shpallura | 1 |
| **3.** | Vendime nga Komisioni Komunal i Aksionarëve | 9 |
| **4.** | Emërim i Bordit të Drejtorëve | 1 |
| **5.** | Njoftime | 2 |

## 1.1 EMËRIMI I BORDIT TË DREJTORËVE

Me datë 11.01.2023 KKA ka shpallur konkursi publik për përzgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, i cili konkurs publik është shpall në përputhshmëri me Nenin 5, paragrafi 5.2, Nenin 16 , paragrafi 16.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Nenin 164 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Nenin 17 të Statutit Nr. 252/22 të N.P.L "Përparimi" Sh. A të miratuar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve ku

periudha e aplikimit ka qenë e hapur prej tridhjetë (30) ditë kalendarike dhe atë nga data 11.01.2023 deri me datë 11.02.2023 në ora 16:00.

Për t'u përzgjedhur për Anëtarë të Bordit të Drejtorëve kanë aplikuar trembëdhjetë (13) kandidatë. Nga ta kanë plotësuar kushtet që të marrin pjesë në procedurat e mëtutjeshme vetëm shtatë (7) kandidatë. Kandidatët të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet për të marr pjesë për intervistim me gojë, u është dhënë mundësia që nga dita e njoftimit për kandidatët që plotësojnë kushtet e konkursit publik, në afat prej (3) ditësh të parashtrojnë vërejtje në lidhje me përpilimin e listës nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve. Pas kalimit të afatit prej tre (3) ditë, kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e konkursit publik janë njoftuar në lidhje me datën dhe orën se kur dhe ku, do të mbahet intervistimi me gojë, dhe atë janë njoftuar me anë të E-mail- adresës dhe me anë të telefonit.

Pas përfundimit të të gjitha fazave të përzgjedhjes me datë 14.03.2023, është publikuar vendim për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, me të cilën kandidatëve të pakënaqur u është dhënë mundësia që të parashtrojnë padi në gjykatën kompetente brenda afatit tridhjetë (30) ditë nga dita e publikimit të njoftimit, mirëpo që ankesa nuk e shtyn ekzekutimit e këtij vendimi (nuk ka efekt suspensiv).

Detyrat dhe Përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 04/L-11 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe i Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin e N.P.L "Përparimi" Sh. A.

Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes do të jetë në periudhë tre (3) vjeçare. Kompensimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes, do të bëhet në pajtim me nenin 20 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Aktiviteti i Bordit të Drejtorëve për vitin kalendarik 2023 pas emërimit nga ana e Komisionit Komunal të Aksionarëve, mund të shihet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr. 2:** Puna e Bordit të Drejtorëve.

| **Nr.** | **Lloji i aktivitetit** | **Viti 2023** |
|---|---|---|
| **1.** | Mbledhje të rregullta të mbajtura nga Bordi i Drejtorëve | 11 |
| **2.** | Procesverbale të miratuara nga Bordi i Drejtorëve | 12 |
| **3.** | Vendime nga Bordi i Drejtorëve | 42 |
| **4.** | Rregullore të miratuara | 6 |
| **5.** | Raport vjetor | 1 |
| **6.** | Raporte tre (3) mujore | 3 |
| **7.** | Plan i biznesit | 1 |

## 1.2 CAKTIMI I KOMPENSIMIT PËR ANËTARËT E BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve ka të drejtë në kompensim në bazë të nenit 2 , paragrafit 20.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ku thuhet se: ***“20.1 Drejtorëve do t’u paguhet një honorar themelor, i cili përcaktohet në përputhje me Nenin 20.2, për kohën e shpenzuar në mbledhjet e Bordit. Drejtorëve po ashtu do t’u paguhet një kompensim për stimulimin e efektshmërisë në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimin e cila përgatitet dhe zbulohet nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni.”***.

Pasi që me datë 22.08.2022, veçse është marr vendimi për caktimin e kompensimit për anëtarët e Bordit të Drejtorëve, ai vendim vlen edhe për anëtarët e rinj të Bordit të Drejtorëve.

## 1.3 CAKTIMI I KOMISIONIT TË AUDITIMIT

Komisioni Komunal i Aksinarwve nw bazw tw ligjit tw NP Nr 03/L-087, nenit 24, paragrafit 24.1, me datwn 17.05.2023 ka marrw vendim me tw cilin ka caktuar Komisionin e Auditimit nga radhwt e Drejtoreve tw Bordit, ku 2 anwtar janw caktuar drejtor te cilët janë ekspert ose se paku kane njohur adekuate nw kontabilitet, ndërsa anwtari i teret, njw drejtor tjetwr pwrveq KE-sw ose kryesuesit tw cilwt detyrat dhe pwrgjegjwsit e tyra do ti ushtrojnw sipas Nenit 25 paragrafit 25.1, paragrafi 25.2 nga shkronja a) deri nw shkronjwn i), dhe Nenit 26,nga shkronja a) deri nw shkronjwn f) tw ligjit 03/L-087.

Funksionimi i Komisionit të Auditimit po ashtu rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe ligjeve tjera në fuqi.

Komisionit të Auditimit në të njëjtën kohë i është caktuar edhe shuma e kompensimit duke marr për bazë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 07/81 të datës 23.03.2016, në të cilën është paraparë kompensimi për anëtarët e Komisionit të Auditimit.

**Tabela nr. 3:** Puna e Komisionit të Auditimit.

| **Nr.** | **Lloji i aktivitetit** | **Viti 2023** |
|---|---|---|
| **1.** | Mbledhje të rregullta të Komisionit të Auditimit | 4 |
| **2.** | Procesverbale të miratuara nga Komisioni i Auditimit | 3 |
| **3.** | Vendime nga Komisioni i Auditimit | 5 |
| **4.** | Rregullore të miratuara | 2 |
| **5.** | Shqyrtime të Raporteve tre (3) mujore | 2 |
| **6.** | Rekomandime | 2 |

## 1.4 AKTET E BRENDSHME TË NDËRMARRJES

Komisioni Komunal i Aksionarwve bazuar nw kompetencat ekskluzive, siq e parasheh neni 34, paragrafi 34.1 te Ligjit Nr.04/L-087 si dhe Ligjit per Shoqerit Tregtare, ka aprovuar, ndryshuar, plotësuar dhe shfuqizuar tw gjitha rregulloret tw cilat i ka pergaditur NPL-ja.

Sipas nenit 34, paragrafit 34.4 Ministria është e autorizuar dhe ka detyrimin për të shpallur një grup të modeleve të rregulloreve për shfrytëzim nga NP-të, dhe secila NP duhet të sigurojë që rregulloret e saj të jenë në përputhje me këto modele. Ministria duhet të sigurojë që modelet e rregulloreve të jenë në përputhje me këtë ligj dhe ligjet e tjera të aplikueshme të Kosovës si dhe ti pasqyrojnë standardet e pranuara ndërkombëtare të qeverisjes korporative dhe ndërmarrjeve publike. Ministria po ashtu duhet të marrë parasysh modelet e rregulloreve të NP të miratuara paraprakisht nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Lista e rregulloreve nw fuqi tw cilat janë pwrgaditur nga NP dhe te aprovuara nga Komisioni Komunal i Aksionarwve wshtw si nw vijim:

1. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.
2. Rregullorja për Përgjegjësinë dhe Procedurat Disiplinore.
3. Rregullorja për Punën e Bordit të Drejtorëve.
4. Rregullorja mbi Përdorimin e Automjeteve Zyrtare.
5. Rregullorja për Marrëdhënien e Punës.
6. Rregullorja për Menaxhimin e Depos.
7. Kodi i Sjelljes dhe i Etikës.
8. Rregullorja për Shpenzimin e Parasë.
9. Rregullorja për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.
10. Rregullorja për Rojet dhe Përgjegjësitë e tyre.
11. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Marrëdhënien e Punës.
12. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Përgjegjësitë dhe Procedurat Disiplinore.
13. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Punën e Bordit të Drejtorëve.
14. Rregullorja për Punën e Komisionit të Auditimit.
15. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Puën e Komisionit të Auditimit.
16. Rregullorja për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës.

Me rastin e miratimit të Rregulloreve të lart cekura janë marr për bazë ligjet dhe Rregulloret që rrjedhin nga ligjet si në vijim:

1. Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
2. Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
3. Ligjin Nr. 05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111;
4. Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
5. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
6. Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
7. Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë së bashku me plotësim ndryshimet;
8. Rregullorja MF-NR. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare;
9. Rregull financiare Nr. 01/2013/MF- Shpenzimi i Parasë Publike;

## 2. NUMRI I PUNONJËSVE NË FUND TË MUAJIT DHJETOR

Numri i punwtorwve tw punwsuar nw ndërmarrjn Publike deri 31 dhjetor 2023 ishte siq shihet në tabelën e mëposhtme.

**Tabela nr. 4:** Puna e Komisionit Komunal të Aksionarëve.

| **Numri i punonjësve në N.P.L "Përparimi" Sh. A – 31, Dhjetor 2023** | |
|---|---|
| **Punonjësit sipas pozitës** | **Numri i punonjësve sipas pozitës** |
| Sigurim Fizik | 82 |
| Pastrues të Zyrave dhe Objekteve | 77 |
| Mirëmbajtës të Hapësirave Publike | 13 |
| Zyrtar i Arkivës | 1 |
| Udhëheqës të njësive | 4 |
| Mirëmbajtës shtëpiak | 2 |
| Shofer për Automjete Transportuese | 1 |
| Depoist | 1 |
| Asistent Administrativ | 1 |
| Elektricist | 4 |
| Asistente e Kryeshefit | 1 |
| Mbikëqyrës të terrenit | 2 |
| Mirëmbajtës i Servisit | 1 |
| Zyrtare në Administratë – Super Puna | 1 |
| Zyrtare e Kontabilitetit | 1 |

| | |
|---|---|
| Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit | 1 |
| **Totali i të punësuarve** | **193** |

Nëse përfshijmë menaxhmentin e ndërmarrjes që janë tre (3), dhe Bordin e Drejtorëve që janë katër (4), atëherë numri i të angazhuarve në ndërmarrje ka qenë dyqind **(200).**

## 3. MARRËVESHJET E NDËRMARRJES ME KOMUNËN E VUSHTRRISË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Ndërmarrja me datë 15.11.2022 ka lidhur marrëveshjen me nr. të protokollit **1451/22** për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë. Ndërmarrja pasi ka rritur pagën e të punësuarve nga vendimi që ka marr bordi i drejtorëve, i ka propozuar Komunës së Vushtrrisë, që të nënshkruajnë një aneks marrëveshje, dhe propozimi ka qenë si në vijim: ***"Për shërbimin e sigurimit fizik dhe pastrimit do të ngritet faturimi prej 20% nga vlera e kontraktuar me marrëveshjen me nr. të protokollit 542/21 të datës 17.05.2021."*.** Komuna ka pranuar lidhjen e aneks marrëveshje dhe ndërmarrja ka vazhduar faturimin e komunës për 20% më shumë në fushën e shërbimit të Sigurimit Fizik dhe Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve.

Ndërmarrja me Komunën e Vushtrrisë ka arritur marrëveshje që ndërmarrja të bëjë mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik në Komunën e Vushtrrisë, ashtu që nga muaji korrik ndërmarrja ka vazhduar në ofrimin e këtij shërbimi. Ndërmarrja ka aktualizuar Njësinë për Ndriçimin Publik në të cilën janë të angazhuar katër (4) punëtorë, të cilët ofrojnë shërbim për ndërmarrjen.

Me datë 16.11.2023, Ndërmarrja ka vazhduar kontratën që ka me Komunën e Vushtrrisë për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë, e cila kontratë do të ketë kohëzgjatje nga data 17.11.2023 deri me datë 16.11.2024. Në kuadër të kësaj kontrate është përfshirë aneksi i muajit korrik, meqë rast shërbimet që do të kryejë ndërmarrja për Komunën në bazë të kësaj marrëveshje janë si në vijim: Mirëmbajtja e Hapësirave Publike, Sigurimi Fizik i objekteve dhe institucioneve publike, Mirëmbajtja – Pastrimi i objekteve dhe institucioneve publike dhe mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik.

Ndërmarrja ka lidhur marrëveshje me Komunën për shërbimin e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale, mirëpo për të njëjtën do të flasim në nën kapitujt më poshtë.

Në tabelën e mëposhtme mund të shihni marrëveshjet e lidhura me komunën e Vushtrrisë sipas datës dhe nr. të protokollit.

**Tabela nr. 5:** Marrëveshjet e lidhura me Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit kalendarik 2023.

| Nr. | Marreveshja | Nr. i protokollit | Data |
|---|---|---|---|
| **1.** | Aneks Marrëveshja për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë | 373/23 | 29.03.2023 |
| **2.** | Aneks marrëveshja për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e Ndriçimit Publik Komunal | 875/23 | 12.07.2023 |
| **3.** | Marrëveshja për Kryerje të Shërbimeve Komunale në Komunën e Vushtrrisë | 1595/23 | 16.11.2023 |
| **4.** | Marrëveshja me Komunën e Vushtrrisë për Mbledhjen dhe Transportimin e Mbeturinave Komunale | 2045/23 | 29.12.2023 |

## 4. AKTIVITETET E OFRUARA NGA ANA E NDËRMARRJES GJATË VITIT KALENDARIK 2023

Ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2023 ka ofruar shërbime për Komunën e Vushtrrisë, dhe atë në bazë të marrëveshjeve që kemi cekur në kapitullin më lartë. Për këtë arsye në nënkapitujt e mëposhtëm do të shtjellohen aktivititetet e ofruara.

### 4.1 MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE PUBLIKE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

Njëra nga veprimtaritë kryesore të ndërmarrjes, është "Mirëmbajtja e Hapësirave Publike Komunale", meqë rast ndërmarrja duke ofruar këtë shërbim ka për synim kryesor ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit.

Ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2023 ka ofruar shërbimet në fushën e mirëmbajtjes së hapësirave publike për Komunën e Vushtrrisë si në vijim:

1. Kositjen e të gjitha hapësirave publike komunale të gjelbëruara;
2. Pastrimin e shtretërve të lumenjve "Tërstena" dhe "Podranqa";
3. Mirëmbajtjen e shëtitores dhe anësorëve afër Lumit Silnica duke përfshirë pjesën e kubëzuar me gurë;
4. Mbjelljen e drunjve dekorativ;
5. Krasitjen e drunjve dekorativ;
6. Ujitja e drunjve dekorativ;
7. Mbjellja dhe ujitja e luleve;
8. Prashitjen e luleve
9. Mbjelljen e barit artificial;
10. Pastrimi nga bora;
11. Vendosjen e flamujve (së bashku me shtiza) kombëtar, shtetëror apo të aleatëve në qyteti, memorialë, lapidare, varreza të dëshmorëve dhe martirëve.
12. Bartjen e inventarit të demoluar nga objektet e komunës.

**13.** Pastrimi i përroskave dhe kanaleve në Komunën e Vushtrrisë.
**14.** Bartjen e kontejnerëve të reciklimit.
**15.** Largimi i deponive ilegale;
**16.** Debllokimi i kanalizimeve;
**17.** Pastrimin e xhamave të jashtëm të objekteve të komunës;.
**18.** Zgjerimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik.

Ndërmarrja ka të miratuar statutin e saj, në kuadër të të cilit janë të cekura veprimtaritë që mund të ushtrojë ndërmarrja e njëra nga ato aktivitete është edhe ndriçimi publik i cili është i identifikuar në kuadër të librit për Klasifikimit e Veprimtarive Ekonomike (NACE Rev.2) me kodin 4321 – Instalimet Elektrike. Për ndërmarrjen ky është një aktivitet i ri i cili është i paraparë në kuadër të Statutit të ndërmarrjes, pra që ne si aksionar me rastin e miratimit të statutit të ndërmarrjes, kemi paraparë që ndërmarrja të merret me këtë aktivitet në të ardhmen. Këtë aktivitet ndërmarrja e ushtron nga muaji korrik i vitit kalendarik 2023.

## 4.2 PASTRIMI I OBJEKTEVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Njëra nga fushë-veprimtaritë kryesore të ndërmarrjes, për vitin kalendarik 2023 ka qenë pastrimi i objekteve dhe institucioneve të ndryshme publike që i përkasin Komunës së Vushtrrisë. Ndërmarrja ka marrëveshjen me Komunën e Vushtrrisë që të ofrojë shërbime në pastrimin e objekteve që janë nën pronësi të Komunës së Vushtrrisë, ku ndërmarrja duhet të bëjë pastrimin e të gjitha hapësirave që gjenden në kuadër të objekteve.

Aktivitetet që ka ofruar ndërmarrja në fushën mirëmbajtjes-pastrimit të institucioneve publike gjatë vitit kalendarik 2023 kanë qenë si në vijim:

1. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të tri (3) shkollave të arsimit të mesëm, dhe arsimit parashkollor, si dhe objektet përcjellëse të tyre.
2. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në qendrat e mjekësisë familjare dhe ambulanteve të mjekësisë familjare në të gjithë Komunën e Vushtrrisë.
3. Kryerjen e shërbimeve të pastrimit të të gjitha hapësirave të objekteve të Administratës së Komunës që përfshinë Objektin e Komunës si dhe objektet tjera të administratës komunale jashtë objektit të komunës si Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina”, Palestra Sportive në Vushtrri, ajo në Samadrexhë, Fusha e Futbollit në fsh. Doberllukë, Muzeu i Qytetit, Qendra Rinore "Naxhije dhe Fahri Buqinca", dhe Qendrën për Punë Sociale, përfshirë pastrimin e xhamave të jashtëm.
4. Pastrimin e xhamave të jashtëm të Objektit të Komunës, dhe objekteve tjera të Komunës.

## 4.3 SIGURIMI FIZIK

Ndërmarrja në bazë të marrëveshjes që ka me Komunën e Vushtrrisë ofron shërbimin themelor të sigurimit fizik të objekteve të institucioneve publike të komunës (Objektet e Arsimit, Shëndetësisë dhe Administratës së Komunës). Pra ndërmarrja bën sigurimin fizik të të gjitha objekteve arsimore, të objekteve shëndetësore, të administratës së komunës dhe objekteve përcjellëse të tyre. Ndërmarrja gjatë vitit kalendarik 2023 ka ofruar në tërësi shërbimet që ka pasur të kontraktuara me Komunën e Vushtrrisë, meqë rast gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë thyerje të asnjë objekti, dhe nuk kemi pas asnjë ankesë nga autoriteti kontraktues.

## 4.4 PËRGATITJET PËR MARRJEN E SHËRBIMIT PËR MBLEDHJEN DHE TRANSPORTIMIN E MBETURINAVE KOMUNALE

Përgjatë vitit kalendarik 2023, ndërmarrja i ka ndërmarr të gjitha veprimet me qëllim të përgatitjes për marrjen e shërbimit për mbledhjen dhe transportimit të mbeturinave.

Ndërmarrja ka ndërmarr hapa që të licencohet në fushën e mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave komunale dhe atë duke u bazuar në nenin 10 par. 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina po citoj si në vijim: *"1. "Në nenin 16, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim: 1.* ***Mbledhjen****, grumbullimin,* ***transportimin****, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bëjnë operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore."*

Ndërmarrja, ka ndërmarr veprimet e nevojshme me qëllim që të licencohet për ofrimin e shërbimit të mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë. Me datë 28.12.2022, ndërmarrja ka pranuar një njoftim nga ana e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si përgjigje ndaj kërkesës që kemi parashtruar, me të cilën njoftim thuhet po citojmë *"Referuar përgjigjeve nga të dhënat në pyetësor për mbledhje dhe bartje të mbeturinave komunale, kjo veprimtari nuk do të ketë ndikim të theksuar në mjedis gjatë fazës së realizimit të mbledhjes dhe bartjes së mbeturinave komunale. Bazuar në të lartcekurat, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës njofton Kompaninë "N.P.L Përparimi" Vushtrri, se nuk do ti nënshtrohet procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedis për mbledhje dhe bartje të mbeturinave komunale. Komuna mund të filloj procedurat për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale për Kompaninë "N.P.L Përparimi" Vushtrri për veprimtarinë e mbledhjes dhe bartjes së mbeturinave Komunale. Gjatë veprimtarisë pala duhet ti ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me ligjin."*

Ndërmarrja në bazë të njoftimit që ka pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me veprimtarinë që dëshiron ta ushtrojë në fushën e mbledhjes dhe bartjes së mbeturinave, nuk i nënshtrohet raportit për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, dhe në të njëjtën kohë neve na ka dhënë udhëzimin se duhet të pajisemi me leje mjedisore komunale.

Prandaj në mbështetje të nenit 10 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.09.2022, të nenit 12 par. 1 dhe 3 i Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 29.10.2010, dhe nenit 32 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit të shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 06.04.2009, lidhur me Njoftimin Nr. 7763-2/22 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të datës 28.12.2022, ndërmarrja ka parashtruar kërkesë që të pajiset me leje mjedisore komunale nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Vushtrrisë.

Ndërmarrja i ka bashkëngjitur kërkesën për pajisje me leje mjedisore komunale gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Ndërmarrja i ka bashkëngjitur kërkesën për pajisje me leje mjedisore komunale gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke përfshirë edhe një raport të VNM-së, që na u kërkua nga ana e Drejtorisë për Urbanizëm të Komunës së Vushtrrisë, ndonëse nuk ishim të obliguar për të njëjtën.. Ne gjatë muajit janar jemi pajisur me leje mjedisore komunale nga ana e komunës dhe në bazë të Nenit 10 par. 1 të Ligjit Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, të cilin po e citoj si në vijim: *"1. Në nenin 16, të ligjit bazik, paragrafi 1, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim: 1. Mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bëjnë operatorët e pajisur me leje përkatëse mjedisore.",* ne si ndërmarrje mund të operojmë në fushën e mbledhjes dhe bartjes së mbeturinave komunale.

Ndërmarrja në fund të vitit kalendarik 2023, duke respektuar procedurat ligjore ka angazhuar me anë të konkursit publik shtatëdhjetë e pesë (75) punëtorë të rinj, të cilët kanë qenë të angazhuar në kuadër të Njësisë operative të Komunës së Vushtrrisë të K.R.M "Uniteti" Sh. A.

Me datë 29.12.2023, ndërmarrja ka lidhur marrëveshje me Komunën e Vushtrrisë për ofrimin e shërbimit për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë. Kjo marrëveshje vlen për periudhën kohore nga data 02.01.2024 deri më 31.12.2024.

## 5. QARKULLIMI I NDËRMARRJES PËR VITIN KALENDARIK 2023

Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni shifrat e qarkullimit të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2023.

**Tabela nr. 6:** Qarkullimi i ndërmarrjes për vitin 2023.

| **Qarkullimi i ndërmarrjes për vitin 2023** | | | |
|---|---|---|---|
| **Të hyrat** | **Shpenzimet** | **Tatimi** | **Zhvlerësimi** |
| 1,189,114.89€ | 1,100,456.38€ | 5,277.32€ | 39,996.24€ |

| | |
|---|---|
| **Fitimi i periudhës** | **43,384.95€** |

## 6. LETRA E MENAXHMENTIT DHE OPINIONI I AUDITIMIT TË JASHTËM

Pas përfundimit të çdo viti kalendarik pasqyrat vjetore financiare i nënshtrohet një auditimi të jashtëm vjetor dhe objektiv nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar ashtu si kërkohet me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-08 për Ndërmarrjet Publike të cilin po e citoj si në vijim: *"Neni 33 i ligjit bazik paragrafi 33.1. riformulohet si në vijim: 33.1. Pasqyrat Vjetore Financiare të çdo Ndërmarrje Publike i nënshtrohen një auditimi të jashtëm të paraparë me ligj në pajtim me standardet e pranuara ndërkombëtare të auditimit. Ky auditim kryhet nga një auditor i pavarur, kompetent dhe i kualifikuar. Produkti përfundimtar i një auditimi të tillë duhet të jetë një opinion mbi vërtetësinë për Pasqyrat Vjetore Financiare përfshirë këtu edhe Letër Menaxhmentin."* Pasqyrat vjetore financiare për vitin kalendarik 2023 i janë nënshtruar auditimit të jashtëm meqë rast me datë 11.04.2024, Auditori i Jashtëm i është drejtuar ndërmarrjes pas Auditimit të Pasqyrave vjetore Financiare ku ka shprehur opinionin se Pasqyrat vjetore Financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe parimet e kontabilitetit dhe se paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen financiare të ndërmarrjes për vitin kalendarik 2023. Meqë rast më poshtë mund të shihni se letrën e menaxhmentit të ndërmarrjes, një ashtu dhe opinionin e Auditorit të Jashtëm të vulosur dhe të nënshkruar.

**Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.**
Rruga Gjergj Kastrioti Skënderbeu, nr.82
Vushtrri, Kosovë
NUI: 811507758

**Deklaratë e Pajtueshmërisë**

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2023

Deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2023 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në Pajtim me të gjitha kërkesat e ligjit 06-/L-065 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

**Fadil Bahtiri**
Kryeshef Ekzekutiv

**Valmira Xhafa Zekolli**
Zyrtare Kryesore Financiare

Quatra
**Quatra Audit Int. LLC.**
**A**:Str. Nena Tereza, H2-1
**T**: +383 (0) 44/377-873
**E**: lulzimkraniqi@gmail.com
**W**: www.quatra-ks.com

## RAPORT I AUDITORËVE TË PAVARUR

### Për aksionarët dhe menaxhmentin e Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A. ('Kompania') të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2023 dhe pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.
Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare të Kompanisë me 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.
Ne jemi të pavarur nga kompania në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkobëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.
Ne besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinion.

### Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrolle të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Kompansië të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetiti bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Quatra

**Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.
Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

**Lulzim Krasniqi**, Auditor LIGJOR, CertIFR, VLP
Partner, QUATRA AUDIT Int. LLC

Prishtinë, 11 prill 2024

Quatra Audit Int
Prishtinë

**P: +383 (0) 44 377 873 ◊ E: lulzimkrasniqi@gmail.com**
**A: Sheshi Nëna Terezë, H1, Nr.2, Prishtinë, Kosovë**
**Licenca KKRF Nr. 80 ◊ Nr. Scaak: 2088**

**Lulzim KRASNIQI,** AL, VL, CertIFR (Auditor Ligjor, Ministria e Financave, Licenca Nr: 80)
**QUATRA AUDIT Int. LLC** (Firmë Ligjore e Auditimit, Ministria e Financave, Licenca Nr. 38)

Quatra
**Quatra Audit Int. LLC.**
**A**:Str. Nena Tereza, H2-1
**T**: +383 (0) 44/377-873
**E**: lulzimkraniqi@gmail.com
**W**: www.quatra-ks.com

## RAPORT MBI KËRKESAT E TJERA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të N.P.L. Përparimi SH.A. si dhe informacionin e shkruar ne raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10. Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është pergatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 per pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

**Raport mbi kërkesat tjera**

- Ne jemi angazhuar si auditor të kompanisë N.P.L. Përparimi SH.A. për periudhën 01 janar 2023 - 31 dhjetor 2023, me datë 15 mars 2024 përmes Prokurimit Publik.
- Si pjesë e auditimit ne kemi identifikuar dhe vlerësuar rreziqet më të rëndësishme të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit. Më poshtë janë paraqitur rreziqet e rëndësishme dhe përgjigja e auditorit ndaj këtyre rreziqeve.

  *Vlerësimet kontabël*

  Kompania përdor vlerësimet kontabël në fusha të rëndësishme të pasqyrave financiare përfshirë jetëgjatësinë e aktiveve, dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe njohjen e provizioneve nga çështjet e mundshme gjyqësore. Përcaktimi i politikave lidhur me vlerësimet kontabël bëhet bazuar në përvojën historike dhe ndryshimet në faktorët ekonomik dhe të industrisë.

  *Përgjigja e auditorit*

  - Vlerësimi i përshtatshmërisë së vlerësimeve kontabël,
  - Vlerësimi i arsyeshmërisë së supozimeve të bëra nga menaxhmenti,
  - Rishikimi i saldove dhe rillogaritja e shumave të përdorura në supozime dhe metoda për të arritur në vlerësimet kontabël.
- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në menyrë qe t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshmet dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shenimeve shpjeguese.
- Ne konfirmojmë që opinioni i auditimit është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit.
- Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në *UA nr.02/2019 për pavaresinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5* dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

Lulzim Krasniqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
11 prill 2024

Quatra Audit Int
Prishtinë

1176/24

10.07.2024

## REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

| | |
|---|---|
| PËR: | z.Izet Miftari,<br>Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport |
| PËR NJOFTIM: | Klubi i Hendbollit KHF Samadrexha |
| PËRMES: | |
| NGA: | Hadika Abdurrahmani, Bashkëpunëtore Profesionale në Zyrën e Kryetarit |
| TEMA: | Kërkesa, ju dërgohet për shqyrtim |

Të bashkangjitur keni kërkesën Nr.02-104/02-31734/24 të dt.04.07.2024, të Klubit të Hendbollit KHF Samadrexha, për mbështetje financiare, për kremtimin e vitit jubilar 50 vjetorin e themelimit.

Kërkesa në fjalë është vendosur që t'i dërgohet Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për shqyrtim të mëtejmë.

Për çfarëdo vendimi që të merrni lidhur me këtë kërkesë duhet ta informoni kryetarin më së largu deri në mbledhjen e radhës me drejtor të drejtorive.

Njoftimi me shkrim lidhur me vendimin mbi kërkesën duhet të i dërgohet gjithashtu palës brenda afatit ligjor.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI - OPŠTINA VUČITRN - MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

## Formulari per kerkese apo ankese

**Drejtorati/Njesia** Kryetari i Komunës

Data 04/07/2024

Mos shkruani në këtë pjesë

**Numri i protokolit** 02-104/02-0031734/24

**Afati i zgjedhjes** 03/08/2024

**Vendimi**

**1.Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:**

**Emri dhe mbiemri** Klubi i hendbollit KHF Samadrexha

**Numri personal** /

**Adresa e vendbanimit** /

**E-mail Adresa**

**Numri i tel. fiks**

**Numri i tel. mobil** 48555550

**Vlera për pagesë:** 0.00

**2. Mënyra e pranimit** Kërkesa

**Statusi i lëndës** Ne proces

**3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:**

Kerkese

**4. Dokumentet e bashkangjitura:**

**Nr.** **Lloji i dokumentit**

**5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi**

Unë Klubi i hendbollit KHF Samadrexha vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkoni nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkese dhe dokumenteve të bashkangjitura

**Pranuar nga:** florjana.krasniqi

## KLUBI I HENBOLLIT „SAMADREXHA"EKIPI I FEMRAVE

Për : Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë z. Ferit Idrizi

Nga : KHF Samadrexha

Lënda : Kërkesë

I nderuar Kryetar, KH Samadrexha këtë vit feston vitin jubilar 50 vjetorin e themelimit. Klub ky që pati arritje të mëdha si në arenën vendore, ndërkombëtare dhe në garat e ligës së dytë Federative të ish Jugosllavisë, andaj kem nderin të ju ftojmë që ky organizim të bëhet nën Patronatin e Kryetarit të Komunës.
Pas një suksesi të jashtëzakonshëm në garat e Super ligës së Kosovës në edicionin e garave 2023/2024 KHF Samadrexha është anëtarë e garave të kupës së Evropës që do të filloj në shtatorë të këtij viti. Për të marr pjesë në garat e kupës së Evropës pa dyshim që na duhet përkrahja financiare nga Komuna dhe ju i nderuar Kryetar. Shuma financiare të cilën kërkojmë nga ju është 30 000 € ndërsa të tjerat i mbulon klubi së bashku me donatorët tjerë

Pasqyra e shpenzimeve për ndeshjen ndërkombëtare

| Nr. | Njësia | Sasia | Përshkrimi | Çmimmi ( € ) | Shuma |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | copë | 25 | Bileta të aeroplanit | 600 | 15 000 |
| 2. | Ditë 4 | 25 | Akomodimi ushqimi | 250 | 25 000 |
| 3. | | | Shpenzime të tjera | | 2 000 |
| Totali | | | | | 42 000 € |

Të bashkangjitur e gjeni edhe vërtetimin e lëshuar nga Federata e Hendbollit të Kosovës dhe thirrjen për pjesëmarrje në këto gara.

Samadrexhë më 01.07.02024

Me respekt!
KHF Samadrexha
Besnik Basholli President

KLUBI I HENDBOLLIT E KOSOVËS SAMADREXHA SAMADREXHË

Për : KHF Samadrexha
Nga: Federata e Hendbollit e Kosovës

28.06.2024, Prishtinë

Lënda: Konfirmim

Të nderuar,

Federata e Hendbollit e Kosovës konfirmon se KHF Samadrexha (femrat) nga Vushtrria është organizatë sportive dhe anëtare me të drejta të plota në Federatën e Hendbollit të Kosovës dhe njëherit merr pjesë në Superligën e femrave me skuadrën seniore, gjithashtu merr pjesë në gara me kategoritë e gjeneratave të reja (kadetë, pioniere dhe fatose).

Ky vërtetim lëshohet për të konfirmuar se KHF Samadrexha merr pjesë në garat evropiane, European Cup për edicionin 2024-2025.

Me respekt,

Isak Osmani

Isak Osmani
Komisar i garave

Kosova Handball Federation
10000 Pristina, Republic of Kosovo
Tel: +383 38 248 758
Fax: +383 38 227 640
Email: office@kosovahandball.info
Web: www.kosovahandball.info

MKRS KOK KEP ILLYRIA Kempa NEPTUN gorenje

# Pjesmarrja e në garat ndërkombëtare edicioni 2024-25

Inbox
Search for all messages with label Inbox
Remove label Inbox from this conversation

**Kosova Handball**

Mon,
Jun 3,
1:09 PM

to KHF, KHF, KHF, me, KHF

Të nderuar,

Shpresoj te jeni mirë dhe punët po ju shkojnë mbar.

Si çdo vit edhe këtë vit pas përfundimit të edicionit të rregullt Federata e Hendbollit duke u bazuar në Propozicionet e garave bën regjistrimin e klubeve për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare i cili afat është 04.06.2024.

Në bazë të rankimit të Federatave, FHK ka të drejt të paraqitjes me 4 (katër) skuadra, një në European League , dhe tri  në EHF Cup.

1. KHF Istogu - European League
2. KHF Ferizaj - EHF CUP
3. KHF Samadrexha - EHF CUP
4. KHF Prishtina - EHF CUP.

Klubet do ti nënshtrohen procesit të regjistrimit duke plotësuar formularët përkatës deri me 25.06.2024 Europian League , gjithashtu klubet të cila dëshirojnë të bëjnë kërkesë për ngritj apo ulje nga Europian League në Europian CUP janë të obliguar që kërkesën ta bëjnë me shkrim në formularin përkatë **attachment3_downgrade to WEC,** ose skuadrat e regjistruar për pjesëmarrje në EHF Europian League përmes formularit: **attachment5_upgrade from WEC to WEL** deri me datën **04.06.2024.**

Klubet të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në garat ndërkombëtare EHFH CUP për edicionin 2024-25, janë të obliguara që paraprakisht ti plotësojnë formularët  përkatës deri me datën: **24.06.2026 ora 16:00, te cilët i keni të bashkangjitur:**

- **1_Arbitration agreement Clubs 2024-25**
- **2_EHFCodeOfConduct_Clubs2024**
- **3_Club Registration form WEC dhe**
- **Garancionin e mbështetjes në garat ndërkombëtare nga Komunat përkatës**

Vëmendja: dokumentet e nevojshme duhet të nënshkruhen, vulosën dhe të dërgohen me email në PDF, për miratim.

Me respekt,
Muhamet Arifi

--

**Kosova Handball Federation**
10000 Pristina, Republic of Kosovo
Tel: +383 38 248 758 Mob: +383 44 450 452
Fax: +383 38 248 759
Email: office@kosovahandball.info
Web: www.kosovahandball.info

REPUBLIKA E KOSOVËS-KOMUNA VUSHTRRI

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

| | |
|---|---|
| Datë : | 02.07.2024 |
| Referencë : | |
| Për: | KPF-në dhe KK-në |
| Përmes | Kryetarit të Komunës,<br>Ferit Idrizi ________ |
| Nga: | Drejtor i DKA-së,<br>Albanez Tahiraj ________ |
| Tema: | Njoftim për shtyrje të afatit të informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024 |

Të nderuar,

Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, ju njofton se shtyn afatin e Informatës për përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2023-2024, për shkak se afati i futjes së të dhënave në sistemin smia.rks-gov.net, që përfshin regjistrimin e të dhënave për sukses dhe mungesa të gjysëmvjetorit të dytë, viti shkollor 2023/24, është i hapur deri më datë: 15.07.2024, prandaj kjo informatë shtyhet për seancën e radhës.

Me respekt!